المؤسسة الإسلامية للشباب

Fondacioni i Rinisë Islame
Stiftung der Islamischen Jugend
Foundation of Islamic Youth

Seebacherstrasse 67
CH-8052 Zürich
☎ + 41 (0) 43 300 16 70

www.islamischen.ch
✉ Islamischen@freesurf.ch
info@islamischen.ch

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَٰنِ الرَّحِيمِ

Në emër të All-llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit!

VESET E LIGA

ALKOOLI – DUHANI - BIXHOZI

Shebib bin Ali el-Hadiri

Kasim Dobraqa

Botuar nga: Botues Privat

Të gjitha të drejtat e këtij libri i takojnë përkthyesit Muhamed Iljaz Dolaku

PJESA E PARË 6
DISPOZITAT SHKATËRRUESE TË PIJEVE ALKOOLIKE 6
DOMETHËNIA E FJALËS "EL-HAMR" 6
PIKA E PARË: NË GJUHË 6
PIKA E DYTË: NË FIKH 8
PIKA E TRETË: NË KIMI 9
PIKA E KATËRT: NË FARMAKOKINETIKË 12
PIJET ALKOOLIKE JANË HARAM, HARAM! 14
E PARA: QËNDRIMI I KUR'ANIT FISNIK KUNDREJT ALKOOLIT 15
E DYTA: QËNDRIMI I SUNETIT TË PASTËR PEJGAMBERIK 24
E TRETA: QËNDRIMI I AS'HABËVE RRETH PËRDORIMIT TË ALKOOLIT 31
E KATËRTA: IXHMA – KONSENSUSI 32
A KA DOBI NË ALKOOL 33
PËRDORIMI I TIJ NË MJEKËSI DHE NË FARMACEUTIKË 34
PËRDORIMI I ALKOOLIT NË PRODHIMIN E AROMAVE DHE LËNDËVE AROMATIKE 35
PËRDORIMET E TJERA TË ALKOOLIT 35
PËRDORIMI I ALKOOLIT SI ILAÇ 36
PJESA E DYTË 37
ALKOOLI, ILUZIONET, GËNJESHTRAT 37

POHIMI I PARË 38
DISA NJERËZ NGA MOSDIJA KONFIRMOJNË SE ALKOOLI (VERA) E ÇEL OREKSIN, PRANDAJ NJERËZIT E PINË ATË GJATË NGRËNIES 38
POHIMI I DYTË 39
DISA NJERËZ NGA MOSDIJA POHOJNË SE ALKOOLI I JEP ENERGJINË E NGROHTË NJERIUT, E CILA E MBRON NGA TË FTOHTËT 39
POHIMI I TRETË 43
DISA NJERËZ POHOJNË SE ALKOOLI KA DOBI SHËNDETËSORE, E
VEÇANËRISHT PËR TË SËMURËT NGA ZEMRA, MEQË ËSHTË VËRTETUAR SE ALKOOLI ZGJERON DAMARËT E GJAKUT! 43
POHIMI I KATËRT 60
DISA NJERËZ POHOJNË SE ALKOOLI KA VLERË USHQYESE, DUKE PASUR PARASYSH SE PRODHON KALORI TË VLERËS SË LARTË 60
POHIMI I PESTË 63
DISA POHOJNË SE ALKOOLI KA AFTËSI QË TA VËJË NË LËVIZJE URINËN, PRANDAJ PËRDORET PËR SHËRIMIN E TË SËMURËVE NGA GURTHI I
VESHKAVE 63
POHIMII GJASHTË 70
DISA POHOJNË SE ALKOOLI E AKTIVIZON MENDJEN DHE I MUNDËSON NJERIUT QË TË PUNOJË DHE TË JETË I QËNDRUESHËM NË PUNË 70
POHIMI I SHTATË 73
DISA POHOJNË SE ALKOOLI NXIT DHE FORCON NEVOJËN PËR SEKS 73
PJESA E TRETË 78
DËMET SHOQËRORE DHE EKONOMIKE NGA ALKOOLI 78
VËLLIMI I PROBLEMIT 79
NDIKIMI I ALKOOLIT NË SHOQËRI 91

SI PËRBALLEN PROBLEMET? 92
Shtetet e Bashkuara të Amerikës 93
Ish-Bashkimi Sovjetik 93
ROLI I ALKOOLIT NË SHPËRBËRJEN E FAMILJES 98
ALKOOLI DHE PROBLEMET NË PUNË 103
ROLI I ALKOOLIT NË BËRJEN E KRIMEVE 104
ROLI I ALKOOLIT NË RRITJEN E PËRQINDJES SË FATKEQËSIVE AUTOMOBILISTIKE 108
BIXHOZI 114
PËRDORIMI I DUHANIT 119
DËMI I DUHANIT 120
PIRJA E DUHANIT NË SHOQËRINË MUSLIMANE DHE QËNDRIMI I ISLAMIT PËR KËTË ÇËSHTJE 121
VRASJET DHE GRINDJET 129
GJAKMARRJA 139
SJELLJA E KEQE DHE JO E KULTURUAR SI SHKAKTARE E GRINDJEVE DHE VRASJEVE 140

PJESA E PARË
DISPOZITAT SHKATËRRUESE TË PIJEVE ALKOOLIKE

DOMETHËNIA E FJALËS "EL-HAMR"
PIKA E PARË: NË GJUHË

Er-Raziu në "Muhtaru es-sihah", për pijet alkoolike (ar. hamr) parashtron si vijon: "Ibën El-A'rabi thotë: "Thuhet se pijet alkoolike e kanë marrë emrin "hamr" ngase duke ndenjur janë thartuar (zier ndër vete), ndërsa thartimi i këtyre pijeve është në realitet ndërrimi i erërave të tyre." Gjithashtu, thuhet se pijet alkoolike e kanë marrë këtë emër ngase ato mbizotërojnë (mbulojnë) arsyen e njeriut. Për gruan e cila e vë velin në fytyrë thuhet "ihtemeret", ndërsa tahmir do të thotë të mbuluarit.

Ajo që deh (hamr) është ajo që mbizotëron (mbulon) arsyen, qoftë ajo në gjendje të lëngët apo të ngurtë, qoftë në formë të ushqimit ose të pijes.

Er-Ragib El-Asbahaniu, në veprën "Mufredat el Kur'an", thotë: "Pijet alkoolike (hamr) kanë marrë emrin "hamr" meqë e mbulojnë arsyen, ndërsa disa njerëz me këtë emër quajnë çdo gjë që të deh."

Është e domosdoshme të përmendet se fjala "alkool", në esencë me prejardhje arabe, është formuar nga fjala "el-gul", por më vonë ajo është transformuar në fjalën "el-kuhul".

Fjala "el-gul" është përmendur në Kur'an në Fjalët e All-llahut të Lartmadhëruar, i Cili thotë: "Prej saj nuk do të dhemb koka dhe nga ajo nuk do të humbet mendja." (Es–Saffat: 47)

Në këtë ajet All-llahu xhel-le shanuhu mohon nga vera e Xhenetit (hamr) vetinë e të dehurit të mendjeve.

Duke komentuar këtë ajet, Esh-Shevkaniu thotë: "Nuk ua merr e as që ua mungon mendjen, e nga kjo verë nuk ndiejnë sëmundje e kokëdhembje. All-llahu xhel-le shanuhu nga vera e xhenetit mohon mundësinë e shkaktimit të mjerimeve, siç është kokëdhembja dhe dehja, që shkakton alkooli (vera) në këtë botë."

Në veprën "Muhtaru es-Sihah", për domethënien e fjalës "gavl", Er-Raziu thotë: "Folja 'gale' është në trajtën 'kale', e thuhet 'igtalehu' nëse i ndodh njeriut diçka duke mos e ditur si dhe prej nga." Fjalët e të Lartmadhërishmit: "La fiha gavl" do të thonë: "pas pirjes së kësaj vere nuk ka kokëdhembje", ngase në një ajet tjetër thotë: "La jusadda'une anha".

Ebu Ubejde thotë: "'El-gavl' do të thotë që vera t'ua marrë arsyen; për çdo gjë që e kaplon njeriun dhe e vdes atë, thuhet 'gavl'."

PIKA E DYTË: NË FIKH

Fjala "hamr" nënkupton çdo gjë që shkakton dehjen, qoftë baza e saj pemët, siç janë rrushi, hurma, stafidhja, qoftë baza e saj drithërat, siç janë gruri, elbi, misri, qoftë nga mjalti, edhe nëqoftëse ajo piqet në zjarr apo jo.

Nga kjo shohim se arsyeja për shkak të së cilës është ndaluar alkooli është dehja, e jo baza nga e cila është prodhuar alkooli. Përkitazi me këtë ekzistojnë këto argumente autentike:

- Umer b. El-Hattabi radijall-llahu anhu mbante ligjëratë (hudbe) nga mimberi i të Dërguarit të All-llahut sal-lall-llahu alejhi ve sel-lam duke thënë: "O njerëz, me të vërtetë është shpallur ndalesa e alkoolit, kurse ky përgatitet prej pesë gjërave: prej rrushit, hurmave, mjaltit, grurit dhe elbit. Alkooli (hamr) është ajo që mbulon arsyen."[1]

- En-Nu'man b. Beshiri radijall-llahu anhu transmeton se i Dërguari i All-llahut sal-lall-llahu alejhi ve sel-lam ka thënë: "Me të vërtetë alkooli është prej rrushit, alkooli është edhe prej hurmave, alkooli është edhe prej mjaltit, alkooli është edhe prej grurit, alkooli është edhe prej elbit."[2]

[1] Transmetojnë El-Buhariu dhe Muslimi.

[2] Transmetojnë të pestët përveç En-Nesaiut.

PIKA E TRETË: NË KIMI

Literatura shkencore përmend se arabët ishin të parët që e prodhuan alkoolin dhe thuhet se një shkencëtar-kimist musli-man, Xhabir b. Hajjani, ishte i pari që e kishte përmirësuar alkoolin në vitin 185 h.

Pijet alkoolike përkufizohen si pije, përbërësi kryesor i të cilave është alkooli. Këto pije përmbajnë në vete një sasi të madhe të përbërësve alkoolikë, kurse më i rëndësishmi është alkooli etilik, formula kimike e të cilit është C_2H_5OH, dhe konsiderohet si lëndë dehëse dhe është i pranishëm në të gjitha pijet alkoolike. Këtë lëndë kimistët e karakterizojnë si helmuese; ajo është e lëngët, pa ngjyrë, avullon e ndizet shpejt dhe tretet si në ujë, ashtu edhe në yndyrëra.

Procesi i përgatitjes së alkoolit ndodh me thartimin e materieve të sheqerit dhe me ndikimin (veprimin) e thartirës, ndërsa, edhe pse dallohen për nga emri, pijet alkoolike përmbajnë një substancë të përbashkët, që quhet alkool.

I Dërguari i All-llahut sal-lall-llahu alejhi ve sel-lam e ka thënë të vërtetën kur ka pohuar: "Me të vërtetë, njerëzit e umetit tim do të pinë pije alkoolike dhe nuk do t'i quajnë me emrat e tyre." [3]

Tabela vijuese na sqaron disa nga pijet alkoolike dhe burimin e substancës së sheqerit nga e cila përgatiten, si dhe përqindjen e alkoolit që përmbajnë.

[3] Transmeton Ahmed Ebu-Davudi.

% E ALKOOLIT	BURIMI I SUBTANCËS SË SHEQERIT	LLOJI I PIJES ALKOOLIKE
3-6% 3-6% 4-8%		Birra dhe llojet e saj: - magazine, - ales, - stout
4-6%	Mollët ose ndonjë frut tjetër	Cider
8-10% 15-20%	Rrushi	Verërat: - e lehta - shampanja të forta: sherry, port, vermouth

40% 37-40% 40% 37-40%	- Distilimi i tretësirës së thartuar të rrushit - Distilimi i tretësirës së thartuar të misrit - Distilimi i kallamit të sheqerit – tretësirë e thartuar, së cilës i është shtuar mani ose ndonjë frut tjetër - Drithëra të distiliuara	- raki - uiski - rum - xhin
20-55%	Pije alkoolike të distiliuara, me shtim të aromës	Pijet alkoolike të ëmbla – likeret: - kirsch, - chatreuse

Grupin e dytë të përbërësve të alkoolit e sajon metanoli, i cili përdoret më pak, por është më helmues se alkooli etilik, ngase mund të shkaktojë edhe vdekjen, helmimin e muskulit të zemrës dhe rraskapitjen e saj. Po kështu ai mund të shkaktojë edhe verbërimin e befasishëm. Është e domosdoshme të përmendet se ky lloj alkooli, d.m.th. metanoli, gjendet në plagjiate të pijeve alkoolike.

Sa alkool përmban një njësi?

Një njësi në vete përmban 10 mililitra ose 8 gramë alkool të pastër, e kjo është përafërsisht e barabartë me:

- një gotë uiski;

- një gotë sherry;

- një gotë verë të thjeshtë;

- një krikëll birrë ose cider me vëllim 550 mililitrash.

Nga ana tjetër, një shishe e pijeve alkoolike të koncentruara, siç është rakia, uiski, xhini etj., përmban 30 njësi, përafërsisht 300 mililitra ose 240 gramë alkool të pastër.

PIKA E KATËRT: NË FARMAKOKINETIKË

Stomaku dhe zorrët e holla e përthithin shpejt alkoolin nëse alkooli është në koncentrim më të vogël, por nëse koncentrimi i alkoolit në pije është më i madh se 20%, atëherë procesi i përthithjes bëhet më i ngadalshëm. Shkaku i kësaj është se alkooli shkakton prishjen e peristaltikës së stomakut (gastric peristalis), siç shkakton edhe tkurrjen e vrimës së diafragmës (pylorosprans), që ka për pasojë ardhjen e më ngadalshme të alkoolit në zorrë që alkooli të përthithet.

Ekzistojnë edhe faktorë të tjerë që shkaktojnë ngadalësimin e procesit të përthithjes, siç është pirja e qumështit, zbutja e alkoolit me ujë dhe ushqimi që ende nuk është tretur.

Pas procesit të përthithjes, alkooli përhapet nëpër të gjitha qelizat e organizmit me shpejtësi të madhe dhe vlen të përmendet se rreth 90% e alkoolit të përthithur mobilizohet në organizëm, kurse pjesa tjetër e tij del jashtë përmes urinës, djersës dhe frymënxjerrjes. Organi më i rëndësishëm i specializuar për metabolizmin e alkoolit është mëlçia, e cila metabolizon rreth 90% të alkoolit të përthithur përmes disa enzimave që i prodhon vetë, siç është enzima që ndan hidrogjenin nga alkooli (alkoholdehydrogerase – ADH), e shndërron alkoolin në acetal-dehyde, pastaj në acetat, i cili më në fund shndërrohet në dioksid karboni dhe në ujë. (Shih fotografinë 2)

PIJET ALKOOLIKE JANË HARAM, HARAM!

All-llahu i Lartmadhërishëm thotë: "O besimtarë! Me të vërtetë, vera, bixhozi, statujat dhe shigjetëzat e fallit janë gjëra të ndyta, punë djalli. Prandaj largohuni nga këto, që të arrini atë që dëshironi!" (El–Ma'ide: 90)

Ndalesa e pirjes së alkoolit është vërtetuar me Kur'an, me Sunet dhe me ixhma (konsensus).

Mirëpo, përkundër kësaj, eksizton një grup njerëzish të cilët konsiderojnë se fjala fexhtenibuhu – largohuni nga këto, që është përmendur në Kur'an nuk udhëzon në ndalesën e qartë dhe kategorike, siç është rasti me ndalesat e tjera, kurse shembull për këtë janë Fjalët e All-llahut të Lartmadhërishëm: "Ju ndalohet ngordhësira, gjaku, mishi i derrit dhe ajo (kafshë) që është therur në emër të dikujt tjetër e jo në emër të All-llahut, dhe që është mbytur e vrarë, dhe që është gremisur, dhe që është therur me brirë, ose që është dëmtuar nga egërsirat, — përveç nëse e keni prerë ju." (El–Ma'ide: 3)

Për t'u përgjigjur në këtë konfirmim të pabazë, vëmendjen tonë do ta drejtojmë në këtë:

E PARA: QËNDRIMI I KUR'ANIT FISNIK KUNDREJT ALKOOLIT

Fjala "Fexhtenibnuhu - Largohuni nga këto", e përmendur në Kur'an

Kjo fjalë në gjuhën arabe do të thotë "largim" dhe "mosafrim ndaj diçkaje" ose "të kufijve të diçkaje". Pra, kjo fjalë është ndër ndërtimet më të spikatura, e cila vë në pah ndalesën. Ai që i studion ajetet e Kur'anit Fisnik do të shohë se fjala *"fexhtenibuhu* – largohuni nga këto", është përmendur në numër të madh në ajete të tjera. Nga këto ajete janë edhe ajetet ku ndalohet pranimi i bindjeve të rrejshme dhe veseve të këqija, ndërsa disa prej këtyre ajeteve janë:

"Prandaj, largohuni nga idhujt dhe shmangjuni sa më shumë bisedave të rrejshme." (El-Haxhxh: 30)

"Ne çdo populli i kemi dërguar Pejgamberë. "Adhuroni All-llahun, e shmangiuni idhujve!" (En–Nahël: 36)

"Për ata të cilët i shmangen adhurimit të idhujve dhe të cilët i drejtohen All-llahut, atyre u janë kushtuar lajmet e gëzuara, prandaj përgëzoji robërit e Mi!" (El–Zumer: 17)

"Kur Ibrahimi u lut: "O Zoti im, bëje këtë vend vendbanim të sigurt dhe më ruaj mua dhe bijtë e mi nga adhurimi i idhujve!" (Ibrahim: 35)

Në disa ajete përmenden njëkohësisht edhe fatkeqët edhe ata që i frikësohen All-llahut, si p. sh.:

*“Në të cilin do të hyjë vetëm fatkeqi, *i cili mohon dhe kthen kokën, *ndërsa nga ai do të jetë larg ai i cili i frikësohet All-llahut.” (El–Lejl: 15-17)

Ai i cili i studion me vëmendje ajetet për ndalimin e alkoolit: *“O besimtarë! Me të vërtetë vera, bixhozi, statujat dhe shigjetëzat e fallit janë gjëra të ndyta, punë djalli. Prandaj largohuni nga këto, që të arrini atë që dëshironi! *Djalli dëshiron që, me anë të pijeve alkoolike e me bixhoz, të fusë në mes jush armiqësi e urrejtje dhe t’ju shmangë juve nga të kujtuarit e All-llahut dhe nga namazi. Pra, a do të shmangeni?!” (El–Ma’ide: 90-91), do të shohë se këto ajete përmbajnë shumë tregues që vënë në pah ndalimin e përdorimit të alkoolit.

Disa nga këta tregues janë si vijon:

Ajeti fillon duke iu drejtuar besimtarëve me fjalët: “O besimtarë!”, që tërheq vërejtjen se ajo që pason është dispozitë të cilën besimtarët, që i përgjigjen Zotit dhe që i kryejnë urdhrat e Tij e shmangen nga ndalesat, duhet ta kryejnë patjetër.

Alkooli (vera) është përmendur në kontekst së bashku me bixhozin, me idhujt, me shigjetëzat për fall dhe të gjitha këto bëjnë pjesë në mëkate të mëdha. Alkooli është përmendur i pari për shkak të mëkatit të madh të përdorimit të tij dhe se ai është çelësi i të gjitha mynxyrave.

Alkooli është quajtur “gjë e neveritshme” (rixhs), ndërsa fjala rixhs në gjuhën arabe shënon gjërat e urryera e të ndyra. Ka mendime se kjo fjalë do të thotë mllef, sikur domethënia e mëkatit.

Ajetet sqarojnë se alkooli është vepër e djallit, ndërsa nga djalli vjen vetëm e keqja, siç thotë Esh-Sheukani. Shehidi, Seid Kutbi, All-llahu e mëshiroftë, thotë: “Shejtani është armiku i stërlashtë i njeriut, kurse për besimtarin mjafton që ta dijë se një vepër është e djallit e që ndjenja e tij t’i

shmanget kësaj, që shpirti i tij të ndiejë neveri nga kjo dhe që qenia e tij të zmbrapset e të largohet nga kjo në mënyrë që të ruhet dhe të frikësohet prej saj."

Përdorimi i shprehjes "largohuni", e cila është më shprehëse, vë në pah ndalesën, ngase kjo do të thotë largimi nga e ndaluara, e të mos flitet për kryerjen e asaj që është e ndaluar.

Arritja e suksesit dhe shpëtimi janë të lidhura me kënaqësinë e All-llahut duke iu shmangur alkoolit: "Prandaj, largohuni nga këto, që të arrini atë që dëshironi!", që paraqet nxitje për besimtarët që t'i shmangen atij. Esh-Sheukani thotë: "Nëse në shmangien nga alkooli është shpëtimi, atëherë në përdorimin e tij është gremisja dhe shkatërrimi."

Ajetet sqarojnë të këqijat dhe dëmet nga përdorimi i alkoolit. I Lartmadhërishmi thotë: "Djalli dëshiron që me anë të pijeve alkoolike e me bixhoz të fusë në mes jush armiqësi e urrejtje." Seid Kutbi, All-llahu e mëshiroftë, thotë: "Me këtë vetëdijes së muslimanëve i zbulohet synimi i djallit, caku i intrigës së tij dhe prodhimi i ndytësisë së tij. Ky është shkaktimi i armiqësisë dhe i urretjes në radhët e muslimanëve, me ndihmën e verës dhe të bixhozit si dhe largimin e "atyre që besojnë" nga kujtimi i All-llahut dhe nga namazi, etj. Këto qëllime, të cilat dëshiron t'i arrijë djalli, janë njëmendësi dhe muslimanët mund t'i shohin ato në botën e dukshme. Këto fjalë janë vërtetuar me Fjalët hyjnore, të vërteta vetvetiu. Nuk është nevoja që të hulumtohet gjatë për t'u bindur njeriu se djalli është ai i cili hedh ndër njerëzit, me anën e alkoolit e të bixhozit, armiqësinë dhe urrejtjen. Alkooli merr mendjen dhe e nxeh gjakun e mishin dhe nxit teket e ashpërsinë. Bixhozi, i cili shkon së bashku me alkoolin, nxit në shpirtëra ndjenjën e shkatërrimit e të smirës (urrejtjes), meqë ai që ka humbur në bixhoz domosdo ndien smirë e urrejtje ndaj atij me të cilin ka luajtur bixhoz, ngase ai ia merr paratë sy ndër sy, i merr ato si fitues, ndërsa partneri i tij

mbetet si humbës me telashe. Në natyrën e këtyre gjërave, të bixhozit e të alkoolit, është që të nxisin urrejtjen dhe armiqësinë, sado që ato i bashkojnë partnerët në fushën e grindavecisë dhe të eksplozivitetit, të cilat sipërfaqësisht kanë mbresën e përzemërsisë dhe kënaqësisë. Largimi nga kujtimi në All-llahun dhe nga namazi nuk është nevoja të shqyrtohet, ngase alkooli shkakton harresën, ndërsa bixhozi të pushton. E qara e bixhozçiut nuk është aspak më e vogël sesa e qara me alkool, kurse bota e bixhozçiut është porsi bota e pijanecit dhe kufizohet në tavolina, në gota dhe në gurë (letra).

Për Fjalët e të Lartmadhërishmit: "Pra, a do të shmangeni?!" Ibën Kethiri thotë: "Këtu është kanosja dhe frikësimi." Kurse Esh-Sheukani thotë: "Këtu gjendet një rrënjë e madhe në formë pyetjeje, e cila vë në pah qortimin, prandaj Umeri radijall-llahu anhu, kur e pat dëgjuar këtë, ka thënë: "Po shmangem!"

Fjalët e të Lartmadhërishmit, pas ajetit me të cilin ndalohet alkooli: "Bindjuni All-llahut, bindjuni edhe Pejgamberit dhe jini të kujdesshëm! E nëse ktheni kokat, atëherë dijeni se Pejgamberi Ynë ka për detyrë vetëm të shpall qartë." (El–Ma'ide: 92). Ajeti vërteton dhe thekson domosdoshmërinë e pasimit të urdhrit të All-llahut, kështu që nuk do të vazhdohet me pirjen e alkoolit, dhe vë në pah pasimin e asaj që i Dërguari i All-llahut sal-lall-llahu alejhi ve sel-lam sqaron lidhur me alkoolin.

As'habët i përfshiu frika për vëllezërit e tyre të cilët kishin përdorur alkoolin e ishin vrarë në rrugën e All-llahut para ndalesës së përdorimit të alkoolit, rreth asaj se a do t'i dënojë All-llahu ata. Për këtë shkak u shpallën Fjalët e All-llahut xhel-le shanuhu, si qetësim i shpirtërave. "Për ata që besojnë dhe që bëjnë vepra të mira s'ka asfarë mëkati për atë që kanë ngrënë e që kanë pirë

(para ndalesës) kur i shmangen asaj që e kanë të ndaluar dhe kur besojnë, pastaj i frikësohen All-llahut e besojnë dhe atëherë u shmangen mëkateve dhe bëjnë mirësira. E, All-llahu i do ata që u bëjnë mirësira të tjerëve." (El–Ma'ide: 93)

Ndalimi i përdorimit të alkoolit është shpallur në etapa dhe unë do t'ia lë hapësirën shehidit Seid Kutbi, All-llahu e mëshiroftë, që të na shpjegojë etapat përmes të cilave ka kaluar dispozita e ndalesës së përdorimit të alkoolit. Ai thotë: "Etapa e parë ka qenë dirigjim i shigjetës së tendosur kur All-llahu i Lartmadhërishëm në suren En-Nahl ka thënë: "E nga frutat e palmave e të hardhisë përgatitni pije dhe ushqim të këndshëm." (En–Nahl: 67) Në këtë mënyrë ajo qe e para që arriti te kujtesa e muslimanëve duke vendosur pijen (alkoolin) kundruall "ushqimit të këndshëm", prandaj duket se alkooli është një gjë ndërsa ushqimi i këndshëm një gjë krejt tjetër.

Pastaj vjen etapa e dytë, në të cilën është zgjuar vetëdija e besimit në shpirtërat e muslimanëve me anë të logjikës legjislative, kur u shpall ajeti i sures El-Bekare: "Të pyesin ty për verën dhe bixhozin. Thuaj: "Në to ka mëkat (dëm) të madh, por edhe dobi për njerëzit; mirëpo, mëkati (dëmi) është më i madh sesa dobia prej tyre!" (El–Bekare: 219)

Në këtë ajet është dhënë shenja se braktisja e bixhozit dhe verës është më urgjente, duke qenë se dëmi është më i madh sesa dobia, ndërsa ka pak gjëra që nuk kanë njëfarë dobie; mirëpo, lejimi ose ndalimi i kësaj gjëje mbështetet në atë se a mbizotëron në të dëmi a dobia.

Pastaj pason etapa e tretë, në të cilën është thyer shprehia e pirjes së alkoolit dhe nxitja e jotolerancës dhe e mospajtimit ndërmjet alkoolit dhe urdhërit për faljen e namazit kur u shpall ajeti nga surja En-Nisa': "O besimtarë! Asesi mos iu afroni namazit kur jeni të dehur, përderisa të dini se ç'flisni." (En–Nisa': 43)

Namazi kryhet në pesë intervale kohore dhe ndërmjet shumicës së këtyre intervaleve ka distancë të vogël kohore, e pamjaftueshme që njeriu të dehet e pastaj të zhdehet ndërmjet dy kohëve të namazit. Me këtë dispozitë ngushtohen gjasat e zbatimit praktik të shprehisë së pirjes së alkoolit, e veçanërisht për pirjen e alkoolit në mëngjes dhe pas ikindisë ose akshamit, siç ishte shprehi e njerëzve në periudhën paraislamike, xhahilijet. Ajeti thyen edhe shprehinë e përdorimit të alkoolit lidhur me afatet e caktuara kohore, në të cilat është përdorur alkooli. Në ajet gjendet diçka që në shpirtin e muslimanit ka peshën e vet, e kjo është pamundësia e harmonizimit ndërmjet zbatimit të urdhërit të faljes së namazave në kohën e tyre dhe shoqërimit të shprehisë së pirjes së alkoolit në periudha të caktuara kohore. Pastaj pason etapa e katërt vendimtare, për të cilën shpirtërat tanimë ishin përgatitur tërësisht. Vetëm sa erdhi ndalesa, pasoi bindja dhe dëgjesa pa farë hamendje. Nga Umer b. El-Hatabi, All-llahu qoftë i kënaqur me të, transmetohet se ka thënë: "O All-llah, shpjegona për alkoolin me një shpjegim të mjaftueshëm!" Atëherë është shpallur ajeti në suren El-Bekare: "Të pyesin ty për verën dhe bixhozin. Thuaj: "Në to ka mëkat (dëm) të madh, por edhe dobi..." Pastaj Umerin e thirrën dhe i lexuan ajetin, ndërsa ky tha: "O All-llah, na shpjego për alkoolin gjëra të cilat do të na kënaqin!" Atëherë u shpall ajeti nga surja En-Nisa': "Asesi mos iu afroni namazit kur jeni të dehur..." Umerin e thirrën sërish, i lexuan këtë ajet dhe tha: "O All-llah, na shpjego për alkoolin aq sa do të jetë e mjaftueshme!" Pastaj u shpall ajeti nga surja El-Ma'ide: "Djalli dëshiron që, me anë të pijeve alkoolike e me bixhoz, të fusë në mes jush armiqësi e urrejtje dhe t'ju shmangë juve nga të kujtuarit e All-llahut dhe nga namazi. Pra, a do të shmangeni?!" Ja lexuan Umerit përsëri këtë ajet e ky tha: "U shmangëm, u shmangëm!" Këtë e shënojnë autorët e "Suneneve".

Kur u shpall ky ajet për ndalimin e alkoolit në vitin e tretë pas Betejës së Uhudit nuk ishte nevoja për më shumë se një tellall (kasnec), i cili thërriste në vendet ku tuboheshin njerëzit në Medinë: "O njerëz, alkooli u bë i ndaluar (haram)!" Ai që kishte në atë çast gotën në dorë – e thyente, ndërsa ai që kishte një gllënjkë në gojë – e nxirrte nga goja dhe u shqyen të gjitha mbajtëset për verë e u thyen të gjitha shtambat. Dhe kështu, çështja mori fund.

Për sa i përket urtësisë që prehet në ndalimin suksesiv të alkoolit, atë na e ka shpjeguar Sejjid Kutbi me rastin e komentimit të Fjalëve të All-llahut: "*Të pyesin ty për verën dhe bixhozin. Thuaj: "Në to ka mëkat (dëm) të madh, por edhe dobi për njerëzit; mirëpo, mëkati (dëmi) është më i madh sesa dobia prej tyre!"* Ai thotë: "Ky tekst, që gjendet para nesh, ishte hapi i parë i ndalesës. Gjërat dhe veprat nga-ndonjëherë nuk janë vetëm të këqija. E mira përzihet me të keqen, ndërsa e keqja përzihet me të mirën në këtë botë. Mirëpo, ajo nga çka varet se a do të jetë diçka e lejuar apo e ndaluar është mbizotërimi i anës së mirë ose të keqe. Nëse dëmi nga alkooli dhe bixhozi është më i madh sesa dobia, atëherë ky është shkak dhe arsye për ndalim, edhe pse këtu nuk është shprehur në mënyrë të qartë."

Në këtë vend tregohet sheshit një anë e metodës së edukimit islam, kur'anor hyjnor dhe të urtë, e kjo është metoda që mund të gjendet në shumë dispozita, urdhëresa dhe udhëzime të tij. Ne do të spikatim tani një rregull të kësaj metode me rastin e të folurit për alkoolin dhe bixhozin.

Kur dispozita ose ndalesa është e lidhur me një rregull të konceptit të imanit (besimit) ose për një çështje bindjeje (i'tikad), atëherë Islami që nga momenti i parë sjell urdhëresë të qartë. Mirëpo, kur dispozita ose ndalesa është e lidhur me shprehi (adet) ose me imitim, ose me ndonjë situatë

shoqërore e cila nuk është e lehtë, atëherë Islami pret dhe i afrohet çështjes ngadalë, butësisht e suksesivisht, dhe përgatit kushte reale e optimale, që lehtësojnë zbatimin dhe bindjen.

Kur kishte të bënte me çështjen e teuhidit apo të shirkut, Islami që nga momenti i parë e realizoi dispozitën e tij në mënyrë të prerë e të vendosur, pa hamendje e përfillje, pa pazarllëk e takim në gjysmën e rrugës; se këtu kemi të bëjmë me çështjen e rregullit bazor të konceptit, pa të cilin imani nuk është i rregullt dhe Islami nuk vendoset. Për sa i përket alkoolit dhe bixhozit, kishin të bënin me adet e shprehi, kurse shprehia kërkon shërim. Për këtë shkak është filluar me lëvizjen e vetëdijes së besimit dhe logjikës legjislative në shpirtërat e muslimanëve, kështu që është thënë se dëmi nga alkooli dhe bixhozi është më i madh sesa dobia, pra në shenjë se braktisja e alkoolit është gjë parësore. Pastaj erdhi hapi i dytë me rastin e shpalljes së ajetit nga surja En-Nisa': "O besimtarë! Asesi mos iu afroni namazit kur jeni të dehur, përderisa të dini se ç'flisni."

Namazi kryhet në pesë periudha kohore dhe në shumicën e këtyre periudhave është një distancë e vogël kohore, që nuk është e mjaftueshme për t'u dehur dhe për t'u zhdehur. Këtu shprehet ngushtimi i gjasave për praktikimin e shprehisë së pirjes dhe thyerja e shprehisë së përdorimit të alkoolit, që është e lidhur me kohën e caktuar të përdorimit.

Dihet se ai që përdor diçka, ndien nevojë për atë që merr rregullisht, qoftë fjala për pije dehëse ose drogë, në kohë të caktuar, në të cilën zakonisht e përdor atë. Kur e kalon këtë kohë të zakonshme dhe kjo përsëritet shumë herë, atëherë zvogëlohet fuqia e kësaj shprehije dhe është e mundur të mposhtet. Pasi u realizuan këta dy hapa, erdhi urdhëri i fundit për ndalimin e alkoolit dhe bixhozit: "O besimtarë! Me të vërtetë, vera, bixhozi, statujat dhe shigjetëzat e fallit janë gjëra të ndyta, punë djalli. Prandaj largohuni nga këto, që të jeni të shpëtuar!" (El–Ma'ide: 90)

Në një vend tjetër Sejjid Kutbi thotë: "Alkooli (vera), bixhozi, statujat dhe shigjetëzat e fallit kanë qenë veçori dhe traditë e rrënjosur thellë në shoqërinë e xhahilijetit. E gjithë kjo ka qenë një tufë e lidhur fort me praktikimin e këtyre gjërave edhe me atë se këto gjëra kanë qenë veçanti dhe traditë e asaj shoqërie. Alkoolin e pinin në sasira të mëdha dhe me pirjen e tij garonin në ndejet e tyre në vetëlavdërime dhe mburrje. Vetëlavdërimin në poezi e ndërlidhnin me alkoolin. Përkrah orgjive shkonte edhe therrja e kafshëve dhe hanin mish të pjekur ata që pinin alkool, ata që e përgatisnin atë dhe ata që ishin përherë të pranishëm në këto ahengje, të cilët gjenin strehim në to dhe ata mblidheshin rreth tyre. Këto kafshë therreshin pranë statujave (ensab), dhe kafshët e tyre i thernin tek ata dhe i lyenin me gjakun e tyre. Gjithashtu, tek idhujt i thernin edhe flijimet që ua kushtonin zotave të tyre, përkatësisht shortarëve që kujdeseshin për ta (idhujt). Rreth kafshës së therrur në orgji dhe në rrethana të ngjashme shoqërore, ushtrohej bixhozi me ndihmën e shigjetëzave (për fall). Çdonjëri prej tyre e fitonte pjesën e vet sipas asaj që tregonte shigjetëza e tij. Shigjetëza që merrte çmimin më të madh (shigjetëza e shtatë), atij i takonte pjesa më e madhe, por kishte edhe të tillë të cilëve shigjetazat nuk u sillnin asnjë fitim. Kur e njohën Zotin e vërtetë, shpirtërat e tyre filluan të dëgjonin atë që më të vërtetë donte dhe nuk donte prej tyre ky Zot i Vërtetë, ndërsa para kësaj as që i kushtonin kujdes, as që i bindeshin urdhërit dhe as që shmangeshin nga ndalesa. Nuk i braktisnin shprehitë e tyre xhahilijetike, pa marrë parasysh sa herë iu përsëriteshin urdhërat ose u jepeshin këshillat.

Lidhja e natyrës së pastër njerëzore është lidhja e bindjes (akides) dhe, nëse së pari nuk vendoset kjo lidhje, në natyrën e njerëzore nuk do të mbetet asgjë nga ahlaku (morali), nga etika ose nga mirëqenia shoqërore. Çelësi i natyrës njerëzore është këtu. Nëse ajo nuk çelet me çelësin e vet, tuneli i saj i brendshëm do të ngelë i mbyllur, ndërsa rrugët e saj bërrylake. Dhe, kurdoherë që

ndonjë grykë e saj zbulohet, tjetra fshihet; kurdoherë që ndriçohet ndonjë aspekt i saj, tjetri errësohet; kurdoherë që zgjidhet ndonjë nyje, tjetra lidhet dhe kurdoherë që hapet ndonjë rrugë e saj, rrugët dhe shtigjet e tjera mbyllen, dhe kështu pa mbarim.

Për këtë shkak metoda islame nuk filloi me shërimin e ceneve dhe devijimeve të xhahilijetit prej tyre. Filloi nga vetë bindja (akida). Filloi nga dëshmia (shehadeti), se nuk ka zot përveç All-llahut, ndërsa periudha e dëshmisë se nuk ka zot përveç All-llahut ka zgjatur trembëdhjetë vjet, gjatë së cilës nuk ka ekzistuar qëllim tjetër përveç këtij: nënshtrimi Atij dhe pushtetit të Tij. E, kur shpirtërat e tyre u bënë të pastër dhe sinqerisht të dorëzuar ndaj All-llahut dhe të atillë që nuk gjenin zgjidhje tjetër për veten përveç asaj që zgjidhte për ta All-llahu, atëherë filluan ngarkesat, mes të cilave ishin edhe adhurimet. Atëherë, po ashtu, filloi pastrimi i fundërrinave të xhahilijetit; shoqëror, ekonomik, shpirtëror, moral, etik... Detyrimet filluan në çastin kur u bë një gjëndje e atillë: kur All-llahu urdhëron, robërit (njerëzit) binden pa farë kundër-shtimi, ngasa ata nuk kërkojnë për vete zgjidhje në atë që u urdhëron ose ua ndalon All-llahu, çfarëdoqoftë kjo."

E DYTA: QËNDRIMI I SUNETIT TË PASTËR PEJGAMBERIK

I Dërguari i All-llahut sal-lall-llahu alejhi ue sel-lam e ka theksuar ndalesën e alkoolit nga shumë aspekte:

1. E ka përshkruar si "çelësi i çdo të keqeje" dhe "nëna e të gjitha të këqijave"

Nga ibni Abbasi radijall-llahu anhu transmetohet se ka thënë: "I Dërguari i All-llahut sal-lall-llahu alejhi ve sel-lam ka thënë: "Shmangiuni alkoolit, ngase ai është çelësi i çdo të keqeje!" (Shënon El-Hakimi)

Nga Abdull-llah b. Amri radijall-llahu anhu transmetohet se i Dërguari i All-llahut sal-lall-llahu alejhi ve sel-lam ka thënë: "Alkooli është nëna e zvetënimit dhe mëkati më i madh nga mëkatet e mëdha. Kush pi alkool, e lë namazin dhe (ndoshta) e çnjerëzon nënën e vet, tezen dhe hallën." (Shënon El-Taberani në "El-Mu'xhem el-Kebir")

2. E ka bërë të ndaluar sasinë e vogël të alkoolit, e të mos flitet për sasinë e madhe

Transmetohet nga Ibni Umeri radijall-llahu anhu se ka thënë: "I Dërguari i All-llahut sal-lall-llahu alejhi ve sel-lam ka thënë: "Ajo që deh në sasi të madhe është e ndaluar edhe në sasira të vogla."

Aishja radijall-llahu anha ka thënë: "I Dërguari i All-llahut sal-lall-llahu alejhi ve sel-lam ka thënë: "E tërë ajo që deh është e ndaluar (haram), kurse ajo që deh në sasi të një "ferku"[4], është e ndaluar edhe në masë të një grushti." (Shënon Ahmedi, Ebu Davudi, Et-Tirmidhiu, të cilët thonë se hadithi është i mirë, hasen)

3. E ka sqaruar shkakun e ndalimit të alkoolit: dehja

[4] Masa e quajtur "el-ferk" ose "el-ferek", por me fet'he është më e njohur, është masë prej 16 ratlash. Disa thonë se kjo masë përmban 16 ratla, nëse mendohet në "el-ferek" (me fet'he në shkronjën r), por nëse mendohet në "el-ferk" (me sukun në shkronjën r), atëherë kjo masë përmban 120 ratla.

Nga Ibni Umeri radijall-llahu anhu transmetohet se ka thënë: "I Dërguari i All-llahut sal-lall-llahu alejhi ve sel-lam ka thënë: "Gjithçka që deh është alkool (hamër), ndërsa çdo lloj alkooli është haram!" [5]

Nga Kajs b. Sa'd b. Ubade radijall-llahu anhu transmetohet se ka thënë: "E kam dëgjuar të Dërguarin e All-llahut sal-lall-llahu alejhi ve sel-lam se ka thënë: "Gjithçka që deh është alkool (hamër), ndërsa çdo lloj alkooli është haram dhe largohuni nga vera prej misri!" (Verën prej misri e bënin abisinasit dhe quhej "el-gubejra.")

Nga Aishja radijall-llahu anha transmetohet se ka thënë: "Është pyetur i Dërguari i All-llahut sal-lall-llahu alejhi ve sel-lam për verën prej mjalti, kurse jemenasit e pinin atë, e ai është përgjigjur: "Çdo pije që deh është haram!"[6]

Lidhur me këtë, po citoj atë që ka përmendur Sejjid b. Kutbi, e mëshiroftë All-llahu, në librin e vet të vlefshëm "Fi dhilali El-Kur'an", ku thotë: "Marramendja nga pija, çfarëdo pije qoftë ajo, është në kundërshtim me syçeltësinë (vetëdijen) e përhershme, të cilën e kërkon Islami nga zemra e muslimanit, në mënyrë që në çdo çast të jetë i lidhur me All-llahun. Pastaj, me ndihmën e kësaj vigjilence duhet të jetë faktor pozitiv për përparimin dhe për rimëkëmbjen e jetës, për mbrojtjen e jetës nga dobësitë dhe nga çoroditja, për ruajtjen e vetvetes, të pasurisë e të nderit të vet, si dhe për ruajtjen e sigurisë së bashkësisë islame, Sheriatit dhe rendit nga çdo lloj agresioni. Individi musliman nuk i është lënë vetvetes e as epsheve të tij, por është i ngarkuar me detyrime të

[5] Shënon Muslimi, Ahmedi, Ebu Davudi e të tjerë.

[6] Shënon Maliku, Ahmedi, Esh-Shafi'u, El-Buhariu, Muslimi dhe Ebu Davudi.

ndryshme që kërkojnë prej tij vigjilencë të përhershme. Ai ka detyrime ndaj Zotit, ndaj vetvetes, ndaj familjes, ndaj bashkësisë muslimane në të cilën jeton dhe ndaj mbarë njerëzimit, e kjo është që të thërrasë e të udhëzojë në Islam. Nga muslimani kërkohet që të jetë në vigjilencë të përhershme në mënyrë që të mund t'i kryejë këto detyrime, madje prej tij kjo kërkohet edhe kur kënaqet me gjërat e bukura të lejuara. Islami e detyron që të jetë i kujdesshëm dhe vigjilent ndaj këtyre kënaqësive dhe mos bëhet rob i kënaqësive ose epsheve. Ai përherë i kontrollon kërkesat e veta, i kënaq ato ashtu siç i kënaq ai që sundon situatën e vet. Marramendja (dehja) aspak nuk pajtohet me këtë drejtim.

Përveç kësaj, maramendja në esencën e vet është vetëm ikje nga realiteti jetësor në periudha të caktuara kohore dhe kredhje në imagjinata të cilat i nxit dehja dhe mahmurllëku. Islami ia mohon njeriut këtë rrugë dhe dëshiron nga njerëzit që t'i shohin faktet e realitetit e t'i dalin atyre përballë, të jetojnë me to e të mos e ndërtojnë këtë jetë mbi imagjinata ose iluzione. Dalja përballë fakteve të realitetit është thelbi i vendosmërisë dhe i vullnetit, ndërsa ikja nga ato në drejtim të imagjinatave e iluzioneve është rruga e lirimit nga detyrimet, dobësi e vullnetit dhe tretje e dëshirës. Islami përherë kujdeset për edukimin e vullnetit dhe lirimit të tij nga zgjedha e shprehisë dominante, pirja e alkoolit. Ky aspekt është vetiu i mjaftueshëm, nga pikëvështrimi i Islamit, që alkoolin dhe pijet e tjera dehëse t'i bëjë të ndaluara, e këto janë gjëra të neveritshme, vepra djalli dhe shkatërrojnë jetën e njeriut."

4. Ka ndaluar gjëra të tjera lidhur me alkoolin bashkë me pirjen e tij

Nga Enesi radijall-llahu anhu transmetohet se ka thënë: "I Dërguari i All-llahut sal-lall-llahu alejhi ve sel-lam i ka mallkuar dhjetë persona që kanë lidhje me alkoolin: atë që e shtrydh, kujt i

shtrydhet, atë që e pi, atë që e shërben, kujt i shërbehet, atë që e ofron, atë që e shet, atë që ushqehet me fitimin nga ai, kush e blen dhe atë prej kujt blihet."[7]

Nga Ebu Hurejra radijall-llahu anhu transmetohet se i Dërguari i All-llahut sal-lall-llahu alejhi ve sel-lam ka thënë: "All-llahu, me të vërtetë, ka ndaluar alkoolin dhe fitimin nga alkooli dhe ka ndaluar ngordhësirën dhe fitimin nga ajo, dhe ka ndaluar mishin e derrit dhe fitimin nga ai."[8]

Nga Ibni Ibni Abbasi transmetohet se ka thënë: "E kam dëgjuar të Dërguarin e All-llahut sal-lall-llahu alejhi ve sel-lam duke thënë: "Më erdhi Xhibrili e më tha: - O Muhamed, me të vërtetë All-llahu e ka mallkuar alkoolin, atë që e shtrydh, atë që e pi, atë që e shërben, kujt i shërbehet, kush e shet, kush e blen, kush e ofron dhe kujt i ofrohet."[9]

5. E ka mohuar imanin (besimin) e atij që pi alkool

Nga Ebu Hurejra radijall-llahu anhu transmetohet se i Dërguari i All-llahut sal-lall-llahu alejhi ve sel-lam ka thënë: "Në çastin kur bën kurvëri njeriu nuk është besimtar, vjedhësi gjatë vjedhjes nuk është besimtar dhe derisa (njeriu) pi alkool nuk është besimtar."[10]

---

[7] Shënon Ibni Maxhe dhe Et-Tirmidhiu.

[8] Shënon Ebu Davudi

[9] Shënon Ahmedi, El-Hakimi dhe El-Bejhekiu.

[10] Shënon El-Buhariu, Muslimi, Ebu Davudi, Et tirmidhiu dhe En-Nesaiu.

Nga Ebu Hurejra radijall-llahu anhu transmetohet se i Dërguari i All-llahut sal-lall-llahu alejhi ve sel-lam ka thënë: *"Nga ai që bën kurvëri ose pi alkool do të hiqet imani sikundër njeriu e heq këmishën përmbi kokë."*[11]

Nga Ibni Abbasi transmetohet se Resulull-llahu sal-lall-llahu alejhi ve sel-lam ka thënë: "Kush e beson All-llahun dhe Ditën e Gjykimit mos të pijë alkool; kush e beson All-llahun dhe Ditën e Gjykimit mos të ulet në tavolinën në të cilën pihet alkooli."[12]

6. Ka caktuar dënimin sheriatik (haddin) për atë që pi alkool

Nga Enesi radijall-llahu anhu transmetohet se i Dërguari i All-llahut sal-lall-llahu alejhi ve sel-lam, për shkak të pirjes së alkoolit ka zbatuar dënimin e goditjes me thupra palme dhe me këpucë, kurse Ebu Bekri godiste me 40 të rëna.[13]

7. Ka kërcënuar me vuajtje të dhembshme në ahiret atë që pi alkool

Nga Ebu Musa El-Eshariu radijall-llahu anhu transmetohet se Resulull-llahu sal-lall-llahu alejhi ve sel-lam ka thënë: "Tre veta nuk do të hyjnë në Xhenet: alkoolisti (pijaneci), ai që i shkëput lidhjet farefisnore dhe ai që i beson fallit (sihrit). Ai që vdes si alkoolist, All-llahu do t'i japë të pijë nga lumi i quajtur El-Gavta'." E kanë pyetur: "E ç'është është lumi "El-Gavta?" Ai është përgjigjur:

---

[11] Shënon El-Hakimi.

[12] Shënon Et-Taberaniu.

[13] Muttefekun alejhi.

"Ky është lumi që rrjedh nga organet seksuale të prostitutave, kurse kundërmimi i organeve seksuale të tyre do t'i trazojë banorët e Xhehenemit."[14]

Nga Ibni Abbasi radijall-llahu anhu transmetohet se ka thënë: "I Dërguari i All-llahut sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem ka thënë: "Nëse vdes alkoolisti si i tillë, do ta takojë All-llahun sikur të ishte adhurues i idhujve."[15]

Nga Abdull-llah b. Umeri radijall-llahu anhu transmetohet se i Dërguari i All-llahut sal-lall-llahu alejhi ve sel-lam ka thënë: *"Tre vetave All-llahu ua ka ndaluar hyrjen në Xhenet: alkoolistit, atij që është i padëgjueshëm ndaj prindërve dhe burrit që i lejon gruas së vet pavleshmërinë.*[16]

Nga Ibni Abbasi radijall-llahu anhu transmetohet se i Dërguari i All-llahut sal-lall-llahu alejhi ve sel-lam ka thënë: "Çdo gjë që është fermentuar është alkool, ndërsa çdo gjë që deh është haram. Ai që pi atë që deh, namazi i tij do të jetë i mangët dyzet mëngjese (ditë). Nëse pendohet, All-llahu do t'ia pranojë pendimin, e, nëse e përsërit këtë edhe për të katërtën herë, All-llahu do t'i japë të pijë nga ajo që del prej trupave të banorëve të Xhehenemit – tinetul habal." I Dërguari i All-llahut sal-lall-llahu alejhi ve sel-lam është pyetur: "E, ç'është ajo (tinetul-habal), o i Dërguari i All-llahut?" Ai është përgjigjur: "Qelbi i banorëve të Xhennemit."[17]

---

[14] Shënon Ahmedi, Ebu Ja'la, Ibni Hibani në *Sahihun* e vet dhe ky hadith konsiderohet për autentik.

[15] Shënon Ahmedi.

[16] Shënon Ahmedi dhe ky është versioni i tij i këtij hadithi; En-Nesaiu, El-Bezzari dhe El-Hakimi, i cili thotë se hadithi ka sened (zinxhir transmetuesish) autentik.

[17] Shënon Ebu Davudi dhe Et-Tirmidhiu.

Nga Ibni Umeri radijall-llahu anhu transmetohet se ka thënë: "I Dërguari i All-llahut sal-lall-llahu alejhi ve sel-lam ka thënë: "Kush pi verë në këtë botë e nuk pendohet për këtë (dhe nuk e braktis atë), atij nuk do t'i lejohet vera në ahiret."[18]

Pas gjithë asaj që u tha më sipër, mund të thuhet se ai që mohon se alkooli është i ndaluar, në realitet, thërret në mohimin e Sunetit dhe në mospërfilljen e rëndësisë së tij në Sheriat, ngase kjo është në pajtim me dëshirat dhe epshet e tij. Për këtë shkak do ta shohësh duke iu përveshur mënyrës së qortuar të diskutimit mbi gjërat e pakontestueshme duke i kënaqur kështu tekat e veta dhe duke i arsyetuar gabimet e veta.

E TRETA: QËNDRIMI I AS'HABËVE RRETH PËRDORIMIT TË ALKOOLIT

El-Buhariu transmeton nga Enesi radijall-llahu anhu se ka thënë: "Unë kam qenë ai që i kam afruar njerëzve alkool në shtëpinë e Ebu Talhasë, ndërsa alkooli që pinin atëbotë ka qenë prej hurmave. I Dërguari i All-llahut sal-lall-llahu alejhi ve sel-lam e ka urdhëruar tellallin që të bërtasë se alkooli është i ndaluar. Ebu Talha ka thënë: "Dil dhe derdhe atë!" Unë kam dalë dhe e kam derdhur alkoolin, e ai rridhte nëpër Medinë. Kështu kanë vepruar të gjithë as'habët e tjerë, All-llahu qoftë i kënaqur me ta!"

[18] Shënojnë të gjithë autorët e *Suneneve*, përveç Et-Tirmidhiut.

Transmetohet nga Ebu Se'idi radijall-llahu anhu se ka thënë: "I Dërguari i All-llahut sal-lall-llahu alejhi ve sel-lam ka thënë: "O njerëz, All-llahu me të vërtetë e urren alkoolin dhe All-llahu (ndoshta) do të shpallë për të shpalljen. Kushdo që ka alkool, le ta shesë atë, në mënyrë që të ketë leverdi nga ai." Ebu Se'idi thotë: "Nuk kaloi shumë kohë dhe i Dërguari i All-llahut sal-lall-llahu alejhi ve sel-lam tha: "Me të vërtetë All-llahu e ka ndaluar alkoolin, prandaj ai tek i cili është gjetur alkooli gjatë shpalljes së këtij ajeti nuk pi alkool dhe nuk e shet atë." Njerëzit që kishin alkool dolën në rrugët e Medinës dhe e derdhën të gjithin."[19]

E KATËRTA: IXHMA – KONSENSUSI

Dijetarët janë pajtuar me konsensus rreth asaj se alkooli është i ndaluar – haram, kështu që disa prej tyre kanë thënë se All-llahu nuk ka ndaluar asgjë më ashpër sesa alkoolin. Për këtë shkak dijetarët thonë se ai musliman që mohon se alkooli është i ndaluar, pasi kjo është vërtetuar me Kur'an, me Sunet dhe me ixhma, konsiderohet si renegat, meqë ka mohuar diçka shumë të njohur në besim.

[19] Shënon Muslimi.

A KA DOBI NË ALKOOL

Disa njerëz thonë se në alkool ka dobi duke marrë si argument Fjalët e të Lartmadhërishmit për alkoolin: "Të pyesin ty për verën dhe bixhozin. Thuaj: "Në to ka mëkat të madh, por edhe dobi për njerëzit; mirëpo, mëkati (dëmi) është më i madh sesa dobia prej tyre!" (El–Bekare: 219) Për këtë ata thonë: "Ne pimë alkool ngase në të ka dobi, siç e ka theksuar ajeti."

Duke u mbështetur në All-llahun, unë them: Dobitë që mund t'i ketë njeriu nga përdorimi i alkoolit nuk e arsyetojnë konsiderimin se pirja e alkoolit është e lejuar dhe se dëmi nga ai pasqyrohet në humbjen e besimit, të kësaj jete dhe të jetës në ahiret.

Është e vlefshme të përmendet se përqindja më e madhe e përdorimit të alkoolit është në aspektin e alkoolit etilik, ndërsa si i tillë është e mundur që ai të përdoret në shumë mënyra, për çka do të bëhet fjalë. Ne do të përmendim disa aspekte të dobive që ka njeriu nga përdorimi i alkoolit.

Disa nga këto dobi janë:

- Fitimi material që ka një grup njerëzish, d.m.th ata që merren me shitjen e alkoolit;

- Dobia momentale, siç është ndjenja e përkohshme e ngrohtësisë dhe e maramendjes, shtytja e urinës (ujët e hollë), e ëmbëlsisë, e oreksit dhe e guximit për shkak të zhdukjes së turpit, i cili për shkak të alkoolit zhduket shumë shpejt;

- Përdorimi i alkoolit në mjekësi, farmaceutikë dhe në industri të tjera kimike.

Tani do t'ia jap rastin doktor Ferid El-Muhtediut, profesor-bashkëpunëtor në Fakultetin Farmaceutik të Universitetit të Mbretit Saud në Riad, që të na japë fragmentin më të rëndësishëm të përdorimit të alkoolit etilik në mjekësi dhe në industri.

PËRDORIMI I TIJ NË MJEKËSI DHE NË FARMACEUTIKË

Alkooli etilik me përqendrim rreth 70% përdoret me ujë si lëndë dezinfektuese. Përdorimi i tij më i rëndësishëm është dezinfektimi lokal i lëkurës, veçanërisht gjatë dhënies së injeksionit, ngase ai shkatërron mikrobet. Mënyra në të cilën vepron alkooli në koncentrim me ujin është shformimi i proteinës në bakterie dhe pengimi i formimit të energjisë në të. Po kështu, alkooli përdoret në sterilizim, siç është sterilizimi i mjeteve ndihmëse kirurgjike, i termometrave e të ngjashme.

Ky alkool më së shumti përdoret si hollues i shumë lëndëve organike e kimike, si edhe i atyre joorganike dhe konsiderohet si hollues i dytë botëror pas ujit. Për këtë arsye përdoret për tretjen e vajrave eterike (të avullueshme), të balsameve dhe të bojërave.

Gjithashtu, përdoret për gatitjen e disa ilaçeve si hollues i shumë lëndëve, ngase hyn në përbërjen e shumë përzierjeve, tretjeve, tinkturave e të tjera.

Po kështu, përdoret si lëndë parësore (bazore) në gatitjen e disa materieve mjekësore, siç është "eteri", i cili përdoret për anestezi, dhe "acetaldehyde", i cili përdoret për konservimin (ruajtjen) e

disa materieve. Duhet përmendur se shumica e këtyre mënyrave të përdorimit kanë filluar të humbasin rëndësinë e tyre me paraqitjen e thirrjeve paralajmëruese (sinjalizuese) për përdorimin e alkoolit në industrinë farmaceutike dhe zëvendësimin e tij me ujë dhe me hollues të tjerë.

PËRDORIMI I ALKOOLIT NË PRODHIMIN E AROMAVE DHE LËNDËVE AROMATIKE

Alkooli përdoret për gatitjen e të gjitha llojeve të aromave (parfumeve), siç janë: kolonja, parfumi, parfumet e koncentruara (të forta) e të ngjashme. Po kështu, hyn në përbërjen e lëndëve aromatike, siç është sapuni aromatik, dhe lëndëve të tjera që përdoren si stoli.

PËRDORIMET E TJERA TË ALKOOLIT

Përdoret në prodhimin e llaçit, bojërave, plastikës etj.

Gjithashtu përdoret si lëndë djegëse për djegie të brendshme te makinat dhe raketat, si antifriz dhe për gatitjen e një numri të madh bashkëdyzimesh kimike, siç janë thartësirat organike etj., me ndihmën e oksidimit.

PËRDORIMI I ALKOOLIT SI ILAÇ

Nga i Dërguari i All-llahut sal-lall-llahu alejhi ve sel-lam transmetohet një hadith autentik se e ia ka ndaluar alkoolin Terik El-Xhaf'iut kur e ka pyetur për të dhe kur ka thënë: *"Unë e përgatis alkoolin për shkak të shërimit."* I Dërguari i All-llahut sal-lall-llahu alejhi ve sel-lam i është përgjigjur: *"Alkooli nuk është ilaç, porse është sëmundje.",* që vë në pah ndalimin e alkoolit si ilaç.

Unë nuk kam zbuluar se alkooli trajtohet si ilaç përveç, sipas dijenisë sime, në dy raste:

- Në rast të helmimit me metanol, i cili mund të shkaktojë verbimin, helmimin e muskulit të zemrës ose vdekjen, madje edhe nëse merret në sasira të vogla. Në këtë rast jepet alkooli etilik përmes venës në sasi të caktuar në mënyrë që të dobësohet fuqia e ndikimit të helmimit me metanol duke ngadalësuar kështu tretjen e tij në organizëm dhe pastaj nxjerrjen e shpejtë të tij jashtë organizmit përmes urinës dhe frymëmarrjes. Mirëpo, falë All-llahut të Lartmadhërishëm, kemi ardhur deri te zbulimi i një mënyre tjetër të eliminimit të helmimit të gjakut me metanol, kështu që përdoret aparati për hemodializën e gjakut ose për dializën peritonale.

- Për shërimin e lindjes së parakohshme, pasi alkooli pengon strukjen e mitrës. Falë All-llahut xhel-le shanuhu, për dhuntitë dhe mëshirën e Tij, është larguar nga muslimanët kjo vështirësi, duke ua mundësuar dijetarëve që në vitin 1980 të zbulojnë një ilaç të ri me emrin retodrin, i cili e zëvendëson alkoolin etilik me efikasitet më të madh duke mos shkaktuar pasojat e tjera që i shkakton alkooli te nënat dhe tek embrio-net.

PJESA E DYTË
ALKOOLI, ILUZIONET, GËNJESHTRAT

Kjo pjesë e librit ngërthen në vete disa konfirmime dhe iluzione të përhapura ndër njerëz, por që i ka nxjerrë në shesh mjekësia bashkëkohore në mënyrë që ta vërtetojë të vërtetën e përhershme, e kjo është se Ai i Cili e ka ndaluar alkoolin, i Gjithëdijshmi, i Urti, i Cili është i informuar për çdo gjë, i Cili është i lartësuar e i lavdëruar, thotë në Kur'an:

"E si të mos dijë Ai i Cili krijon, i Cili i di të gjitha hjollësisht dhe i Cili është i informuar hollësisht për të gjitha?!" (El–Mulk: 14), dhe thotë: "Ne, do t'u dëftojmë atyre argumentet Tona në hapësirat e Gjithësisë, si dhe tek ata vetë, derisa t'u bëhet plotësisht e qartë se ai (Kur'ani) është i vërtetë. Vallë, a nuk të mjafton ty ajo që Zoti yt është, me të vërtetë, i informuar për çdo gjë?!" (Fussilet: 53)

Më të rëndësishme janë këto konfirmime:

POHIMI I PARË
DISA NJERËZ NGA MOSDIJA KONFIRMOJNË SE ALKOOLI (VERA) E ÇEL OREKSIN, PRANDAJ NJERËZIT E PINË ATË GJATË NGRËNIES

MENDIMI I MJEKËSISË: Disa studime e kanë vërtetuar dhe e kanë argumentuar se alkooli i koncentruar 85% ose më pak e nxit stomakun që të sekretojë lëngun e stomakut, kurse një lloj i atij lëngu është acidi klorhidrik. Në rast se koncentrimi i alkoolit arrin përqindjen prej 14-27%, atëherë strukturën ku më të cilën është i mbështjellë muri i stomakut e përfshin plagosja dhe shkatërrimi si pasojë e ndikimit të kësaj thartësire, gjë që më në fund shkakton inflamacion të madh krahas prishjes së pjesës së lartë të kanalit tretës.

Në rastin kur njeriu pi gjithnjë alkool, stomaku sëmuret nga atrofia, ndërsa sasia e lëngut të stomakut fillon të pakësohet, që në fund rezulton me atë se pijaneci e humbet oreksin. Ia vlen të përmendet se alkooli ndikon në lëvizjen e zorrëve, që sërish shkakton çrregullime të fuqishme në tretjen e ushqimit, për shkak të të cilave ndonjëherë njeriu nuk është në gjendje që të hajë diçka.

POHIMI I DYTË
DISA NJERËZ NGA MOSDIJA POHOJNË SE ALKOOLI I JEP ENERGJINË E NGROHTË NJERIUT, E CILA E MBRON NGA TË FTOHTËT

MENDIMI I MJEKËSISË: Procesi i nxerrjes së organizmit zhvillohet me ruajtjen e temperaturës së tij trupore, e cila i nevojitet për mirëmbajtjen e funksioneve vitale, porse shumica e ngrohtësisë shpërndahet në ajrin që rrethon trupin, përveç një sasie të vogël.

Alkooli shkakton një ndjenjë afatshkurte të ngrohtësisë, e cila kalon shpejt. Shkaku i kësaj është veprimi i alkoolit te damarët e gjakut, të cilët gjenden nën sipërfaqen e lëkurës, që shkakton zgjerimin e tyre, që sërish lejon që sasia më e madhe e gjakut të rrjedhë në pjesët sipërfaqësore të lëkurës dhe kjo manifestohet p.sh. në trajtën e skuqjes së fytyrës.

Nga shkaku se gjaku e mirëmban temperaturën e brendshme të trupit, pijaneci në fillim ndien ngrohtësi, porse kjo ndjenjë së shpejti humb për shkak të lirimit të ngrohtësisë trupore jashtë trupit. Atëherë njeriu ndien ftohtësi dhe e kaplojnë të dridhurat. Alkooli, gjithashtu, nuk është ushqim i vërtetë që mund t'ia kompensojë trupit temperaturën (ngrohtësinë) që ka humbur. Për këtë shkak alkoolistët janë më së tepërmi të ekspozuar ndaj gripit, ftohjes, pezmatimit të mushkërive dhe sëmundjeve të tjera. Raste të papandehura e të shpeshta vdekjeje në Evropë, që ndodhin pas festimit të Vitit të Ri, gjithashtu paraqesin argument të konfirmimit paraprak. Në realitet, njerëzit atëherë kalojnë pjesën më të madhe të natës duke pirë alkool e pastaj dalin në ajër të ashpër dhe shumë të ftohtë dhe palosen përtokë njëri pas tjetrit.

TRAJTIMI ISLAM I KËTIJ POHIMI: Duke e vërtetuar këtë fakt Islami ka kaluar shkencën bashkëkohore më tepër se 1400 vjet. Kështu, me një rast, kur Resulull-llahut sal-lall-llahu alejhi ve sel-lam i erdhi një delegacion nga Jemeni, u ngrit Dejlem El-Himejri dhe e pyeti Resulull-llahu sal-lall-llahu alejhi ve sel-lam, duke thënë: *"O i Dërguari i All-llahut, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lam , ne jemi nga viset e ftohta dhe ne në vendin tonë punojmë punë të rënda, prandaj pimë pije që i gatitim nga gruri dhe me to forcohemi në punët tona dhe përballojmë të ftohtin."* I Dërguari i All-llahut sal-lall-llahu alejhi ve sel-lam e pyeti: *"E, a deh kjo pije?" "Po",* u përgjigj ai, kurse i Dërguari i All-llahut sal-lall-llahu alejhi ve sel-lam tha: *"Atëherë largojuni asaj!" "Por njerëzit nuk do ta lënë atë!"*, tha ai. Atëherë i Dërguari i All-llahut sal-lall-llahu alejhi ve sel-lam tha: *"Nëse nuk heqin dorë nga ajo, atëherë luftoni kundër tyre!"*[20]

Në vitin 1928, në qytetin belg Anvers, është mbajtur Kongresi i Nëntë Ndërkombëtar për ndalimin e pijeve dehëse, në rendin e ditës të të cilit ka qenë diskutimi rreth temave të ndryshme lidhur me alkoolin. Në kongres është ngritur një doktor i madh, punonjës në Vjenë, Austri, e ka thënë: *"Disa mjekë, të cilët kanë këshilluar që të merren disa gllënka pijesh alkoolike si mbrojtje nga të ftohtët, kanë bërë gabim të madh shkencor, ngase u është dukur nga ndikimi i jashtëm se alkooli e ngre temperaturën trupore tek ata që e pinë."* Ky doktor, në vazhdim, tha: *"Ndjenja e ngrohtësisë në këtë rast është ndjenjë e rrejshme, ngase pas kësaj pason ulja e temperaturës trupore."*

Pastaj është hapur diskutimi dhe një dijetar ka thënë: "Banorët e Islandës – e Islanda është nga vendet më të ftohta – në mbrojtje pijnë pije alkoolike. Pastaj numri i rasteve të vdekjes në mesin e tyre është rritur në ato përmasa, saqë i ka brengosur njerëzit përgjegjës formuan një komision për hulumtimin e kësaj dukurie. Komisioni ka ardhur në përfundim se shkaku i rritjes së

[20] Shënon Ebu Davudi.

vdekshmërisë në ujdhesë është pirja e alkoolit. Gjaku nga brendia e trupit dilte në sipërfaqe të lëkurës dhe ajri e ftohte gradualisht përderisa nuk ftohej i tërë gjaku, dhe kështu jeta shuhej me zhdukjen e ngrohtësisë. Kjo dukuri e ka shtyrë parlamentin e Islandës që të nxjerrë ligjin, me të cilin në Islandë ndalohet alkooli."

Pastaj është ngritur përfaqësuesi i Suedisë dhe ka thënë: "Dëshiroj t'ua tërheq vërejtjen pjesëmarrësve të kongresit në atë që i ka ndodhur Doktor Skotit dhe shoqërisë së tij kur ishin në një ekspeditë për vëzhgimin e Polit Jugor. Skoti ka kuptuar çfarë ndikimi të madh ka alkooli në të ftohtë, prandaj u ka propozuar shokëve të vet që të mos pinë alkool, në mënyrë që trupat e tyre të mos e humbasin aftësinë e përballimit të të ftohtit. Kur shokët e tij harruan këshillën dhe iu përveshën shisheve të uiskit, pasoja, siç shënon doktor Skoti në kujtimet e veta, ishte se, ata që iu përmbajtën këshillës së tij dhe nuk pinë alkool i kanë ikur vdekjes, kurse të tjerët kanë vdekur." Pastaj është ngritur përfaqësuesi i Egjiptit, doktor Ahmed Galvashi, e ka thënë: "Muslimanët janë të mbrojtur nga viktimat e njerëzimit, për të cilat kanë tërhequr vërejtjen pjesëmarrësit e kongresit, për arsye se i përmbahen urdhërit të fesë së tyre dhe të të Dërguarit të tyre, Muhammedit sal-lall-llahu alejhi ve sel-lam, ngase ai ua ka tërhequr vërejtjen që të mos pinë alkool dhe u ka sqaruar se alkooli nuk bën dobi në të mbrojturit nga të ftohtët." Pastaj ua ka lexuar përkthimin e hadithit, të cilin e transmeton Dejlem El-Himjeri. Kjo i ka befasuar pjesëmarrësit e kongresit dhe me miratim e me duartrokitje i kanë pranuar fjalët e tij dhe duke kërkuar nga ai që t'ua citonte hadithin, të cilin e kanë vlerësuar si mënyrën e drejtë për mbrojtjen nga të ftohtët.

Për sa i përket doktor Muhammed Ali El-Bara'it, ai thotë: "Faktori më i rëndësishëm i uljes së temperaturës trupore, i shkaktimit të vdekjes dhe i humbjes së vetëdijes është alkooli, siç qëndron

në revistën mjekësore të Amerikës Jugore, në numrin e janarit të vitit 1984." Doktor Ali El-Bara'i më tej thotë: "Alkooli e shkakton këtë në shumë mënyra. E para, alkooli zgjeron damarët e gjakut në sipërfaqe të lëkurës dhe kështu njeriu humbet sasira të mëdha të temperaturës trupore në ajrin e ftohtë. E dyta, alkooli pengon procesin e transformimit të sheqerit të akumuluar në glukozë, pastaj glukozën në energji që bëhet me anë të oksidimit. E treta, alkooli pengon të dridhurat dhe vërgëllimat e trupit, që ndodhin në ajër të ftohtë, e ky është proces tejet i rëndësishëm, ngase me këtë transformohet një sasi e madhe e sheqerit të akumuluar në energji. E katërta, alkooli rrjedh në pjesën e trurit përgjegjëse për rregullimin e temperaturës trupore dhe e paralizon atë. E pesta, njeriu i dehur e humbet aftësinë e të kuptuarit dhe të gjykimit dhe shpeshherë në Perëndim mund të shihen njerëz të dehur, e veçanërisht gjatë Krishtlindjeve dhe Vitit të Ri, se si bredhin parqeve e rrugëve, flenë në hapësirë të hapur, e aty temperatura e ajrit zbret nën zero.

Si pasojë e këtyre faktorëve pijaneci e humb vetëdijen, kurse trupi i tij e humb ngrohtësin. Temperatura trupore bie dhe ai vdes duke ndierë ngrohtësinë e rrejshme. Për këtë arsye hulumtimet bashkëkohore thonë se alkooli është shkaktari kryesor për shkak të të cilit ndodhin rastet e rënies së befas-ishme të temperaturës trupore. Përqindja e vdekjes në këto raste sillet rreth 30% dhe 80%, e kjo varet nga shpejtësia e largimit të pijanecit nga vendi i ftohtë, shkalla e ftohtësisë së ajrit dhe shpejtësia e shkathtësia (saktësia) e shërimit."

POHIMI I TRETË
DISA NJERËZ POHOJNË SE ALKOOLI KA DOBI SHËNDETËSORE, E VEÇANËRISHT PËR TË SËMURËT NGA ZEMRA, MEQË ËSHTË VËRTETUAR SE ALKOOLI ZGJERON DAMARËT E GJAKUT!

MENDIMI I MJEKËSISË: Më sipër pamë se alkooli shkakton zgjerimin e damarëve të gjakut, të cilat gjenden nën sipërfaqen e lëkurës, derisa ndikon për kundërtën tek enët e gjakut që furnizojnë muskulin e zemrës, të njohura si koronat e arteries. Alkooli shkakton gëlqerizimin e arterieve (arteriosklerozën), kështu që shkaktohet rritja e yndyrërave në gjak, siç është kolesteroli dhe glicerina – alkooli trihidroksil -, i cili, sërish, fundërron në muret e enëve dhe shkakton gëlqerizimin dhe ngushtimin e tyre, që së fundi shpie në varfërimin e furnizimit të zemrës (me gjak) – IHD, e veçanërisht shpie në shtrëngimin e gjoksit dhe në spazmat e zemrës – angina pectoris – e mund të shkaktojnë edhe zënien e zemrës – myocardial infarcetion.

Doktor Adnan Esh-Sherifi, në një artikull të botuar në revistën "El-Fikru el-islami" (Mendimi islam), thotë: "Disa mjekë, para se të ishin të sigurtë e të bindur nga aspekti i mjekësisë, i kanë këshilluar disa që lëngojnë nga zemra, të sëmurë nga mefshtësia (ngathtësia) e koronares së arteries, që për çdo natë të pinë nga një gotë alkool, më saktësisht, nga një gotë uiski, duke konsideruar se alkooli e zgjeron koronaren e arteries dhe pengon sulmet e angina pectorisit - spazmave të zemrës.

Cili ishte rezultati?

Rezultati ishte i padobishëm, e në shumicën e rasteve edhe i përkundërt, meqë pikërisht këtyre mjekëve, të cilët u paraqitën me këtë risi mjekësore, iu vërtetua se alkooli i zgjeron arteriet e rëndomta të cilat nuk janë të ngushtuara për shkak të arteriosklerozës.

Në këtë situatë, në vend se të rritet sasia e gjakut që arrin në zonat e muskujve të zemrës, gjaku pakësohet gjatë pirjes së alkoolit, i cili vetëm i zgjeron arteriet e tjera të shëndosha të zemrës, të cilat i furnizojnë zonat muskulare, të cilave në fakt nuk u duhet ndonjë sasi e shtuar e gjakut nga ajo që kërkon vetë funksioni i tyre, e kjo në fjalorin mjekësor është e njohur si "rast vjedhjeje".

Falë kësaj "diagnoze të kadifenjtë bashkëkohore", e nën gunën e sëmundjes dhe të udhëzimeve të mjekëve të drejtuara pijanecëve, një gotë alkooli ka kaluar në dy, pastaj në tre, e më në fund në tërë shishen, e më pas në alkoolizëm të hapët."

Doktor Muhammed El-Hatibi thotë: "Që nga kohët e lashta ka qenë e përhapur bindja se alkooli zgjeron arterien koronare të zemrës. Hulumtimet bashkëkohore në fushën e mjekësisë kanë vërtetuar se alkooli nuk ka ndikim të drejtpërdrejtë në arterien koronare të zemrës, kurse dhembjet fillojnë për shkak të angina pectorisit - spazmave të zemrës – duke lejuar si rezultat ndikimin e alkoolit si anestetik në qendrat e dhembjes në trurin e njeriut.

Hulumtimet bashkëkohore, gjithashtu, kanë vërtetuar se alkooli, në rast të zmadhimit të sasisë së tij, shkakton mbylljen dhe rraskapitjen e muskulit të zemrës, ngase alkooli në përqindje prej 1% në gjak shkakton rritjen e të rrahurave të zemrës me dhjetë të rrahura në një minutë. Për shkak të këtyre faktorëve i sëmuri ndonjëherë ndien pushim dhembjesh dhe ëndje iluzioniste dhe e braktis shtratin, në mënyrë që t'i ekspozohet vdekjes.

Për këtë arsye, mjekët e kohës së sotme (bashkëkohore) i rekomandojnë çdo njeriu të sëmurë nga angina pectoris-i që të heqë dorë nga pirja e alkoolit dhe e duhanit."

Ndërsa Doktor Muhammed Ali El-Barai thotë: "Hulumtuesit kanë zbuluar se nëse 200 mililitra uiski do t'i jepeshin të sëmurit që vuan nga angina pectoris-i, kjo do t'ia aktivizonte menjëherë këtë sëmundje dhe do të paraqiteshin rezultatet në EKG-në e zemrës. Kjo nxjerr sheshit se dhënia e alkoolit si ilaç është iluzion i rrezikshëm pa kurrfarë bazash. Përkundrazi, alkooli shkakton zmadhimin e kësaj sëmundjeje, e ndonjëherë shkakton edhe infarktin."

Ai, pastaj, thotë: "Hulumtimet mjekësore kanë treguar se 200 mililitra uiski ndonjëherë shkaktojnë zbritjen e funksionit të zemrës 205, siç ka vërejtur Rejani, kurse 600 mililitra uiski shkaktojnë te barkushja e majtë e zemrës pamundësinë e pompimit.

Hulumtues të tjerë kanë vërejtur rritjen e vërshimit të gjakut në mushkëri pas pirjes së alkoolit, e kjo është simptomë e rraskapitjes së zemrës."

Hulumtuesit Nooti dhe Birdi pohojnë se alkooli, jo vetëm që shkakton, por edhe e rrit përqindjen e sëmundjes nga angina, pra sulmet e dhembjeve në kraharor që i ndodhin njeriut kur gjendet duke ndenjur pa lëvizur, veçanërisht natën. Këto sulme i përcjellin ndërrimet e kohëpakohshme të EKG-së së zemrës, që rezulton me ngushtimin e njërës nga arteriet kryesore koronare, të cilat e furnizojnë (me gjak) muskulin e zemrës. Për këtë shkak nuk ekziston ndonjë shkak i arsyetuar logjikisht që alkooli t'i përshkruhet si ilaç të sëmurit që vuan nga angina pectoris-i.

Kjo lloj sëmundjeje konsiderohet si e rrezikshme, e rrit përqindjen e vdekjeve të befasishme (sudden death) dhe për këtë shkak nuk ka ndonjë shkak të arsyeshëm logjik që alkooli t'i përshkruhet si ilaç të sëmurit që vuan nga angina pectorisi.

Disa hulumtime kanë treguar se alkooli e rrit përqindjen e yndyrërave të shkallës ë lartë të dendësisë në gjak (HDL).

Disa nga treguesit që vërtetojnë rolin e alkoolit në gëlqerizimin e arteries dhe në varfërimin e tajitjes së zemrës janë si vijon:

- pirja e njëkohësishme e alkoolit dhe e duhanit dhe kjo e dyta konsiderohet nga faktorët e rëndësishëm në sëmundjen e varfërmit të furnizimit të zemrës (me gjak);

- roli i alkoolit në rritjen e përqindjes së sëmundjes së shtypjes së gjakut, që konsiderohet nga faktorët më të rëndësishëm të sëmundjes së varfërimit të furnizimit të zemrës;

- roli i alkoolit në rritjen e yndyrës në gjak (Hiperlipidemia), që ndihmon në fundërimin e yndyrërave në muret e enëve të gjakut, që, sërish, sjell deri të gëlqerizimi i këtyre enëve, e pastaj te sëmundja nga varfërimi i furnizimit të zemrës.

Për sa i përket profesorit Braunuald, njërit nga specialistët më të njohur të sëmundjeve të zemrës në botë dhe autorit të librit "Sëmundjet e zemrës", ai në librin e tij thotë: *"Megjithëse ekzistojnë disa hulumtime, të cilat kanë treguar se alkooli e ngre përqindjen e yndyrës së dendësisë së madhe, unë assesi nuk këshilloj përdorimin e alkoolit si ilaç preventiv për sëmundjen e furnizimit të varfër të zemrës (me gjak)."*

Doktor Ahmed Tahai, konsultor për sëmundjet e zemrës në Spitalin Qendror në Riad, duke u përgjigjur ndaj pyetjes: *A mbron pirja e alkoolit nga sulmet e zemrës?*, përgjigjet: *"Kohë pas kohe na vijnë revista periodike mjekësore me ndonjë studim, në të cilin autori i tij pohon se një sasi e vogël e alkoolit e përmirëson gjendjen e zemrës dhe mbron nga sulmet e zemrës. Se në alkool ekzistojnë disa dobi, ky është fakt për të cilin nuk ka kundërshtim, ngase All-llahu i Lartmadhërishëm, i Urtë dhe i Gjithëdijshëm na ka informuar se në të ka dobi, porse në suaza të* ajetit të përjetshëm vërtetohet se mëkati dhe dëmi nga alkooli e tejkalojnë dobinë. I Lartmadhërishmi thotë: "Të pyesin ty për verën dhe bixhozin. Thuaj: "Në to ka mëkat (dëm) të madh, por edhe dobi për njerëzit; mirëpo, mëkati (dëmi) është më i madh sesa dobia prej tyre!" (El–Bekare: 219)

Shumica e studimeve, nëse jo edhe të gjitha, të cilat pohojnë se alkooli mbron nga sulmet vdekjeprurëse dhe jovdekjeprurëse të zemrës, mbështeten në krahasimin e atyre që pinë alkool në sasira të vogla, të mesme dhe të mëdha dhe të atyre që kanë pushuar së piri alkool pasi e kanë bërë këtë për një kohë të caktuar dhe që tanimë kanë përjetuar sulm në zemër, me grupin e njerëzve nga katër llojet e përmendura tanimë, por që nuk kanë përjetuar sulm në zemër. Në këtë lloj hulumtimesh, të cilat janë të njohura me emrin "Hulumtimet e mesatares horizontale", ndonjëherë mund të zbulohet lidhmëria ndërmjet dy gjërave, porse nuk mund të vërtetohet. Këtë mund ta bëjë studimi i mesatares vertikale, e ky është studimi i një grupi njerëzish gjatë viteve dhe ku shënohen paraqitjet e sëmundjeve si lëndë hulumtimi.

Në mënyrë që ta argumentojmë dallimin mes kuptimit (domethënies) të studimit vertikal dhe horizontal, do të marrim shembullin vijues: Ndonjëherë dikush mund t'i krahasojë ata që vdesin në rrugë me ata që vdesin në shtrat dhe të shohin se numri i atyre që vdesin në shtrat është më i madh se ata që vdesin në rrugë. Kështu vijnë në përfundim se qëndrimi në shtëpi është më

pozitiv se dalja në rrugë. Ky është studim horizontal, i cili ka shpënë në rezultate të pasakta, e, sikur studiuesi të kishte përcjellë ndonjë grup njerëzish, do të shihte se përqindja e njerëzve të shëndoshë që vdesin për çdo ditë në shtretërit e tyre është tejet e vogël dhe se ata që vdesin në shtretërit e tyre janë njerëz të cilët i ka penguar sëmundja e tyre që të dalin në rrugë dhe se ata që vdesin në fatkeqësitë rrugore janë njerëz të shëndoshë dhe, në shumicën e rasteve, të rinj. Ky shembull na sqaron se vetë të dhënat dhe statistikat, pa përdorimin e arsyes, ngandonjëherë na shpien në rezultate të gabuara.

Dhe tani të shqyrtojmë pyetjen kryesore, e cila është: A mbron alkooli nga sulmet e zemrës?

E PARA: Nuk guxojmë të harrojmë se studimet që janë bërë në Perëndim bëjnë krahasimin mes njerëzve të cilët pinë alkool dhe atyre që kanë pirë në të kaluarën. Këto studime nuk bëjnë krahasim mes atyre të cilët kanë pirë alkool, meqë në Perëndim është rrallësi të gjendet dikush, përveç muslimanëve, që nuk ka pirë alkool bile një herë në jetën e tij. Sikur të ishte bërë krahasimi mes atyre që pinë alkool në sasira të vogla ose të mesme dhe të atyre që nuk e kanë pirë atë, asnjëherë, krahasimi do të vërtetonte se ata që nuk kanë pirë kurrë alkool janë më pak të ekspozuar ndaj sulmit të zemrës.

E DYTA: Në harmoni me shpalljet (informatat) e hulumtimit që janë bërë në këtë fushë, ata që pinë alkool në sasira të vogla dhe të mesme (të matura) janë ata që pinë alkool dy ose tre herë në ditë, e kjo sasi, padyshim, është e dëmshme për organet e tjera të trupit, e veçanërisht nëse pihet për një periudhë të gjatë.

E TRETA: Ndonjëherë dallimi mes atyre që pinë alkool në sasira të vogla ose të matura dhe atyre që pinë në sasira të mëdha është ajo që pirësit e alkoolit në sasira të mëdha, vdesin të rinj nga

sëmundje të tjera që i shkakton alkooli, madje para se t'i jetojnë vitet kur ndodhin sulmet e zemrës, e kjo nuk është e mundur të vërtetohet, përveçse me hulumtime vertikale.

E KATËRTA: Asnjë hulumtim vertikal nuk ka vërtetuar se alkooli mbron nga sulmet e zemrës, përkundrazi, hulumtime të tilla kanë vërtetuar se përqindja e të sëmurëve nga sulmet e zemrës tek ata që pinë alkool është më i madh, që është pasojë e rritjes së peshës trupore, rritjes së yndyrës dhe thertësirës në gjak, rritjes së shtypjes së gjakut, rrahja e çrregulluar e zemrës dhe çrregullimi i funksionit të barkushes së majtë. Për më tepër, studimi në fillim nuk e ka zbuluar ekzistimin e lidhjes së fortë në mes të gëlqerizimit të arterieve koronare, të cilat e furnizojnë zemrën (me gjak). Mirëpo, me vëzhgimin disavjeçar, janë vërtetuar rezultate negative të ndikimit të alkoolit në zemër dhe në arteriet koronare, që vërteton se një periudhë më e gjatë kohore është ajo e cila ka zbuluar ndikimin e alkoolit në zemër, që sërish vërteton përparësinë e hulumtimit vertikal kundrejt atij horizontal.

E PESTA: Alkooli nuk shkakton vetëm vdekjen e befasishme për shkak të gëlqerizimit të arterieve koronare, e pastaj sulmet e zemrës, por shkakton vdekjen e befasishme si pasojë e rrahjeve joritmike të zemrës, edhe përkundër aterieve të shëndosha konorare, nga shkaqet të njohura si sëmundje të muskulit të zemrës dhe të tjera ende të panjohura.

E GJASHTA: Disa konfirmojnë se alkooli, nëse pihet në sasira të vogla dhe të mesme, zvogëlon mundësitë e ekspozimit të atij që e pi, ndaj sulmeve të zemrës, pasi rritet përqindja e kolesterolit të dendësisë së madhe në gjak, i cili karakterizohet si mbrojtës nga gëlqerizimi i arterieve. Mirëpo, ekzistojnë faktorë të tjerë të cilët shkaktojnë rritjen e koresterolit të dendësisë së vogël, i cili karakterizohet si i dëmshëm për zemrën ose shkakton rënien e përqindjes së kolesterolit të den-

dësisë së madhe, siç është tendosja psikike dhe nervore, që nuk është e mundur të vlerësohet në hulumtime të tilla. Pijaneci në shoqëritë perëndimore bie në kësi situatash duke ikur nga detyrimet e jetës dhe duke i kërkuar kënaqësi jetës së tij të rëndë.

E SHTATA: Ekzistojnë studime që vënë në pah se rritja e përqindjes së kolesterolit të dendësisë së madhe te pijanecët është rezultat i mbeturinave (thërrmijëzave) të pemëve prej të cilave është përgatitur alkooli, e nuk është rezultat i vetë alkoolit. Pemët dhe perimet përmbajnë në vete lëndë të oksiduara të cilat veprojnë duke zbritur kolesterolin me dendësi të vogël dhe rritin kolesterolin me dendësi të madhe. Por, përse ndikimi i kësaj nuk paraqitet tek ata që pinë alkool në sasira të mëdha?

Në rastet e shumta ndikimi i kolesterolit me dendësi të madhe në gjak pengon rritjen e peshës trupore dhe shkakton çrregullim në funksionimin e mëlçisë, e cila ka rol tejet të madh në rregullimin e yndyrërave.

Në studimin e vet, nën titullin "Ndikimi i alkoolit në zemër", të prezantuar në Kongresin e Parë të Mjekësisë Islame, të mbajtur në Kuvajt në vitin 1401 sipas hixhretit, doktor Sulltan Ahmedi thotë: "Edhe përkundër asaj se ndikimi helmues në zemër dhe ndikimi i mëlçisë është shumë i njohur, pirja e alkoolit për qëllime shoqërore dhe shtytje mjekësore është bërë shumë i përhapur. Ka ekzistuar mendimi se sasira të vogla të alkoolit nuk shkaktojnë helmimin dhe sëmundjen e organeve, prandaj nuk është lejuar të ndalohet alkooli. Për këtë arsye, unë e bëra këtë studim në mënyrë që të vlerësoj ndikimin helmues të alkoolit në zemër për sasitë e alkoolit që nuk janë helmuese për njeriun e shëndoshë dhe kam studiuar ndikimin e pirjes së alkoolit në njerëzit e sëmurë.

Duke pirë alkool në sasi prej 600 mililitrash, me koncetrim 43%, në kohëzgjatje prej një ore (grupi i parë) dhe dy orësh (grupi i dytë), te personat e rëndomtë të moshës 23-30 vjeç është shkaktuar çrregullim në funksionimin e zemrës.

Te grupi i parë, te njerëzit te të cilët niveli i alkoolit ka qenë rreth 74 miligramë, në çdo militër gjakut është rritur periudha para pompimit të gjakut nga 90 në 96 të qindat.

Koha e mosndërrimit (qëndrueshmërisë) të vëllimit është rritur nga 44 në 52 qindorë, ndërsa përpjesëtimi ndërmjet kësaj është rritur nga 0.299 në 0.323.

Kjo është rritur pas dy orësh pasi alkooli në gjak është shtuar në 111 miligramë, ndërsa me rritjen e shpejtësisë së pirjes së alkoolit (grupi i dytë) është shkaktuar ligështimi (kapitja) në funksionimin e barkushes së majtë pas tridhjetë minutash, duke qenë se përpjesëtimi i alkoolit në gjak ka qenë 50 miligramë në çdo 100 mililitra.

Grupi i tretë ka qenë grupi i krahasimit prej pesë personash, të cilëve u është dhënë sakarozë, pasi ka ndodhur rënie në të tre drejtimet e përmendura.

Për këtë arsye, pirja e alkoolit në sasira që nuk janë të helmueshme ka shkaktuar kapitjen (rraskapitjen) e funksionimit të qarkullimit të gjakut te personat e thjeshtë që nuk e kanë shprehinë e pirjes së alkoolit.

Në mënyrë që të vlerësohet funksionimi i zemrës te pijanecët është bërë krahasimi i tre personave prej atyre që janë të njohur si alkoolistë të mëdhenj me persona të thjeshtë.

Edhe përkundër dallimeve të ndieshme në indikacione dhe simptoma të zemrës, te të gjithë ata është treguar një rënie e sigurtë e aftësisë së diastolës (lëshimit) dhe sistolës (tkurrjes) së barkushes së majtë.

Kapitja ka qenë më flagrante te të sëmurë që kanë pasur diastolën më të gjatë. Te dymbëdhjetë të sëmurë që nuk vuajnë nga asnjë simptomë ose rritje të zemrës, vëllimi i barkushes së majtë dhe sasia e gjakut të nxjerrë kanë qenë shumë të ndryshme te personat e shëndoshë.

Te njëmbëdhjetë të sëmurë shtesë, të cilët nuk vuajnë nga rritja e zemrës, është paraqitur dallimi i qartë, kështu që tek ata vëllimi (i barkushes) është rritur ndërsa intensiteti i pompimit të gjakut është zvogëluar.

Te tetëmbëdhjetë të sëmurë, të cilët vuajnë nga rritja e zemrës pa simptoma, ka ndodhur një rënie e ndieshme e funksionimit të pompimit krahas rritjes së vëllimit dhe zvogëlimit të sasisë së nxjerrë të gjakut.

Prandaj, pirja e alkoolit shkakton rënie të parreshtur duke filluar nga çrregullimi i ritmit të zemrës e deri te etapat që pasojnë njëra pas tjetrës, e këto janë zvogëlimi i aftësisë së pompimit të gjakut, pastaj zgjerimi (rritjen) i zemrës, e më pas paraqitja e simptomave të kapitjes (rraskapitjes) së zemrës. Të dhënat e fituara nga eksperimenti me qentë i vërtetojnë këto fakte. Kështu, gjatë furnizimit të shtatë qenve me rreth pesë sasira energjie të ngrohtë që u është dhënë me anë të alkoolit për 18 muaj, është bërë e qartë rënia e sasisë së nxjerrë të gjakut nga barkushja e majtë dhe rënia e aftësisë së sistolës (tkurrjes) së muskulit të zemrës.

Për sa i përket zgjerimit të barkusheve dhe pezmatimit të arterieve koronare, ose ndërrimit të tyre, kjo nuk është vërejtur (paraqitur) gjatë autopsisë (së qenve), ndërsa potasi në muskulin e zemrës të këtyre kafshëve ka rënë dukshëm. Dhe, të rezymojmë, pirja e alkoolit në sasira që nuk janë të helmueshme ka shkaktuar ligështim (kapitje) në funksionimin e qarkullimit të gjakut te personat e shëndoshë me shprehinë e pirjes së alkoolit. Për sa i përket pirjes kronike të alkoolit, ai shkakton rënien e funksioneve duke filluar nga pengimi i funksionimit të muskulit të zemrës e deri tek etapa e cila shquhet me dobësimin e aftësisë së pompimit të gjakut, me zgjerimin e zemrës dhe me paraqitjen e simptomave të çrregullimit (të funksionimeve). Prandaj, përdorimi i alkoolit në çfarëdo sasie qoftë ose gjatë cilësdo periudhe kohore, jo vetëm që ka ndikim shumë të dëmshëm në zemër, por ndikon edhe në rregullsinë e bindjes fetare."

Profesor Tomas Shehi (Sheehy), ligjërues i mjekësisë së brendshme në Universitetin e Birmingamit, në artikullin "Alkooli, zemra, si bën dobi, e si bën dëm?", të botuar në revistën e njohur mjekësore "Post Graduate Medicine", në numrin e prillit të vitit 1992, thotë: *"I pari që ka filluar të proklamojë rolin preventiv të alkoolit në pengimin e sulmit të zemrës është hetuesi Rusk dhe bashkëpunëtorët e tij, kur në vitin 1956 proklamuan se pirja e një apo dy gotave uiski ndikon siç ndikojnë ilaçet që pengojnë angina pectoris-in, të njohura sepse përmbajnë nitroglicerinë.*

Po kështu, në të kaluarën ka qenë e përhapur bindja se alkooli zgjeron arteriet koronare të cilat furnizojnë muskulin e zemrës, e disa kanë thënë se alkooli ka rol në pengimin e dhimbjeve në vendpranimet (qendrat) e dhembjes në tru. Ndërsa, hetimet e mëpastajme kanë vërtetuar se alkooli me të vërtetë i zgjeron arteriet, por arteriet e shëndosha që e furnizojnë muskulin e zemrës.

Për sa i përket arterieve që janë ngushtuar nga gëlqerizimi i shkaktuar nga fundërrimi i yndyrërave në muret e tyre, ato nuk zgjerohen dot. Këtë e ka zbuluar hetuesi Fridman me bashkëpunëtorët e tij, në vitin 1981, ku ka vërejtur se në qoftë se përqindja e alkoolit në gjak rritet me 200 miligramë, atëherë alkooli shkakton atë që është e njohur si "vjedhja koronare" (coronary steal) në situatë të furnizimit të varfër (të zemrës me gjak). Ai ka vërejtur se arteriet e shëndosha zgjerohen dhe me këtë marrin sasinë më të madhe të gjakut, por tek arteriet e ngushtuara nuk vjen assesi sasia e mjaftueshme e gjakut dhe kështu gjendja keqësohet."

Profesor Shehi më tej thotë: "Ideja se alkooli pengon sulmet e zemrës kur hetuesi Uilens, gjatë vrojtimeve të tij në vitin 1947, me rastin e autopsisë së trupave të pijanecëve, që kishin vdekur para moshës pesëdhjetë vjeçare, ka gjetur se tek ata përqindja e gëlqerëzimit të arterieve është më e vogël sesa tek ata që nuk pinë alkool. Ky vrojtim i ka nxitur shumë shkencëtarë dhe hetues që të bëjnë shumë vëzhgime në mënyrë që të vërtetohet saktësia e këtyre pohimeve.

Në vëzhgimet e tyre statistikore hetuesit janë ndarë në mendime rreth rolit të alkoolit në sëmundjen e sulmeve të zemrës. Një grup prej tyre konsideron se alkooli zmadhon mundësinë e sëmundjes së arterieve koronare, të dytët konsiderojnë se nuk ka ndonjë lidhje ndërmjet pirjes së alkoolit dhe paraqitjes së kësaj sëmundjeje, ndërsa të tretët konsiderojnë se pirja e alkoolit në sasira të matura pengon sulmet e zemrës.

Disa hulumtime janë kryer edhe mbi disa të sëmurë të cilët kanë pasur sulm të zemrës, kështu që u janë hetuar EKG-të e zemrës gjatë punëve të rënda dhe është zbuluar se, me rritjen e sasisë së alkoolit të pirë rritet edhe mundësia e dobësimit të furnizimit të zemrës (me gjak). Këto rezultate

janë komentuar si pasojë e rolit të alkoolit në tkurrjen e arterieve (vasospams) dhe "vjedhjes koronare"."

Profesor Shehi pastaj thotë: "Alkooli ka aftësi të mjaftueshme që të shkaktojë tkurrjen e arterieve, pastaj nxitjen e mbylljes së muskulit të zemrës (AMI), madje edhe kur në arteriet koronare të zemrës nuk ka asnjë sëmundje..."

Në lidhje me pirjen e alkoolit dhe vdekjen e befasishme (sudden death), profesor Shehi na thotë: "Rastet e vdekjeve të befasishme në SHBA vlerësohen në 300 000 raste në vit dhe shumica për shkak të pirjes së alkoolit.

Me hulumtimin vertikal, të ndërmarrë në Suedi në vitin 1987, nga ana e hulumtuesit Lethel me bashkëpunëtorë, ku kanë marrë pjesë 2122 njerëz në moshë 50 vjeçare, është zbuluar se rreth 49 % e rasteve të vdekjes në mesin e tyre kanë ndodhur ndër pijanecët. Në vëzhgimin e dytë të rreth 169 njerëzve, Birdi dhe bashkëpunëtorët e tij, në vitin 1986, kanë zbuluar se 40% e rasteve të vdekjeve të befasishme kanë ndodhur për shkak të pirjes së alkoolit.

Po kështu, hulumtimi i bërë nga Instituti Patologjik në Moskë ka vërtetuar se rreth 17% e numrit të të vdekurve nga vdekja e befasishme ka qenë si pasojë e pirjes së alkoolit..."

Ai më tej thotë: "Për sa i përket paraqitjes së vdekjes së befasishme te pijanecët, ekzistojnë shumë faktorë të përbashkët: roli i alkoolit në sëmundjen e tkurrjeve të arterieve koronare (coronary vasospasm), çrregullimi i ritmit të zemrës (Arhythemias) dhe sëmundja e muskulit të zemrës (Cardiomyopathy)."

Në vitin 1973, hulumtuesi Fernandez me bashkëpunëtorë ka zbuluar se alkooli shkakton tkurrjen e arterieve koronare, të cilat e furnizojnë muskulin e zemrës, që pastaj shpie deri në angina pektorisi ose te mbyllja e muskulit të zemrës.

Disa hulumtime kanë vërtetuar se kjo tjurrje e arterieve ndodh 5 deri 17 orë pas pirjes së alkoolit në sasira që vlerësohen në rreth 100 deri 150 mililitra.

Takiziu me bashkëpunëtorët e vet gjithashtu ka vërtetuar se alkooli luan rol të rëndësishëm në nxitjen e sulmeve të zemrës nga lloji "variant angina".

Rreth çrregullimeve të ritmit të zemrës profesor Shehi thotë: "Shkencëtari Ettinger me bashkëpunëtorë ka vërtetuar në vitin 1978 se alkooli nxit çrregullime të ritmit të zemrës, pasi ka hetuar një grup të sëmurësh te të cilët janë paraqitur simptomat e çrregullimit të ritmit të zemrës pasi kishin pirë alkool. Këtë dukuri ai e ka quajtur "Sindroma e sëmundjes së zemrës gjatë ditëve të uikendit" (Holiday heart syndrome), ndërsa gjatë hulumtimit ka zbuluar si vijon:

- 12 të sëmurë nga AF – Atrial Fibrilation;
- 6 të sëmurë gjithashtu nga AF;
- 6 të sëmurë nga PVCs – Ventricular Estopic Beats;
- 4 të sëmurë nga ST – Sinus Tachycarida.

Kështu ai ka zbuluar se 16 të sëmurë kanë nevojë për ndërhyrje të shpejtë të kthimit të rregullit të zemrës, qoftë me elektroshok ose me ilaçe, edhe përkundër faktit se këta të sëmurë kanë pirë alkool në një periudhë më tepër se dhjetëvjeçare dhe asnjëri prej tyre nuk kishte vuajtur nga asnjë

sëmundje e zemrës ose e arterieve. Për sa i përket shkakut të paraqitjes së çrregullimit, ky është ndikimi i helmimit të drejtpërdrejtë të alkoolit në muskulin e zemrës. Një hulumtim i ndërmarrë te personat e shëndoshë ka vërtetuar se pirja e alkoolit në sasi më të vogël se 50 miligram në ditë zmadhon mundësinë e paraqitjes së çrregullimeve të ritmit të zemrës. Në qoftë se kjo sasi do të ishte 90 miligramë, mundësia e paraqitjes së këtyre çrregullimeve do të rritej tri herë. Hulumtuesi Lujsentajn me bashkëpunëtorët ka zbuluar se 12 prej 19 të sëmurëve (ose 65%) prej atyre që janë nën moshën 65 vjeçare janë të sëmurë nga fibrilacioni atrial – AF."

Ndërkaq, hulumtuesi Riç me bashkëpunëtorë ka zbuluar se 40 deri 64 të sëmurë (62%) janë të sëmurë gjithashtu nga kjo sëmundje.

Nga ana tjetër, Koheni me bashkëpunëtorë ka deklaruar se pirja e alkoolit mesatarisht 6 e më shumë herë në ditë e rrit dyfish mundësinë e paraqitjes së çrregullimit të ritmit të zemrës...

Në fund të këtij artikulli, profesor Shehi rezymon: "Hulumtimet e shumta që janë ndërmarrë vitet e fundit, kanë treguar se alkooli shkakton zgjerimin e arterieve të rëndomta (të shëndosha) koronare, por njëkohësisht përgatit paraqitjen e mbylljes së muskulit të zemrës së atij që vuan nga ngushtimi i arterieve të zemrës. Këto hulumtime gjithashtu kanë vërtetuar rolin e alkoolit në sëmundjen nga sulmet e angina pectoris-it, në çrregullimin e ritmit të zemrës, në sëmundjen e muskulit të zemrës dhe në vdekjen e befasishme. Dhe, deri në këtë çast, nuk dihej shkaku që i ka mundësuar alkoolit të jetë shkaktar i shfaqjes së këtyre sëmundjeve..."

QËNDRIMI (TRAJTIMI) ISLAM (I KËSAJ): Nga Tarik El-Xha'fiu radijall-llahu anhu transmetohet se e ka pyetur Resulull-llahun sal-lall-llahu alejhi ve sel-lam për alkoolin e ai ia ka

ndaluar atë. Tariku ka thënë: *"Unë e prodhoj atë për ilaç"*, kurse i Dërguari i All-llahut sal-lall-llahu alejhi ve sel-lam i është përgjigjur: *"Ai, me të vërtetë, nuk është ilaç, por sëmundje!"*[21]

Nga Tarik b. Suvejd El-Hadraniu transmetohet se ka thënë: "Unë thashë: "O i Dërguari i All-llahut sal-lall-llahu alejhi ve sel-lam, në viset tona ka rrush, të cilin ne e shtrydhim dhe e pimë." I Dërguari i All-llahut sal-lall-llahu alejhi ve sel-lam tha: "Jo!" Unë përsëri iu drejtova dhe thashë: "Në të kërkojmë ilaç për të sëmurët", e ai tha: "Me të vertetë, ky nuk është ilaç, por sëmundje!"[22]

Nga Ebu Derda'i radijall-llahu anhu transmetohet se ka thënë: "I Dërguari i All-llahut sal-lall-llahu alejhi ve sel-lam ka thënë: *"Me të vërtetë All-llahu ka dhënë (ka zbritur) sëmundjen dhe ilaçin dhe për çdo sëmundje ka dhënë ilaç. Shërohuni, por mos u shëroni me atë që është e ndaluar (haram)!"*[23]

Nga Ibni Mes'udi radijall-llahu anhu transmetohet se ka thënë: "I Dërguari i All-llahut sal-lall-llahu alejhi ve sel-lam ka thënë: *"All-llahu me të vërtetë nuk ju ka dhënë ilaç në atë që ua ka bërë haram (të ndaluar)!"*[24]

T'i kthehemi sërish Kongresit Ndërkombëtar e të shohim një mrekulli tjetër të të Dërguarit të All-llahut sal-lall-llahu alejhi ve sel-lam. Njëri nga pjesëmarrësit e kongresit është ngritur e ka thënë: *"Ekziston një numër i madh i të sëmurëve të cilëve ua kemi përshkruar dhe i kemi këshilluar që të pijnë*

[21] Shënon Muslimi, Ebu Davudi dhe Et-Tirmidhiu.

[22] Shënon Muslimi.

[23] Shënon Ebu Davudi.

[24] Shënon El-Buahariu.

alkool të llojeve të ndryshme, në mënyrë që ta shpejtojmë shërimin e tyre. Ndërkaq e vërteta është se ne e kemi shpejtuar vdekjen e tyre."

Përfaqësuesit të Egjiptit në këtë kongres nuk i kishte mbetur asgjë tjetër por të ngritet e të thotë: *"Këtë jua ka kaluar Pejgamberi islam. Ai na ka sqaruar se alkooli nuk është i dobishëm si ilaç"* Pastaj ua ka përkthyer hadithin që shënon Muslimi duke transmetuar nga Tarik El-Xha'fiu, që u përmend pak më parë.

Përfaqësuesi i Egjiptit, duke shtuar në këtë hadith, ka thënë: "Ferrëfyesi ynë, Muhammedi sal-lall-llahu alejhi ve sel-lam, ka ardhur me këtë të vërtetë shkencore para më tepër se 1400 vjetësh dhe ne muslimanët i përmbahemi kësaj këshille të shtrenjtë. Më tepër kemi dëshirë të vdesim sesa të pimë ilaç në të cilin ka drogë, duke iu frikësuar shkeljes së urdhrit të All-llahut xhel-le shanuhu dhe të Dërguarit të Tij, sal-lall-llahu alejhi ue sel-lam."

Anëtarët e kongresit janë çuditur nga përputhja e qëndrimeve të tyre dhe teorive të reja me fjalët e Ferrëfyesit islam, Muhammedit sal-lall-llahu alejhi ve sel-lam, dhe kanë kuptuar se nuk kishin zbuluar dot asgjë të re.

Dhe, në fund, nën titullin "Pasioni për pirjen e alkoolit", është botuar artikulli në njërën nga revistat më të njohura mjekësore në botë "Lancent" (botohet në Britani), e në fillim të artikullit autori thotë: *"Ajo që pohojnë disa mjekë se alkooli mund të jetë i dobishëm nëse merret në sasira të vogla, me të vërtetë është gënjeshtër e pastër dhe përçartje."* Pastaj thotë: *"Studimi ku mbështeten është studim i pabazuar, tek i cili nuk mund të mbështetemi dot."* Në fund, artikulli përfundon me fjalët: *"Rezymeja e gjithë asaj që është thënë është se mjekët janë të detyruar t'ua dorëzojnë njerëzve një porosi, e kjo është: "Alkooli është i dëmshëm për shëndetin!"*

POHIMI I KATËRT
DISA NJERËZ POHOJNË SE ALKOOLI KA VLERË USHQYESE, DUKE PASUR PARASYSH SE PRODHON KALORI TË VLERËS SË LARTË

MENDIMI I MJEKËSISË: Vlera ushqyese e ushqimit matet me kaloritë që liron ushqimi me rastin e djegies në trup. Hulumtuesit kanë zbuluar se gjatë djegies së një grami alkool lirohen shtatë kalori dhe kjo sasi është përafërsisht e njëjtë me atë që liron gjatë djegies sasia e njëjtë e yndyrës. E, a ka vallë organizmi dobi nga kjo energji ashtu siç ka nga ushqimi tjetër?

Dijetarët pohojnë se organizmi nuk ka dobi nga kaloritë e liruara gjatë djegies së alkoolit dhe se organizmi nuk është në gjendje që këto kalori t'i shndërrojë në energji që mund t'i sjellin dobi kur ka nevojë.

Kjo është diçka që pritej pasi, siç është rasti me ushqimet e tjera, temperatura e brendshme trupore rritet gjatë furnizimit të organizmit me kalori që rrjedhin nga djegia e alkoolit. Mirëpo, ai e derdh temperaturën trupore jashtë trupit, siç pamë më herët, gjë që ka për pasojë rënien e temperaturës trupore. Gjithashtu, kaloritë e rezultuara nga djegia e alkoolit më shumë bëjnë dëm sesa dobi, meqë te njeriu shkaktojnë ndjenjën e ngopjes dhe zvogëlojnë ndjenjën e urisë. Për këtë shkak alkoolisti shumë rrallë i afrohet ushqimit. Prandaj shohim që alkoolistët vuajnë nga sëmundja e mosngrënies (malnutriton).

Në shkaqet e përhapjes së sëmundjes së pangrënies tek alkoolistët bëjnë pjesë:

- mosinteresimi i alkoolistit për zgjedhjen e ushqimit cilësor, meqë brenga e tij e vetme është që të arrijë deri tek alkooli me çfarëdo mjeti qoftë, madje i flijon të hollat e ushqi-mit të vet dhe të fëmijëve;

- humbja e oreksit;

- pezmatimi i parreshtur i gjuhës (glossitis), nga ku alkoolisti sëmuret për shkak të mungesës së përbërësve të vitaminës B, që e shkakton alkooli. Atëherë futja e ushqimit në organizëm bëhet e dhimbshme, që e shtyn alkoolistin ta refuzojë ushqimin që i ofrohet;

- sëmundja e parreshtur e pijanecit nga krupa (të pështirët) dhe nga vjellja;

- roli që ka alkooli në zbrazjen e përmbajtjes së stomakut dhe të zorrëve, për shkak se alkoolisti sëmuret nga çrregullimet tretëse që e mundojnë dhe e pengojnë nga ushqimi;

- çrregullimet që shkakton alkooli në procesin e metabolizmit duke qenë se sëmundja e mëlçisë, që është rezul-tat i pirjes së alkoolit, sjell deri te rënia e procesit të formimit të proteinave dhe acideve aminike, pastaj pamundësinë e mëlçisë që të akumulojë lëndët jetike, siç janë zinku, vitaminat B6 dhe B12, si dhe pamundësinë e mëlçisë që t'i transformojë disa vitamina nga trajta e palëvizshme (inerte) në trajtën e lëvizshme, siç është vitamina D.

Alkooli zvogëlon aftësinë e sistemit tretës që të përthithë ushqimin (malabsorption), e kjo varet nga ndikimi i drejtpërdrejtë i alkoolit në zorrët e holla, si dhe në atë se shkakton inflamacionin e pankreasit dhe sëmundjen e mëlçisë. Të gjitha këto shkaqe së bashku sjellin deri te mungesa e disa materieve kryesore në trup, siç janë:

- vitaminat, që përbëhen nga vitamina A, grupi i vitaminave B, vitamina C dhe vitamina D;

- mineralet, që përbëhen nga:

ELEMENTI	SIMPTOMAT E MUNGESËS SË TIJ
ZINKU	Mangësia në funksionin e testisit dhe shërimit të varrëve dhe çrregullimi i imunitetit.
POTASI	Ndjeshmëria e muskujve dhe çrregullimi i rregullimit të zemrës.
MAGNEZIUMI	Çrregullimi i nervave si dhe çrregullimi i rrahjeve të zemrës.
FOSFATI	Kapitja e muskujve dhe çrregullimi i trurit, që mund të sjellë deri te epilepsia, dhe ndjeshmëria e funksionimit të trombocitit.
KALCIUMI	Kapitja (dobësia) e përgjithshme e trupit dhe shtangimi i shumicës së muskujve.

Për shkak të të gjitha këtyre shkencëtarët nuk e numërojnë alkoolin si burim relativ të ushqimit. Edhe pranë lirimit të nxehtësisë së madhe gjatë djegies së alkoolit ai nuk përmban elemente të rëndësishme ushqyese siç janë proteinat, minera-let, vitaminat, për më tepër, ai shkakton pakësimin e këtyre elementeve në trup, e me këtë ndikon drejtpërdrejt në tru dhe në mëlçi.

POHIMI I PESTË
DISA POHOJNË SE ALKOOLI KA AFTËSI QË TA VËJË NË LËVIZJE URINËN, PRANDAJ PËRDORET PËR SHËRIMIN E TË SËMURËVE NGA GURTHI I VESHKAVE

MENDIMI I MJEKËSISË BASHKËKOHORE: All-llahu i Lartmadhërishëm i ka dhënë veshkës aftësi për pastrimin nga mbeturinat dhe nga helmet që mund t'i bëjnë dëm njeriut nëse fundërrojnë në trup, si dhe aftësi për ruajtjen e lëndëve që i nevojiten organizmit.

Roli i alkoolit në veprimin e tij në veshkë shquhet përmes ndikimit të tij në pjesën e prapme të gjëndrës jargëzore që e pengon të sekretojë hormonin kundër lëvizjes së urinës, për ç'arsye shtohet lëvizja e urinës. Mirëpo, a i ndihmon kjo organizmit të lirohet nga teprica e kripës, nga helmi dhe nga gurthet? Përgjigjja është: Jo! Përkundrazi, dëmi është i madh, ndërsa pasojat që shkakton alkooli është e mundur të reduktohen në:

alkooli e rrit përqindjen e yndyrës në gjak, gjë që shkakton pengesa për lirimin e veshkave nga kjo yndyrë. Në fund kjo shkakton dobësimin e veshkave dhe paralizimin e funksioneve të tyre (renal failure);

- rritet jashtëqitja e lëndëve (përmes urinës) të cilat i duhen organizmit, siç janë: eritrociti, leukociti, trombociti, protenat dhe disa kripëra të rëndësishme;

- për shkak të pirjes së alkoolit veshka sëmuret nga një lloj malcimi (inflamacion) kronik, si p.sh. birra shkakton atrofinë granulare (granular atrophy) dhe, në këtë rast, veshka është e njohur si

"veshkë alkoolike". Është e mundur gjithashtu që veshka të sëmuret nga ciroza dhe trashja për shkak të shtresimit të yndyrës në të;

- alkooli, veçanërisht vera e bardhë, shkakton spazma të veshkëve krahas ekzistimit të gurthit në kanalet e urinës;

- alkooli shkakton gërryerjen e mukozës së uretrës si rezultat i konservantëve të futur në alkool, siç është acidi salicilik.

Këtu do të parashtroj mendimin e doktor En-Nesimit, All-llahu e mëshiroftë, i cili thotë: "Shumë prej tyre që pinë birrë thonë se ajo është pije e shëndoshë dhe e dobishme në shërimin e gurthit të veshkës, duke qenë se birra e nxit urinën. Të tjerët thonë se birra është pije e cila nuk është dëmshme e as e ndaluar (sipas Sheriatit), ngase një apo dy gota birrë nuk dehin..."

Ai më tej thotë: "Në shtetet evropiane dhe në Amerikë është përhapur shumë përdorimi i birrës, kështu që pirja e birrës e merr një pjesë të jetës së përditshme. Ajo pihet në vend të ujit, me çdo ushqim, pihet nëpër shëtitore dhe bile pa asnjë shkak. Kjo veti e qortuar rritet në botë dhe ka hyrë nëpër portet e shteteve arabe, në kryeqendra e kryeqytete dhe në shumë shëtitore e shërimore te disa mjedise.

Është për t'u pikëlluar ajo që më kanë rrëfyer disa besimtarë islamë, se kanë parë një automobil në rrugët e një qyteti islam-arab duke bartur diçka që i ngjanë shportave të ujit mineral. Që të gjithë kanë shikuar në këto shporta dhe kanë vërejtur se në to shkruante "Birrë joalkoolike".

Doktor En-Nesimi pastaj vazhdon e thotë: "Birra që nuk është e fortë përmban 2-3% alkool, birra e fortë 6-7%, kurse pija natyrore alkoolike, e njohur si verë, zakonisht përmban një përqindje të alkoolit që sillet rreth 8-10% dhe jo më shumë se 17%.

Një gotë alkool është e barabartë me një gotë e një çerek deri një gotë e gjysmë birrë të fortë ose me dy gota e gjysmë deri në katër gota birrë të dobët.

Për këtë arsye është e mundur që njeriu të dehet kur pi një sasi të madhe të birrës, madje edhe në qoftëse ajo përmban sasi të vogël alkooli. Po kështu, sasia e alkoolit që ndikon në dehje varet nga individi në individ, varësisht nga shprehia personale dhe të duruarit e alkoolit, të vetisë natyrore, shtetit, mënyrës së jetës, kohës së pirjes dhe nga gjendja e urisë ose të ngopjes në të cilën gjendet individi gjatë pirjes së alkoolit, ngase përthithja e alkoolit në gjendje urie është më e shpejtë.

Birra bën pjesë në pijet dehëse pasi përmban alkool dhe nuk ekziston dot birrë joalkoolike, edhe përkundër asaj se disa perëndimorë dhe gjermanë i kanë vënë këtë emër birrës së butë.

Kjo është kështu për shkak të pasionit të tyre të madh ndaj pijeve dehëse dhe të shprehisë së pirjes së tyre, e birra e butë nuk i deh dot, e cila përndryshe e deh individin që pi alkool për të parën herë, prandaj e kanë quajtur birrë joalkoolike. Edhe përkundër kësaj, kjo birrë të furnizon me një sasi alkooli që e kompenson sasinë e humbur në gjak dhe pengon simptomat e braktisjes së alkoolit të cilat paraqiten tek alkoolistët kur e lënë përnjëherësh alkoolin, siç është rasti te drejtuesit e kamionëve në rrugë të gjata. Gjithashtu, kjo birrë njeriut joalkoolist i jep një ndjenjë ekstaze (entuziazmi) nëse nuk e tepron me pijen e saj, në të kundërtën e deh..."

Për dëmin e birrës doktor En-Nesimi më tej thotë: "Ngulmimi në pirjen e alkoolit shkakton të majmjen, zgjerimin e stomakut, albuminurinë, rritjen e zemrës që përgatit kushte të volitshme për kullimin e sheqerit në urinë, për artritisin, shtangimin e arterieve, pezmatimin e fshikëzës së urinës e pas-taj pezmatimin e veshkëve. Këto dëme nuk shkaktohen vetëm nga alkooli që gjendet në birrë, por edhe për shkak të acidit salicil që i shtohet si lëndë mbrojtëse, si dhe për atë se kulpra, që i shtohet birrës për shkak të shijes së ashpër, përdoret kundër potencës, d.m.th. zvogëlon nevojën për seks me anë të ndikimit të lupolinës që gjendet në të.

Birra dhe cedri zvogëlojnë aktivitetin e tretjes së fibrinit, i cili rrit gëlqerizimin e arterieve, si dhe atë që pirja e alkoolit, qoftë madje edhe pije të buta, siç është birra, në koncetrim prej 25%, zvogëlon imunitetin nga sëmundjet infektuese, veçanërisht sëmundjen e mushkërive. Pirja e alkoolit dobëson funksionet e mëlçisë dhe shkakton aneminë krahas mungesës së vitaminave tek 50% e alkoolistëve, si dhe për shkak të zvogëlimit të faktorëve që prodhon veshka dhe që marrin pjesë në procesin e trombozës (ngjizjes) së gjakut."

Koloneli Grin, drejtor i një enti sigurimi në Amerikë, thotë: "Njëra nga ngarkesat e mia ka qenë përgadititja e raporteve dhe bërja e hulumtime të rasteve të fundit të fatkeqësive, të sëmundjeve dhe të vdekjeve të disa mijërave mbartës të sigurimit jetësor në të gjitha pjesët e vendit. Unë e kundërshtoj idenë shumë të përhapur, e cila propagandohet fuqishëm, e kjo është se birra nuk është e dëmshme. Kam pasur rastin që në një qytet të madh tonin, në të cilin ekzistojnë shumë shfrytëzues të birrës, të jem dëshmitar i vdekjes së një numri të madh personash që kanë pirë birrë."

Nëntë drejtorë të enteve të sigurimit e kanë pohuar vërtetësinë e raportit të Grinit dhe kanë shpallur se kjo përputhet tërësisht me situatën e klientëve të tyre.

Ndërsa doktor Sabri El-Kabani thotë: "Shumë të rinj të këtij brezi konsiderojnë se birra është pije e cila të shqetëson më së paku, është më e pijshme dhe më e pastër, por sa e shëmtuar është kjo që mendojnë ata. Kështu, djaloshi që nuk ka hyrë ende në periudhën e pubertetit, i nënshtrohet vizitave të vendeve të zbavitjeve dhe vulgaritetit... Ai me zor i nënshtrohet imitimeve dhe shoqërimeve që t'i ndjekë shokët e vetë në konsumim, madje qoftë edhe në sasira të vogla të alkoolit. Nëse goja e tij nuk pranon shijen e verës ose të uiskit dhe shpirti i tij nuk pranon pirjen e pijeve dehëse çfarëdo lloji qoftë, duke u frikësuar për shëndetin e vet, të gjithë përreth tij përpiqen që të argumentojnë parregullsinë e qëndrimit të tij dhe insistojnë me ngulm që të pijë pak pije dehëse, e, nëse nuk mund ta përballojë atë, atëherë le të provojë birrë.

Atëherë bashkëbiseduesi shndërrohet në personalitetin e mjekut me përvojë dhe i numëron këtij djaloshi dobitë e birrës dhe ia zbukuron atë. Pastaj ia përshkruan se birra nxit skuqjen e faqeve, aktivizon organizmin, shtyn urinën e cila e nxjerrë jashtë gurthin. Ajo e rrit oreksin dhe tretjen, e majm atë që e pi dhe ia forcon shëndetin. Ajo bën pjesë në pije freskuese, e jo në ato alkoolike. E ndihmon djersitjen gjatë dimrit, ndërkohë që zbut vapën e verës. Thënë më saktë (konçiz), ai birrën e bën ilaç për të gjitha sëmundjet dhe shmangës të të gjitha brengave dhe lodhjeve.

Përkundër shijes së keqe dhe të hidhur të alkoolit, alkoolisti e pi atë vetëm për hir të ndierjes së ekstazës, e cila e pushton atë me ndihmën e shqisave të tij. Kurdoherë që trazohen, kujtimet ose ndjenjat e tij, zgjohet ndonjë ngjarje e gëzue-shme ose e pikëllueshme, ai e shtrin dorën pas gotës

në mënyrë që t'ia zmadhojë ekstazën dhe kënaqësinë ose që të kridhet në harresën e dhimbjeve dhe fatkeqësisë së tij.

Ekstaza lind nga alkooli që gjendet në pijen dehëse, për ç'arsye alkoolistët pinë pije të forta alkoolike në gota të vogla, me ujë ose me sodë për t'i zbutur ato. Birrën, që përmban pak alkool, e pinë në gota të mëdha ose në shishe, që ta plotësojnë sasinë e duhur të alkoolit. Rezultati në të dy rastet është i njëjtë, e kjo është futja e alkoolit në organizëm në sasi përafërsisht të njëjta në mënyra të ndryshme.

Pra, alkoolisti nuk ka kursyer në pierjen e lëndëve dehëse dhe në zgjedhjen e tyre, por e ka mbushur barkun e vet, e ka rritur dhe e ka zgjeruar atë me një sasi të madhe alkooli, ndërsa me sasitë e mëdha të pijeve zgjeron stomakun. Gjatë tretjes ndodhin çrregullime, e si rezultat i pijes dhe i shprehisë zvogëlohet ndezja e ushqimit dhe ngadalësohet asimilimi i ushqimit dhe kështu tek alkoolisti rritet të majmurit dhe pesha trupore, ndërsa fuqia, gjallëria dhe aktiviteti zvogëlohet.

Ekziston edhe dëmi i tretë nga birra, përveç pijeve të tjera alkoolike: birra ruhet (paketohet) në konserva (gota) teneqeje dhe shishe të blombuara. Duhet përmendur se në fabrikat e birrës i shtohet acid salicil, i cili e ruan atë nga prishja, porse prish dhe shkatërron veshkat.

Dhe, përderisa alkoolisti mendon se birra e nxit urinën dhe i pastron veshkat, ajo i shkatërron ato porsi kazma rrënuese.

Gjithashtu, nëpër fabrika, së bashku me birrën përzihet edhe kulpra, e cila i jep birrës një shije të hidhur të këndshme për ata që e pijnë. Kjo lëndë – kulpra, përdoret edhe në mjekësi, kurse

ekstrakti i saj, lupolini, përdoret për zvogëlimin e potencialit seksual dhe për zbutjen e fuqisë dhe vrullit të tij.

Unë jam i sigurtë se ky shkak i fundit vetiu është i mjaftueshëm që rinia t'i largohet birrës dhe pijeve të tjera alkoolike, në mënyrë që ta ruajë gjallërinë dhe aktivitetin."

Në ujdi me temën rreth dëmshmërisë së birrës, po parashtroj lajmin e botuar në revistën "El-Islah", numër 91, në muajin dhul-hixhxhe të vitit 1405 sipas Hixhrit. Në këtë lajm thuhet: *"Një numër anëtarësh të Senatit në Romë ka shpallur në një anketë zyrtare të ndërmarrë në Senat, se birra është e dëmshme për shëndetin e njeriut. Anëtarët e Senatit kanë vënë në pah se ndërmarrjet botërore për prodhimin e birrës, përdorin një gaz të rrezikshëm, që është përdorur në Luftën e Parë Botërore për prodhimin e lotësjellësve. Akuza kryesore u është drejtuar fabrikave të birrës të Gjermanisë Perëndimore dhe këta anëtarë kanë kërkuar ndalimin e importit të kësaj birre dhe kanë ndërmarrë një fushatë zyrtare që të tërhiqet vërejtja ndaj rrezikut që përmban kjo pije."*

Në fund, ua drejtoj apelin vëllezërve të mi muslimanë që kundrejt kësaj pijeje prej elbi, në të cilën shkruan: *"Birrë joalkoolike",* të mos kenë sjellje të papërfilltë, ngase nuk ekziston dot birrë joalkoolike.

Disa hulumtime kanë vërtetuar që kjo pije përmban përqindje të alkoolit rreth 0.5 – 1.7%. Për këtë shkak, çdo musliman është i detyruar t'i shmanget gjërave të dyshimta, në mënyrë që të mos e hudhë veten në hidhërimin e All-llahut.

Në revistën "Consumer" (Konsumatori), që e boton Organizata Amerikane për Ushqim dhe Ilaçe (FDA), në artikullin e botuar në fashikullin 20, numër 7, në muajin shtator të vitit 1986, nën

titullin "Birra dhe vera pa alkool – a është kjo e afërt me të vërtetën?", autori i artikullit, dr. Roxher Mileri, thotë: *"Shprehja "birrë joalkoolike" përdoret për çdo pije që përmban më pak se 0.5% alkool krahas krahasimit me birrën e rëndomtë, e cila përmban 4% alkool, me birrën e butë, e cila përmban 3% alkool dhe me shumicën e verërave, të cilat përmbajnë 12% alkool."*

Ai pastaj thotë: "Pija, për të cilën thuhet "birrë joalkoolike", nuk është e mundur që të jetë krejtësisht pa alkool, ngase nuk ekziston dot ndonjë metodë kimike me ndihmën e së cilës do të mënjanohej alkooli nga ndonjë pije."

Doktor Mileri më tej thotë: "Organizata Amerikane për Ushqim dhe Ilaçe (FDA), e ka vërtetuar emrin "pije joalkoolike (non-alcoholic) për pijet që përmbajnë më pak se 0.5% alkool. Mirëpo kjo agjensi i është kundërvënë emrit të pijeve joalkoolike (alcohol-free), ngase kjo do të thoshte se është mënjanuar i gjithë alkooli që përmban kjo pije, e kjo është e kundërta e së vërtetës."

POHIMII GJASHTË
DISA POHOJNË SE ALKOOLI E AKTIVIZON MENDJEN DHE I MUNDËSON NJERIUT QË TË PUNOJË DHE TË JETË I QËNDRUESHËM NË PUNË.

MENDIMI I MJEKËSISË: Sistemi nervor qendror, ku bën pjesë edhe truri, konsiderohet si aparati trupor që i pari i ekspozohet ndikimit të alkoolit. Gjatë pirjes së alkoolit njeriu ndien

entuziazëm, ngase alkooli zgjeron venat e trurit, me çka rritet sasia e gjakut që vjen në tru, gjë që sjell deri te syçeltësia kohëshkurtër e cila zhduket shpejt dhe kalon në apati dhe plogështi. Pasojat e kësaj i vuajnë shumë qendra në tru, të cilat janë përgjegjëse për funksionet vitale të trupit, siç janë qendrat për kujtesë, për lexim, për të folurit, për sjellje, për lëvizje etj.

Alkooli shkatërron njerëzinë te njeriu, pasi shkatërron turpin dhe rrënon murin e turpit dhe ai, për shkak të alkoolit, bën vepra për të cilat do të turpërohej sikur të ishte i vetëdijshëm. Po kështu, alkooli ndikon drejtpërdrejt në trurin e vogël, të cilit All-llahu i Lartmadhërishëm i ka dhënë funksionin e koordinimit të lëvizjeve të muskujve dhe të mirëmbajtjes së barazpeshimit dhe për shkak të alkoolit njeriu e humbet barazpeshën dhe kontrollin mbi të.

Në rastin kur rritet përqindja e alkoolit në gjak, mund të ndikojë në qendrën për frymëmarrje në tru dhe mund të shkaktojë pushimin e punës së saj e pastaj vdekjen e njeriut.

Libri "Alkoolizmi" (Alkoholism) përmend se deri më sot nuk dihet sasia e saktë e alkoolit prej së cilës shkaktohet sëmundja e alkoolizmit. Mirëpo, ajo që dihet me siguri, është se sa më e gjatë të jetë koha (periudha) e pirjes së alkoolit të alkoolistit, tek organet e trupit ndikon sasia më e vogël e alkoolit. Dijetarët konsiderojnë se nuk ka ndonjë sasi të caktuar nën të cilën njeriu do të ishte i sigurtë nga rreziku i pijeve dehëse.

Libri në fjalë vërteton se shkatërrimi i indeve për shkak të pirjes së alkoolit mund të jetë shkatërrim përfundimtar (i përhershëm), i cili nuk mund të shërohet më.

Prandaj disa dijetarë thonë se pirja e një ose dy gotave të cilësdo pije alkoolike ndonjëherë shkakton vdekjen e disa qelizave të trurit.

Ky pohim e rrëzon mendimin se sasia e vogël e alkoolit nuk bën dëm, meqë alkooli, qoftë edhe në sasi të vogël, shkakton dobësimin e vullnetit të gjykimit të shëndoshë dhe zmadhon reaksionet shpirtërore. Për këtë arsye nëse alkoolisti nuk është i aftë që të përmbahet nga sasia e vogël e alkoolit, atëherë si do të jetë gjendja kur të bëhet alkoolist kronik?!

Doktor Umer El-Bajir Salihu thotë: "Shkenca ka vërtetuar se gjendja e ekstazës, e fatit dhe e gëzimit, që nxiten nga gotat e para të alkoolit, është vetëm mashtrim. Alkooli nuk është stimulant por, në realitet, është narkotik, kurse shkenca sqaron esencën e ekstazës së rrejshme në këtë mënyrë: Dihet se truri i njeriut shquhet nga ekzistimi i qendrës së përbërë nga disa qeliza të ndieshme, që kryejnë funksionin e "inspektorit" (mbikëqyrësit) mbi gjithçka që vjen nga qendrat më të ulëta të trurit dhe i bën ato të hajthme e subtile dhe të përshtatshme për njeriun, duke ruajtur kontinuitetin e jetës.

Kur njeriu pi alkool, këto qeliza të ndieshme shtangohen, veprimtaria dhe kontrollimi i tyre pushon dhe kështu qendrat më të ulëta bëhen të lira dhe ndikimet e tyre shprehen pa kurrfarë kufizimi e kontrolli. Ky është shkaku që e sheh dikë që ka qenë i heshtur e turpshëm ditën, sesi po i rrotullohet gjuha me shpejtësi të kompjuterit pasi ka pirë alkool. Kështu personi i trashë hyn në arenën e vallëzimit dhe e dredh prapanicën e vet sikur të ishte anëtar i ndonjë grupi vallëzues; njeriu me zë të ngjirur fillon të këndojë dhe gjen hapësirë për atë që nuk do të duhej të thuhej ose të bëhej, e kështu me radhë.

Mirëpo, kur rritet numri i gotave, atëherë fillon numërimi dhe qendrat e trurit dështojnë njëra pas tjetrës dhe shkaktohen çrregullime në ecje, vështirësi në të folur, shtohet përmjerrja dhe ndodh që alkoolisti të flejë në vendin (karrigen) e vet porsi i drobitur.

TRAJTIMI ISLAM: Nga Aishja radijall-llahu anha transmetohet se ka thënë: "I Dërguari i All-llahut sal-lall-llahu alejhi ve sel-lam ka thënë: *"Çdo gjë që deh është haram. Ajo që deh në sasi prej një fereku, është haram edhe në sasi prej një grushti."*[25]

Dhe i Dërguari i All-llahut sal-lall-llahu alejhi ve sel-lam ka thënë: *"Ajo që deh në sasi të madhe është haram edhe në sasi të vogël."*[26]

POHIMI I SHTATË
DISA POHOJNË SE ALKOOLI NXIT DHE FORCON NEVOJËN PËR SEKS

MENDIMI I MJEKËSISË: Alkooli zgjon afshin për seks (afrodiziak), por zvogëlon vetë aktin e seksit në këtë mënyrë: Alkooli ndikon në testise, meqë alkooli shkakton të fishkurit (atrofinë) te mashkulli, pra: a) rënien e sekretimit të hormoneve të mash-kullit – testosteronin; b) zvogëlimin e numrit të spermatozoide-ve dhe zvogëlimin e sasisë së qumështit te mëndesha.

Në raportin e Fakultetit Britanik për Mjekë të vitit 1987, nën titullin "Kobi i madh dhe i rrezikshëm", shkruhet: "Pirja e vijueshme e alkoolit shkakton çrregullim në funksionet seksuale te

[25] Shënon Ebu Davudi dhe Et Tirmidhiu.
[26] Shënon Ebu Davudi dhe Et Tirmidhiu.

meshkujt dhe femrat për shkak të ndikimit të drejtpërdrejtë të alkoolit në testise dhe në vezore, në pjesën e trurit nën dhomëzën e përhimtë (hypothalamus) dhe në gjëndrën jargore përgjegjëse për sekretimin e hormoneve seksuale (gonadotropins), të cilat nxisin testiset dhe vezoret.

Është zbuluar gjithashtu se përqindja e hormoneve mashkullore (testosteroneve) te mashkulli alkoolist është në rënie e sipër, ndërsa te femra alkooliste zvogëlohen hormonet femërore (estrogjenet).

Ndër problemet më të mëdha të sistemit gjenital te mashkulli bën pjesë si vijon: humbja e nevojës për seks, impotenca, atrofia (të fishkurit) e testiseve, zvogëlimi i organit gjenital, zvogëlimi i aftësisë apo pamundësia e testisit që të prodhojë spermatozoide, pastaj rënia e qimeve përreth organit gjenital dhe ndërrimi i formës së njohur të testiseve.

Për sa u përket atyre të cilëve u është sëmurë mëlçia nga ciroza për shkak të pirjes së alkoolit, tek ata ndodhin çrregullime në barazpeshimin e hormoneve, që sjell deri te rritja e gjinjve (sisave) etj.

Statistikat flasin se 40-90% e alkoolistëve janë të sëmurë nga humbja e nevojës për seks, ndërsa testiset te 10-75% të sëmurëve janë të sëmura nga atrofia."

Në raport më tej thuhet: "Për sa u përket problemeve më kryesore që ndodhin në sistemin gjenital të femrës, si rezultat i alkoolit, janë si vijon: çrregullimi në funksionin e vezoreve, humbja e nevojës për seks dhe çrregullimet në ciklin mujor të cilat sillen në mes rritjes së sasisë së gjakut dhe mungesës së plotë e gjakut. Po kështu, atrofia 'futet' në vezore, në gjinj dhe në organet e jashtme gjenitale dhe duke ndërprerë sekretimin e sekrecioneve vaginale. Një hulumtim ka konfirmu-ar se 75% të alkoolisteve janë të sëmura nga atrofia e sisave.

Disa hulumtime tregojnë se gjendja te 25-50% e alkoolistëve, të cilët kanë pushuar krejtësisht së piri, është përmirësuar, veçanërisht tek ata testiset e të cilëve nuk kanë qenë të sëmura dhe në hormonet seksuale të të cilëve nuk kanë ndodhur çrregullime."

Raporti i përgatitur (botuar) nga Fakulteti Mbretëror për Psikiatërit, në vitin 1986, tregon se në kohët më të reja është vërtetuar se pirja e alkoolit në masa të kufizuara mund të shkaktojë sterilitetin (shterpësinë). Këtu ka arritur hulumtuesi Morgan, në vitin 1982, pasi i ka vëzhguar rreth 100 meshkuj, të cilët janë paraqitur në ordinanca për shërimin e sterilitetit. Ai ka zbuluar se te 40% e këtyre meshkujve shkaku i sterilitetit ka qenë zvogëlimi evident i spermatozoideve, ndërsa gjatë hulumtimit ka zbuluar se ata kanë pirë rreth 30-50 gram alkool në ditë, që i përgjigjet përafërsisht 2-3 gota birre, kurse këta njerëz nuk kanë qenë alkoolistë. Te gjysma e këtyre meshkujve gjendja është përmirësuar pas ndërprerjes së pijes, ndërsa numri i spermatozoideve u është kthyer në mesataren e rëndomtë.

Doktor Morijer Kafitisi thotë: "Alkooli nxit afshin seksual, porse çdo gjë ka çmimin e vet. Pirja e alkoolit, i cili është narkotik, ka aftësinë që t'i dobësojë ose t'i kufizojë ndjenjat. Duke qenë se ushtrimi i seksit është një proces me plot ndjenja dhe se organet që marrin pjesë në këtë akt, janë të ndieshme, alkooli, me vetitë e veta, mund të shkaktojë mossukses në të dyja anët."

Dhe në fund, dikush mund të pyesë e të thotë: Nëse alkooli është i dëmshëm për shëndetin, përse atëherë është i përhapur në të gjitha pjesët e botës dhe shumica e muslimanëve e pi atë e nuk sëmuren nga shumë sëmundje që përmendin librat e mjekësisë?

Duke u mbështetur në All-llahun, unë them: Nëse njeriu bën diçka që është e dëmshme dhe nga kjo vetë nuk ka ndonjë dëm, ky nuk është argument që të mohojmë ekzistimin e dëmit në atë gjë.

Njerëzit e dinë se çfarë dëmi sjell pirja e duhanit, por megjithatë një përqindje e madhe njerëzish e pinë atë. E dinë edhe dëmin nga prostitucioni, por megjithatë ka të atillë që e bëjnë këtë dhe i nxisin të tjerët, e ngjashëm me këtë.

Ekzistojnë shumë gjëra për shkak të të cilave disa alkoolistë nuk sëmuren, e unë do të përmend si vijon:

All-llahu i Lartmadhërishëm e ka krijuar njeriun dhe ia ka dhënë aftësinë që të mbrohet nga të gjitha sëmundjet. Mirëpo, çdo gjë ka kufirin e vet. Nëse njeriu e kalon këtë kufi, fuqia e tij për t'i kundërvënë sëmundjeve do të shkatërrohet dhe ai do të bjerë si theror i sëmundjes. Gjithashtu aftësia e durimit (të sëmundjes) ndryshon nga personi në person dhe ti sheh se një sëmundje e cila ka goditur një person gjatë një kohe të shkurtër kërkon një periudhë kohore më të gjatë që të paraqitet te një person tjetër. Alkooli shquhet me faktin që shumica e ndikimeve të tij në organizëm paraqiten vetëm pasi të kalojë një periudhë kohore, e cila ndonjëherë është dhjetë e ndoshta edhe më shumë vjet. Gjatë kësaj periudhe kohore organizmi reziston me gjithë fuqinë që i është dhuruar, derisa vjen deri te kufiri kur e humbet fuqinë e vet dhe atëherë këto sëmundje fillojnë të paraqiten.

Tabiatet e njeriut me rastin e pirjes së alkoolit janë të ndryshme. Ka njerëz që alkoolin e pinë në sasira të vogla, e ka edhe të tillë që, thjesht, e gëlltisin atë, e disa të tjerë e pinë deri në kufirin e helmimit. S'ka dyshim se llojllojshmëria e këtyre tabiateve luan një rol të rëndësishëm në paraqitjen e simptomave të cilat vënë në pah se organizmi ka rënë nën ndikimin e alkoolit. Sa më e madhe të jetë sasia e pirë alkoolit në një kohë të shkurtër, aq më shumë organizmi bie nën ndikimin e alkoolit.

Ata që punojnë në fushën e shëndetësisë më së miri e njohin madhësinë e ndikimit që ka alkooli tek alkoolisti. Prandaj, mund të shohësh se te njerëzit e thjeshtë mungon kuptimi i madhësisë së këtij problemi, përveç nëse dikush prej tyre lexon nga hulumtimet ose statistikat që janë bërë në lidhje me këtë çështje.

PJESA E TRETË
DËMET SHOQËRORE DHE EKONOMIKE NGA ALKOOLI

Ndikimi i pirjes së alkoolit nuk kufizohet vetëm te alkoolisti (pijanecin), por ai shtrihet dhe përfshin mbarë shoqërinë. Për këtë arsye urtësia e ndalimit të alkoolit (sipas sheriatit) është tejet e madhe, kurse dënimet e caktuara (sheriatike) konsiderohen si masë preventive për mbrojtjen e bashkësisë nga ata që rrezikojnë sigurinë, stabilitetin dhe pastërtinë.

Dënimet shoqërore dhe ekonomike të shkaktuara nga pirja e alkoolit e nga lejueshmëria e përhapjes së tij në shoqëri mund të kuptohen përmes këtyre gjërave:

- njohja e vëllimit;
- ndikimi i alkoolit në ekonomi;
- përpjekja e disa qeverive në drejtim të pengimit (kufizimit) të këtij problemi;
- roli i alkoolit në shkatërrimin e familjes;
- roli i alkoolit në përhapjen e krimeve;
- roli i alkoolit në rritjen e fatkeqësive në trafik.

Në këtë pjesë do të përpiqem të përdor statistika të besueshme e autentike nga burime profesionale, të cilat e skicojnë më së miri vëllimin e problemit dhe madhësinë e rrezikut, që disa ndoshta e konsiderojnë si çështje private (personale), e alkoolistit.

VËLLIMI I PROBLEMIT

Pirja e alkoolit konsiderohet si një ndër problemet që brengosin shumë qeveri në botë në aspektin e dëmit shumë të madh për ekonominë, individin, shoqërinë dhe shëndetin, gjë që i ka cytur këto qeveri të bëjnë gjithçka është e mundur dhe në fuqinë e tyre në drejtim të zgjidhjes së këtyre problemeve.

Organizata Botërore e Shëndetësisë, në raportin e vet të vitit 1982 përmend si vijon: "Një grup i madh sëmundjesh të pranishme në botë janë rezultat i pirjes së alkoolit, ndërsa rreth 50% (përqind) e fatkeqësive të trafikut janë pasojë e pirjes së alkoolit. Po kështu, rreth 86% e rasteve të vrasjes dhe të veprave të tjera kriminale janë rezultat i pirjes së alkoolit."

Raporti sekret i Akademisë së Shkencave të Bashkimit Sovjetik, fragmentet e së cilës kanë arritur deri tek Agjencia Franspres, ka zbuluar si vijon:

- sipas statistikave zyrtare në Rusi, në vitin 1980, kanë qenë 40.000.000 njerëz që kanë pirë alkool;

- vodka për çdo vit mbyt 1.000.000 njerëz, ndërsa numri i të sëmurëve është 17.000.000;

- shkencëtarët rusë thonë se është e pakuptimtë të flitet për raketa dhe për tensionet ndërkombëtare përkundruall rrezikut nga alkooli;

- 16% e fëmijëve të lindur në vitin 1982 kanë qenë me mangësi trupore;

- hulumtimi ka vërtetuar se Bashkimi Sovjetik fiton rreth 45.000.000.000 rubla (56.000.000.000$) në vit nga shitja e vodkës, ndërsa humbjet (dëmet) ekonomike, të shkaktuara nga alkoolizmi janë 180.000.000.000 rubla (225.000.000.000 $)."

Vlen të përmendet se këto numra kanë qenë para shpërbërjes së Bashkimit Sovjetik, kur rubla kishte vlerë më të madhe sesa dollari. Mirëpo tani rubla ka rënë ndieshëm.

- 99,4% e meshkujve dhe 97,6% e femrave, prej të cilave 95% janë vajza më të reja se 18 vjeç, në Bashkimin Sovjetik pinë alkool;

- pirja e alkoolit ka qenë shkak i rreth 85% të vrasjeve, dhunimeve të femrave dhe vjedhjeve;

- gazetat e "Seleskajtit" kanë vënë në pah se nëntë të dhjetat prej atyre që për herë të parë janë shëruar nga alkoolizmi janë më të rinj se 15 vjeç, ndërkohë që ekziston edhe përqindja e atyre që janë më të rinj se 10 vjeç;

- alkoolizmi konsiderohet si shakaktar kryesor për vdekjen e hershme në Rusi. Gjatë dhjetë viteve të fundit ka shkaktuar rënien e mesatares së jetës prej 67 në 62 vjet;[27]

[27] Marrë nga revista "En-Nur", numri i 20 majit, i vitit 1985.

- profesori Shakit (Shakeet) në doracakun e Harisonit përmend se: "Në SHBA 90% e popullatës pinë alkool, kurse 40-50% meshkuj sëmuren nga sëmundjet e zakonshme (kalimtare) si rezultat i pirjes së alkoolit. 10% e meshkujve dhe 3-5% e femrave vuajnë nga sëmundjet dhe problemet kronike shkaktar i të cilave është alkooli.";

- revista "Lanset" (Lancet), në vitin 1987, në artikullin e një mjeku, citon: "Në Angli për shkak të alkoolit vdesin 200.000 persona në vit, kurse shpenzimi i alkoolit në Britani është dyfishuar gjatë 30 viteve të kaluara, përderisa përqindja e rasteve të vdekjes dhe e komplikimeve të sëmundjeve të shkaktuara nga alkooli është rritur në përmasa të ngjashme." Pak kohë më parë Ministri i Shëndetësisë i Gjermanisë Përendi-more, Renar Versuati, ka publikuar se numri i të sëmurëve me shprehinë e pirjes së pijeve alkoolike në Gjermani arrin në 1.500.000 dhe se pirja e alkoolit gradualisht zvogëlohet në mbarë vendin. Duhet përmendur se numri i qendrave dhe spitaleve për shërimin e alkoolistëve në Gjermani arrin në 9000.

- buletini i botuar në vitin 1986 nga Fakulteti Mbretëror Britanik për mjekët e praktikës së përgjithshme përmend: "Zyra për Ekonominë Shëndetësore në Britani dhe në Uells ka zbuluar se 700.000 persona (rreth 2% e banorëve) vuajnë nga probleme të shkaktuara nga pirja e alkoolit. Nga ana tjetër, Zyra ka zbuluar se 3.000.000 (8% e banorëve) kanë pirë alkool në sasira të mëdha, gjë që ka çuar deri te paraqitja e problemeve dhe sëmundjeve të natyrës kronike.

Bofami dhe bashkëpunëtorët e tij kanë zbuluar në vitin 1984 se përqindja (mesatarja) e rasteve të vdekjes është rritur ndër alkoolistët.

Vetëm në Britani, përkundër faktit se numri i fletëvdekjeve që jepen çdo vit vlerësohet me 3000, ku shkaktar i vdekjes është alkooli, numri i rasteve të vdekjes që nuk janë regjistruar zyrtarisht sillet rreth 5000-10000 raste vdekjesh në vit."

Buletini më tej thotë: "Petersoni dhe bashkëpunëtorët e tij, në vëzhgimin e bërë në vitin 1974, në Suedi, kanë zbuluar se prej 7935 personash, në një periudhë kohore 3-7 vjet, alkooli ka qenë shkaktar i vdekjes së 25% të atyre që janë përfshirë në vëzhgim.

Statistika e vitit 1976 flet se rastet e ë vdekjes për shkak të alkoolit në Angli dhe në Uells kanë arritur 8000 raste vdekjesh në vit.

Të dhënat e fundit statistikore na bëjnë të ditur se alkooli është shkaktar i 40000 vdekjeve për çdo vit në Britani, ndërsa rreth 100.000 persona vdesin në vit për shkak të pirjes së duhanit.

Të dhënat vijuese statistikore sqarojnë problemet që lindin nga pirja e alkoolit, të cilat kanë shkaktuar vdekjen e një numri të madh personash në vitin 1984 në Angli dhe në Uells:

Sëmundja	Numri i rasteve të vdekjeve	Femra %	Meshkuj %
Kanceri (tumori) i keq	140-239	3	4
Sulmi në tru	430-438	3	12
Sëmundjet e mushkërive	460-519	3	11

Sëmundja e organeve tretëse	520-579	3	12
Sëmundja kronike e mëlçisë	571	80	80
Rastet e fatkeqë-sive dhe helmimit	800-899	1	6
Sëmundjet e tjera		1	6
Nga numri i përgjithshëm i rasteve të tjera të fatkeqësive		3	12

Sa u përket shpenzimeve në të holla të shkaktuar nga alkooli, si rezultat i prodhimit të zvogëluar, shpenzimeve të shërimit dhe problemeve të tjera shoqërore për shkak të alkoolit, kanë arritur shumën prej 1.800.000.000 funtash në një vit. Kësaj mund t'i shtohen shpenzimet jo të drejt-përdrejta në të holla për shkak të rasteve të fatkeqësive, të krimeve dhe të ndërprerjeve të marrëdhënieve të punës për shkak të alkoolit, e çmimi i të cilave vështirë se mund të vlerësohet."

Në një statistikë tjetër që e kanë përpiluar Mak Doneli dhe Mirdi në vitin 1985 është zbuluar se shpenzimet për shërbimet shëndetësore të ofruara alkoolistëve kapin shumën rreth 100.000.000 funtash për një vit. Po kështu, shumë statistika tregojnë se një në pesë të sëmurë që kanë hyrë në spital vuan nga problemet e shkaktuara nga pirja e alkoolit.

Raporti i Fakultetit Mbretëror për Mjekë në Britani, i vitit 1987, përmend: "Rreziqet për shëndetin, të cilat kanosen për shkak të pirjes së alkoolit, nuk janë në radhë të parë rezultat i asaj

se një numër i vogël njerëzish pinë sasira të mëdha alkooli. Mirëpo rreziku më i madh për shëndetin në përgjithësi është ngase një numër i madh njerëzish pinë alkool në sasi të njëjtë dhe në kontinuitet. Pirja e përditshme e 60 ml. alkool, përkatësisht dy litra birrë, shkakton rritjen e madhe të shtypjes së gjakut, sulme të trurit (strokes), sëmundjen e mëlçisë, sterilitetin, dobësimin e potencës dhe sëmundjen e sistemit nervor. Për sa u përket grave, gjysma e kësaj sasie, përkatësisht, një litër birrë, është garanci e mjaftueshme e këtyre sëmundjeve të kobshme."

Raporti nën titullin "Kobi i madh në rritje e sipër" (A great and growing evil), vazhdon më tej e thotë: "Ky raport nuk është i pari që ka botuar Fakulteti Mbretëror. Përkundrazi, shumë herët, më sakëtësisht në vitin 1926, Fakulteti ka botuar për dëmin e alkoolit dhe e ka paraqitur në Parlamentin Britanik (Dhomën e Ulët).

Në këtë raport thuhet se alkooli është kob i madh në rritje e sipër dhe se pirja e alkoolit të llojeve të ndryshme shkatërron shëndetin në përgjithësi dhe i bën njerëzit të paaftë për punë dhe për prodhimtari.

Alkooli shkatërron tregtinë dhe industrinë, njeriun që pi alkool e bën të rrezikshëm për sigurinë dhe për shëndetin në përgjithësi. Po kështu, shkakton lindjen e fëmijëve me konstru-ksion të dobët trupor, të cilët i kaplojnë sulmet e sëmundjeve, ndërsa shumica prej tyre vuajnë nga mangësi të mëdha kobkëqija trupore dhe kështu bëhen barrë shoqërore, në vend që të jenë mjet dhe faktor i ndërtimit e i prosperitetit të saj."

Raporti më tej thotë "se populli britanik në vitin 1981 për alkool ka shpenzuar 11.000.000 stërlina dhe se britanikët për alkool shpenzojnë më shumë sesa për fëmijë, automobila, spitale, shkolla

dhe fakultete bashkarisht dhe se shpenzimet në alkool paraqesin 7,5% të shpenzimeve të përgjithshme në vend."

Raporti gjithashtu thotë se është e pamundur të vlerësohen me çfarëdo shume dëmet ekonomike të shkaktuara nga aksiden-tet automobilistike dhe problemet e alkoolistëve me policinë, me gjyqet e të ngjashme, të cilat kapin shumën rreth 1 700 000 000 stërlina.

Në raport përmendet se gjendja në SHBA është shumë më e keqe sesa kjo. Dëmet materiale në SHBA, në vitin 1971, të shkaktuara nga pirja e alkoolit vlerësohen rreth 30 000 000 000 $. Në vitin 1975 dëmet kapin shumën rreth 43 000 000 000 $, e së shpejti shuma rritet në 113 000 000 000 $ në vitin 1979.

Në librin "Ekonomia dhe alkooli "(Economics and alcohol) këto dëme janë parashtruar pjesërisht në këtë mënyrë:

Humbjet	Vlera ($)
Në prodhimtari	77.544.000.000.000
Në shëndetësi dhe për shpenzimet në shëndetësi	20.465.000.000.000
Në fatkeqësi automobilistike	6768.000.000.000
Për shkak të djegieve	647.000.000
Për shkak të krimeve e dhunimeve	4.477.000.000.000

Humbjet ekonomoke të shkaktuara në gjykime dhe probleme shoqërore	3.467.000.000.000
Gjithsej vlera e humbjeve në vitin 1979	113.368.000.000.000

Libri "Një mijë sëmundje nga alkooli", botuar nga " Revista Britanike Mjekësore"(BMJ) në vitin 1977, përmend se një e pesta deri një e treta e rasteve të pranuara në seksionin e sëmunjdjeve të brendshme janë për shkak të alkoolit; d.m.th 300 000-500 000 veta.

Hulumtimi i bërë nga Malruoja ka vërtetuar se 29% e të gjitha ditëve në të cilat janë pranuar të sëmurët në spital, kanë ndodhur për shkak të pirjes së alkoolit. Studimet që janë bërë në Britani dhe në SHBA kanë vërtetuar se 40% e pacientëve të spitaleve të përgjithshme vuajnë nga problemet e lidhura me pirjen e alkoolit. Hulumtimet gjithashtu kanë treguar se te një e treta e atyre që i janë drejtuar ndihmës së shpejtë përqindja e alkoolit në gjak ka qenë 80 ml për çdo 30 cm^3 të gjakut. Ky është kufiri i sipërm i alkoolit i lejuar në Britani dhe SHBA gjatë ngarjes së automobilit, përkundër faktit se një numër i madh fatkeqësish ndodhin për shkak të sasisë së vogël të alkoolit, më pak se 80 ml në çdo 100 cm^3 të gjakut.

Është vertetuar se përqindja e aksidenteve të trafikut rritet shumë herë kur niveli i alkoolit në gjak arrin 50 ml në çdo 100 cm^3 të gjakut. Mirëpo, kur niveli i alkoolit arrin 200 ml në çdo 100 cm^3, mundësia e aksidenteve të trafikut rritet më tepër se njëqind herë. Zyra për Ekonominë Shëndetësore (Office of Health Economics) në Britani vlerëson se për çdo vit 8-15 milionë njerëzve u shkon huq një ditë pune për shkak të pushimit mjekësor të shkaktuar nga pirja e alkoolit.

Hulumtimet e bëra në Malmo, në Suedi, sqarojnë se personi që pi alkool, madje edhe nëse e përdor në masë, duke shkaktuar kështu rritjen e kufirit të sipërm natyror të enzimave (GGT), mungon nga puna mesatarisht 60 ditë në vit, në krahasim me personin tek i cili ky enzim është në kufirin e poshtëm.

Libri "Një mijë sëmundje nga alkooli" përmend se 25% e të gjitha rasteve të helmimit në Britani kanë ndodhur me të moshuar që kanë qenë në spital për shkak të rraskapitjes së zem-rës, pezmatimit të përsëritur të mushkërive, humbjes së kujte-sës dhe çrregullimit të arsyes dhe që kanë vuajtur nga problemet e lidhura me pirjen e alkoolit e që nuk i kanë shëruar. Një mjek i prak-tikës së përgjithshme në Britani shëron përafërsisht 2000 persona, prej të cilëve 135 persona pinë alkool në sasira të mëdha (më tepër se 6 gota në ditë, çfarëdoqoftë lloji i pijes alkoolike), 40 persona vuajnë nga probleme shoqërore e shëndetësore, produkt i pirjes së alkoolit, ndërsa 7 persona, e këta janë në fund të shkallës, vuajnë nga shkatërrimi i plotë i jetës së tyre.

Në vitin 1981, në spitalet për sëmundjet shoqërore e mentale në Angli dhe në Uells, janë pranuar 17 955 raste për shkak të pirjes së alkoolit. Prej këtyre, 12 026 persona kanë qenë meshkuj, ndërsa 5929 gra. Kësaj mund t'i shtohen edhe 14 000 persona që kanë hyrë në spital për shkak të shërimit të alkoolizmit.

Në Amerikën Latine, në vitin 1975, në pesë qytete të mëdha është bërë një hulumtim për pirjen e alkoolit dhe është vërtetuar se 35% e alkoolistëve janë meshkuj në moshën 15-64 vjeçare. Gjysmën e këtij numri e rrethojnë probleme shoqërore e familjare si dhe gjendja e keqe ekonomike për shkak se pijnë alkool.

Statistikat kanë treguar se 1-10% e alkoolistëve e kanë braktisur punën për shkak të pirjes së alkoolit. Gjithashtu, është zbuluar se braktisja e punës dhe produktiviteti i vogël rritet dy herë në mesin e alkoolistëve në krahasim me ata që nuk pinë alkool e që janë të profesionit të njëjtë, pa marrë parasysh se për çfarë bëhet fjalë.

Profesori doktor Emel El-Alemi, në studimin e vet nën titullin "Alkooliteti dhe helmueshmëria ndërmjet mjekësisë dhe Islamit", e që ka prezantuar në Kongresin e Mjekësisë Islame në Pakistan më 1405 h., thotë: *"Nën titullin "Alkooli është helm për sistemin nervor qendror"*, Xhak Lamaniu, drejtor për hulumtime pranë Qendrës Shtetërore për Hulumtime Shkencore dhe udhëheqës i laboratorit për hulumtime në Institutin Koleg de France të Francës, ka shkruar në revistën nr.15, të tetorit 1980, si vijon: *"Konsumimi i alkoolit është në rritje e sipër në të gjitha shtetet industriale. Ndërkaq Franca, me konsumimin e 16,7 milionë litrave të alkoolit të pastër në vit, është përpara të gjitha vendeve në të cilat ndodhin shumë aksidente trafiku. Numri i francezëve që pinë alkool në sasira të mëdha vlerësohet ndërmjet 4-5 milionë. Çdo vit numri i viktimave të alkoolit arrin 70 000 të vdekur, kurse shpenzimet për alkool arrijnë 70 000 000 000 franga franceze."*

Revista e njohur mjekësore Medicine International, në numrin e vet të shkurtit 1989 përmend: "Shpenzimi i alkoolit është rritur shumë në botë në vitet pesëdhjetë, gjashtëdhjetë dhe shtatëdhjetë. Konsumimi i alkoolit në Britani është rritur gjatë periudhes ndërmjet vitit 1949 dhe 1979, kurse në Gjermaninë Përendimore dhe Bullgari në vitin 1983 është rritur për më tepër se një herë në krahasim me vitin 1950."

Në Holandë konsumimi i alkoolit në fillim të viteve pesëdhjetë është trefishuar, ndërsa në periudhën e njëjtë konsumimi i alkoolit në Gjermaninë Lindore është rritur tetë herë.

Përkundër kësaj, gjatë dhjetë viteve të fundit në Francë dhe në Itali konsumimi i alkoolit ka filluar paksa të zvogëlohet.

Tabela në vijim sqaron konsumimin vjetor të alkoolit për një person në njëzet vende si dhe përqindjen e rasteve të vdekjes në ato vende, të shkaktuara nga ciroza e mëlçisë. Gjithashtu shihet se me rritjen e shpenzimit të alkoolit pas Luftës së Dytë Botërore janë rritur edhe problemet e sëmundje-ve që shkakton alkooli dhe ekziston një lidhje e fortë ndërmjet mesatares së konsumimit të alkoolit dhe përqindjes së rasteve të vdekjeve të shkaktuara nga ciroza e mëlçisë.

Shteti	Konsumimi i alkoolit të pastër për një person në litra				Mesatarja e rasteve të vdekjeve për shkak të cirozës së mëlçisë në çdo 100 000 persona		
	1975	1982	1985	Viti i konsumimit më të madh	- Meshkuj	Femra	Viti
Franca	17,0	13,9	13,9	1982	45,9	17,7	1977
Italia	13,4	13,0	9,4	1975	49,5	19,5	1978
Gjermania P.	12,5	10,9	11,3	1979	38,9	17,4	1978
Argjentina	11,1	10,1	8,7	1980	23,8	7,8	1978
Belgjika	10,1	10,8	10,8	1985	17,9	11,1	1976
Zelanda e Re	9,8	9,6	8,1	1981	5,7	3,3	1978
Australia	9,7	9,9	9,2	1981	12,3	4,3	1978
Hungaria	9,5	11,5	12,3	1984	31,7	14,8	1978

Çekosllovakia	*9,1*	*9,8*	*9,9*	*1982*	*25,1*	*9,9*	*1975*
Danimarka	*8,9*	*1,0*	*9,8*	*1983*	*12,5*	*9,8*	*1978*
Kanadaja	*8,2*	*8,8*	*7,8*	*1981*	*16,6*	*8,2*	
Gjermania L.	*7,7*	*10,0*	*13,4*	*1983*	*17,1*	*9,5*	*1977*
Polonia	*7,3*	*6,5*	*6,7*	*1980*	*15,6*	*8,5*	*1978*
SHBA	*7,0*	*8,2*	*7,7*	*1981*	*18,6*	*9,3*	*1978*
Britania e Madhe	*6,8*	*7,0*	*7,1*	*1979*	*8,9*	*6,0*	*1978*
Irlanda	*6,7*	*6,7*	*6,9*	*1978*	*4,3*	*3,6*	*1978*
Finlanda	*6,3*	*6,4*	*5,9*	*1983*	*3,6*	*3,0*	*1977*
Bashkimi Sovjetik	*6,4*	*6,1*	*5,7*	*1975*	*7,8*	*3,1*	*1977*
Japonia	*5,4*	*5,6*	*4,4*	*1983*	*21,1*	*7,5*	*1978*
Norvegjia	*4,3*	*3,8*	*4,1*	*1980*	*6,6*	*3,6*	*1978*

Kjo revistë mjekësore vërteton se meshkujt pinë alkool në sasi përafërsisht dy herë më të madhe se femrat. Për këtë shkak problemet e lidhura me alkoolin janë shumë më të mëdha te meshkujt sesa te femrat, por është zbuluar se një përqindje e madhe femrash ka filluar të pijë alkool me makutëri (grykësi), kështu që përqindja e meshkujve dhe e femrave në disa shtete është barazuar. Për shumë arsye femrat ia kalojnë meshkujve në shpejtësinë e rënies nën ndikimin e një sasie më të vogël alkooli.

NDIKIMI I ALKOOLIT NË SHOQËRI

E tani, të njihemi me vëllimin e problemeve të natyrës ekonomike përmes këtyre të dhënave statistikore:

- një të tretën e kapaciteve të spitaleve në vendet industriale e zënë të sëmurët nga alkooli. Në Teksas shpenzimet për shërimin e alkoolistëve, humbjet ekonomike të shkaktuara nga humbja e pasurisë, kompensimi dhe rënia e prodhimtarisë në raste të shumta e tejkalojnë fitimin e realizuar nga shitja e prodhimeve alkoolike;

- për sa i përket ish-Bashkimit Sovjetik, një hulumtim ka vërtetuar se fitimi vjetor i Bashkimit Sovjetik nga shitja e vodkës arrin rreth 45 000 000 000 rubla (56 000 000 000$), kurse humbjet ekonomike në Bashkimin Sovjetik për shkak të pirjes së alkoolit arrijnë 180 miliardë rubla (225 miliardë $);

- në Francë, në vitin 1979, është publikuar statistika mjekësore shoqërore-ekonomike, në të cilën thuhet se të ardhurat mesatare të Francës nga prodhimi dhe shitja e pijeve alkoolike kapin shumën rreth 20 miliardë franga franceze. Nga ana tjetër, të ardhurat kombëtare pësojnë dëme, si rezultat i pirjes së alkoolit. Kjo shkakton humbjen e orëve në punë, kështu që përdoren pushimet mjekësore të përkohshme ose të për-hershme, poashtu edhe pagesat e shërbimeve mjekësore, page-sa e spitaleve, mjekëve dhe ilaçeve. E gjithë kjo së bashku kushton 100 000 000 000 franga.

- humbjet e SHBA-ve për shkak të pirjes së alkoolit arrijnë 30 000 000 000$ në vit, kurse humbjet e Britanisë janë 3 000 000 000 funta në vit, përderisa, nga ana tjetër, nga tregtia me alkool Britania

fiton 1 700 000 000 funta.[28] Duhet përmendur se statistikat e vitit 1989 kanë dhënë përqindjet e humbjeve ekonomike, meqë humbja e gjithëmbarshme e SHBA-ve ka arritur rreth 120 miliardë dollarë në vit. Humbja e Britanisë ka qenë 7 miliardë funta.

Revista britanike për alkoolin (British journal of Addicton), në vitin 1987, ka përmendur se humbjet që kanë rezultuar nga problemet e shkaktuara nga alkool vetëm në vitin 1983 kanë arritur 640 000 000 funta.

Në një raport tjetër, të botuar në këtë revistë në numrin e dytë, thuhet se humbjet e gjithëmbarshme për shkak të pirjes së alkoolit vlerësohen rreth 2 000 000 000 funta në vit.

SI PËRBALLEN PROBLEMET?

Qytetërimi perëndimor me të gjitha aspektet e veta jeton në një boshllëk shpirtëror, dhe përfaqësuesit e këtij qytetërimi jetojnë duke bredhur në një gjendje konfuzioni. Prandaj, nuk është aspak për t'u habitur që problemi i alkoolizmit në raport me të konsiderohet si një problem i vështirë për t'u zgjidhur. Kjo shihet qartë nga qëndrimet e tyre të përkundërta për zgjidhjen e këtij problemi, të cilit, në fakt, nuk i është qasuar nga rrënja.

Këtu do të parashtroj tentimet e disa shteteve për ta zgjidhur këtë problem.

[28] Marrë nga revista "El-Fikr el-Islam", nr. 10, muaji muharem viti 1405 h.

SHTETET E BASHKUARA TË AMERIKËS

Tentimi i parë i SHBA-ve ka qenë vendosja e ligjeve të rrepta me të cilat ndalohej prodhimi dhe tregtia e alkoolit. Gjithashtu janë caktuar dënime të ashpra, siç janë burgimet dhe gjobitjet në të holla për ata që i shkelin këto ligje. Këto ligje janë zbatuar në vitin 1920, por pak kohë më pas, në vitin 1923, ato janë abroguar, pasi ishte u rrit numri i atyre që pinin alkool fshehurazi. Po kështu, ishte zgjeruar shitja e fshehtë e alkoolit, veçanërisht shitja e llojeve të këqija të alkoolit.

ISH-BASHKIMI SOVJETIK

Në numrin 787, të botuar në mars të vitit 1985, revista "El-Belag" shkruan: "Problemi i rritjes së përqindjes së alkoolistëve në Bashkimin Sovjetik filloi të nxitë reagime të mëdha në vend. Për herë të parë qeveria lejon që të botohet një artikull që thërret për t'u ndaluar alkooli në vend në trajtë të plotë, në mënyrë që të pengohen shumë probleme që rrjedhin si rezultat i pirjes së alkoolit."

Gazeta "Moskovski" ka botuar një artikull të shkruar nga akademiku i njohur botëror, Fjodor Oglavi, në të cilin ai kërkon ndalimin e prodhimit dhe të blerjes së alkoolit, e kundërta e asaj që ka ndodhur gjatë kohës së Leninit. Ajo që është interesante këtu është se ky akademik i ka akuzuar gazetat zyrtare që po heshtin për këtë kob, në vend që të thërrasin për ndalimin e shitjes së alkoolit. Në ujdi me raportin që ka bërë Akademia e Shkencave e Bashkimit Sovjetik, alkooli

është shkaktar i vdekjes së një milion sovjetikëve në vit. Nga ana tjetër, në çdo gjashtë fëmijë të lindur, njëri lind me mangësi ngase prindërit e tij pinë alkool. Shtetasi i Bashkimit Sovjetik konsumon mesatarisht 30 litra vodkë, kurse numri i pijanecëve arrin në 40 milion persona.

Revista "En-Nur", nr. 33, muaji ramazan, viti 1406 sipas hixhrit, përmend se Junadij Kolbini, sekretari i parë i Partisë Sovjetike në krahinën Ulanovsk, ka thënë se dënimet në të holla, që janë inkasuar për shkeljen e ligjit të ndalimit të pijeve alkoolike kanë arritur në një milion rubla (1,2 milion dollarë), pas hyrjes në fuqi të zbatimit të masave të reja të caktuara në muajin qershor.

Në fjalimin e tij të botuar nga një revistë e formuar posaçërisht për mbështetjen e aksionit për luftimin e pirjes së alkoolit, ai ka thënë së vëllimi i shitjes së alkoolit në vitin 1985 ka rënë në 23 000 000 rubla (28 000 000 $) në krahasim me vitin 1984. Ai ka sqaruar se ky numër në të kaluarën ka arritur në 7-8 milion rubla (10 000 000 $) në vit.

Gazeta "El-Sherk El-Eusat", në numrin e botuar më 30.04.1407 h. përmend: Si mund të zgjidhet çështja e mijëra të pastrehëve në Bashkimin Sovjetik, të cilët gazetat i akuzojnë se janë pijanecë, se shkaktojnë përhapjen e sëmundjeve të rrezikshme dhe se jetojnë në buzë të ligjshmërisë? Disa propozojnë që sërish të inkuadrohen në shoqëri, e disa të tjerë nuk ngurrojnë të rekomandojnë likuidimin e tyre me pushkatim. Nga ana tjetër, revista ka filluar diskutimin në një hulumtim tjetër i cili ka të bëjë me kushtet e jetesës të këtyre njerëzve, të cilët jetojnë në margjinën e shoqërisë sovjetike. Revista ka vërtetuar se numri i atyre arrin disa mijëra dhe mund të hasen në çdo vend të (ish) Bashkimit Sovjetik të gjerë, edhe pse ekzistojnë vende ku gjenden më shumë, siç është jugu, e veçanërisht Azia dhe Lindja e largët.

Këta të pastrehë nuk kanë dokumente personale dhe, praktikisht, nuk kanë kurrfarë të drejtash. Ata nuk mund të punësohen në ndonjë punë zyrtare e as që mund t'i drejtohen mjekut ose spitalit. Gjëja e përbashkët e tyre është se të gjithë ata pa dyshim janë alkoolistë. Revista thekson se ata paraqesin rrezik për shëndetin në Bashkimin Sovjetik, meqë mbartin çdo lloj sëmundjeje gjenitale, madje edhe tuberkulozin, i cili i shkakton kokëçarje qeverisë, e veçanërisht në Azinë e Mesme. Revista u bën pyetje atyre që kanë marrë pjesë në hulumtimin për mënyrën e përballjes së kësaj dukurie dhe njëri prej tyre, anëtar i Lidhjes Komuniste të Rinisë, përgjigjet: "Duhet të pushkatohen."

Franca

Pushteti francez në vitin 1940/41 ka vendosur ligje të reja, të cilat vërtetojnë ligjet e vjetra, e disa prej tyre janë:

- ndalimi i pijeve alkoolike me përqindje alkooli më të madhe se 18%;

- ndalimi i përdorimit të alkoolit të martën, të enjten dhe të shtunën;

- ndalimi i shitjes së alkoolit adoleshentëve;

- moszvogëlimi i dënimeve për krime që bën shoferi i dehur;

- ndalimi i propagandimit të pijeve alkoolike;

- të aktivizohen organizatat që kundërshtojnë pijet dehese;

Atëherë u vendos që numri i kafeneve të zvogëlohet nga viti në vit dhe të aktivizohet prodhimtaria e lëngjeve të ndryshme.

Zbatimi i këtij ligji ka bërë që numri i alkoolistëve të jetë gati përgjysmë më i vogël nëpër spitale, ose dy të tretat në raport me numrin e mëparshëm të tyre.

Komisioni i Lartë për Hulumtime dhe Shpjegime, në informatën e botuar në Paris, ka përmendur se qeveria franceze nuk bën luftë të fuqishme kundër pirjes së alkoolit. Komunikata ka nxjerrë sheshit edhe moskokëçarjën që mbretëron në vend, i cili e ka thyer rekordin në konsumimin e alkoolit.

Ky komision, i formuar në vitin 1955, anëtarët e të cilit i emëron pushteti, kritikon reklamimin e tanishëm të pijeve alkoolike në Francë si dhe miratimin e ligjit me të cilin i ofrohet mbështetje hapjes së kafeneve (bareve). Ky komision qëndrimin e vet e argumenton me nevojën e përmirësimeve të gabimeve të qytetërimit (bashkëkohor).

Alkooli dhe pasojat e tij konsiderohen si shkaktarët e tretë të vdekjes (pas sëmundjeve të zemrës dhe kancerit) në Francë, ngase për shkak të tij vdesin 18 000 persona në vit.

Duke u përgjigjur kritikave Ministri i Shëndetësisë ka deklaruar se masat parandaluese të alkoolizmit dhe sëmundjeve lidhur me alkoolin kanë qenë dhe do të mbeten nga brengat më të rëndësishme të pushtetit.

Parlamenti e ka verifikuar me konsensus propozimin e ligjit të qeverisë, ligj i cili kërkon praktikimin e dënimeve më të rrepta ndaj personave që i ngasin automobilët e tyre në gjendje të dehur.

Në projektligjin e ofruar nga Ministri i Drejtësisë, Aliban Shalindon, thuhet se autoritetet policore dhe gjyqësore kanë të drejtë që menjëherë të burgosin çdo ngarës, nëse aty për aty tregohet se është nën ndikimin e alkoolit.

Projektligji parasheh dënimin me burg deri në dy vjet si dhe pagimin e dënimit në të holla, që arrin edhe 30 000 franga, kundër çdo shoferi në gjendje të dehur që vret një person tjetër.

Në këtë projektligj është përmendur edhe ajo se aksidentet e trafikut në Francë shkaktojnë çdo vit vdekjen e 11 000 personave për shkak se shoferët pinë alkool.

Kina

Gazetat kineze kanë përmendur se është zbatuar gjykimi (sentenca) me vdekje ndaj katër personave, meqë prodhonin pije alkoolike pirja e të cilave ka shkaktuar vdekjen e 25 personave. Zu Shin Gong dhe Li Jang Taj kanë prodhuar 8000 litra pije alkoolike dhe kanë shitur më tepër se 1000 litra. Për shkak të pirjes së kësaj pijeje kanë vdekur 15 persona, kurse 7 të tjerë janë verbuar.

Sud Sing Do në Kinën Jugperëndimore ka dhënë gjykime me vdekje që janë zbatuar menjëherë.

Një rast tjetër, i ngjashëm me këtë, që ka ndodhur në një krahinë tjetër, ka qenë shkak që të caktohet gjykimi me vdekje i prodhuesit të dytë të alkoolit me emrin Li Rong Vi, ngase pija e prodhuar prej tij ka shkaktuar vdekjen e dhjetë personave. Gjykimi me vdekje është zbatuar gjithashtu edhe mbi bashkë-vepruesin e tij.[29]

[29] Marrë nga revista "En-Nur", muaji muharem, viti 1406 h.

Britania

Revista mjekësore britanike "Lanset" (Lancet), botuar në vitin 1987, ka kërkuar nga qeveria e Britanisë që të përdorë më tepër të holla me qëllim të vetëdijësimit të njerëzve për rreziqet e alkoolit, ashtu siç vepron në lidhje me pirjen e duha-nit.

Autori i artikullit kërkonte nga shteti që të ndalojë reklamimin e alkoolit dhe që në shishet e alkoolit të vendoset vërejtja për rrezikun e alkoolit për shëndetin.

Në Suedi shitja e alkoolit, mes vitit 1978 dhe 1983, ka rënë falë ndalimit të pjesërishëm të reklamimit të alkoolit.

Autori i artikullit ka kërkuar që të rriten tatimet për alkoolin dhe të caktohen kufizimet dhe dënimet për shoferët që do të kapen në vepër dmth. për pirje të alkoolit.

ROLI I ALKOOLIT NË SHPËRBËRJEN E FAMILJES

Nuk ka dyshim se dhënia pas alkoolit shkakton probleme të shumta të cilat shkatërrojnë familjen, sado e madhe të jetë kompaktësia e saj. Problemet më të rëndësishme që sjellin deri te shpërbërja e familjes së alkoolistit janë këto:

- rritja e përqindjes së shkurorëzimeve në familjet që kanë probleme me dhënien pas alkoolit të njërit ose të të dy prindërve (bashkëshortëve). Në Britani përqindja e shkurorëzimeve ka arritur në 20%, ndërsa alkooli dhe problemet që shkakton ai kanë qenë shkaku i parë i shkurorëzimit.

Ndërkaq, kjo përqindje në ish-Bashkimin Sovjetik ka arritur në 67%. Doktor Malme nga Suedia përmend se meshkujt te të cilët ka pasur pak rritje të enzimave GGT, që tregon se pinë alkool me masë, i kanë ndërprerë masat për shkurorëzim, ndërsa vetëm 3% e meshkujve, që nuk kanë pasur kurrfarë teprice enzimash GGT (që pinë alkool), i kanë hyrë shkurorëzimit;

- mosinteresimi i babait alkoolist ndaj shtëpisë dhe familjes së tij, për shkak të mungesës së përhershme nga shtëpia;

- përhapja e dukurisë së përdorimit të dhunës së burrit ndaj gruas dhe fëmijëve, që e shton urrejtjen e tyre kundrejt tij. Kështu, hulumtimi, i cili ka përfshirë rreth 100 gra të ekspo-zuara ndaj keqtrajtimit fizik nga burrat e tyre, ka zbuluar se 52 gra janë rrahur nga burrat e tyre - kur ata ishin në gjendje të dehur. Raporte të shumta përmendin se 74% e atyre që u kanë shkaktuar vuajtje të dhimbshme grave të tyre kanë qenë alkoolistë. Në Britani, një numër i madh i tyre kanë bërë keq-trajtime seksuale dhe trupore të fëmijëve duke qenë nën ndikimin e alkoolit, kurse përqindja në SHBA arrin deri në 80%.

- mungesa e kujdesit dhe e butësisë ndaj fëmijëve. Për më tepër, disa prindër i keqtrajtojnë fëmijët seksualisht dhe fizikisht, dhe ndoshta nuk u japin edhe ushqimin e domosdoshëm, ngase e gjithë brenga e babait-alkoolist është se si të arrijë deri të pija, madje edhe në kurriz të fëmijëve.

- përhapja e sëmundjeve shoqërore në mesin e anëtarëve të familjes, e ndoshta edhe përhapja e devijimeve morale, siç është dhënia pas drogës, zhytja në detin e pijeve dehëse dhe veprimet e tjera. Kjo ndodh si reaksion i vrazhdësisë, i mosafri-mit i dashurisë, i butësisë dhe i kujdesit nga ana e prindit. Nuk është fare për t'u çuditur që në gazeta hasim të botuara lajme të këtilla:

- Revista "En-Nur", nr.97, shkurt 1986, ka shkruar: "Hulum-time të shumta shkencore të ndërmarra në SHBA dhe në Gjermani, të cilat i ka përmendur revista "Der Schpiegel", në artikullin për fëmijët alkoolistë tregon se rreth 50-70% e fëmijëve alkoolistë rrjedhin nga familjet në të cilat njëri nga prindërit ka qenë alkoolistë. Revista shton se numri i atyre që pinë alkool në kontinuitet arrin shifrën 12 000 000 në moshën 22-24 vjeçare. Numri i tyre në Gjermaninë Lindore gjatë dy viteve të fundit është rritur tmerrshëm.

Revista "En-Nur", në numrin e vet 25, të muajit muharrem të vitit 1406 h., ka shkruar si vijon: "Në një hulumtim të botuar nga revista "Family circle", në edicionin e vet të vjeshtës, thuhet se çdo i pesti nxënës i shkollës së mesme në SHBA ka pranuar se pi alkool së paku një herë në javë, ndërsa çdo i katërti nxënës pajtohet me pirjen e mariuanës."

Në hulumtimin e bërë në bashkëpunim me Institutin Shtetëror të Prindërve për mbrojtje nga droga, thuhet se pirja e alkoolit është duke u përhapur edhe në mesin e nxënësve të rinj.

Ja pikat më kryesore që janë parashtruar në hulumtimin që ka filluar në vitin 1981, gjatë të cilit janë pyetur mbi 200 nxënës të moshës 10-18 vjeçare, në njëzet e një shtete ameri-kane, shumica prej tyre në pjesën juglindore të SHBA-ve:

- më tepër se 3 000 000 nxënës të shkollës së mesme (25%) pinë mariuanë, çdo i dhjeti pi në vazhdimësi, kurse më tepër se 500 mijë (6%) nxënës të arsimit fillestar pinë mariuanë;

- më tepër se 500 000 (5%) në moshën 10-13 vjeçare pranojnë se pinë alkool një herë në javë. Ky numër është më i madh me 2 500 000 (25%) në rastin e nxënësve të shkollës së mesme, kurse mbi 500 000 nxënës të shkollës së mesme pinë kokainë;

- 2 250 000 nxënës të shkollës së mesme përdorin ilaçe dehëse, 12% përdorin mjete stimulative dhe 6% pinë ilaçe për qetësim.

Në numrin e datës 3.12.1986, gazeta "El-Sherk El-Eusat" shkruan si vijon: "Hulumtimi i bërë në Britani ka treguar se numri i fëmijëve të rritur në Britani që pinë alkool është rritur në përmasa që brengosin njerëzit për mbrojtjen sociale dhe shëndetësinë.

Ajo që i brengos këta njerëz është mosha e vogël e këtyre fëmijëve, të cilët janë bërë gjysmëalkoolistë, dhe shumica e fëmijëve të përfshirë në këtë hulumtim kanë qenë të moshës 12-13 vjeçare dhe kanë pranuar se janë gjysmëalkoolistë, kanë thënë se pinë aq alkool, saqë e humbasin vetëdijen. Kur fëmijëve të moshës 16-18 vjeç, gjatë këtij hulumtimi u janë parashtruar këto pyetje, i kanë pritur ato me një dozë hutimi, ndërsa në përgjigjet e tyre ka njëfarë habie. Ata janë përgjigjur: "Po si, pimë alkool, ndonjëherë madje edhe të llojeve të forta, deri në atë masë saqë e humbasim vetëdijen."

Habia e njerëzve përgjegjës për këtë hulumtim ka arritur një shkallë të lartë kur këta fëmijë kanë pranuar se pinë alkool, duke thënë: *"Kjo gjendje zgjat tanimë disa vjet dhe tani kemi shprehi dhe eksperiencë në pirjen e alkoolit."* E, kur njerëzit përgjegjës i kanë pyetur se sa vjeç ishin kur kanë filluar të pinë alkool, njëri prej tyre është përgjigjur se alkoolin ka filluar ta pijë në moshën 11 vjeçare.

Njerëzit përgjegjës për mbrojten sociale dhe për shëndetësinë thonë se përqindja është e madhe në mesin e fëmijëve të mitur në Angli dhe në Uells. Përsa u përket fëmijëve në Skoci, hulumtimi ka treguar se ata e fillojnë pakëz më vonë pirjen e alkoolit në raport me fëmijët në Angli e në Britani. Zakonisht në Skoci fillojnë të pinë alkool në moshën 13-14 vjeçare, por ata pas një a dy vjetësh barazohen me sasinë e alkoolit që pinë. Hulumtimi, gjithashtu, ka treguar se te disa fëmijë

paraqiten simptomat e qarta të sëmundjeve për shkak të pirjes së tepruar të alkoolit. Hulumtimet kanë treguar disa shenja të sëmundjes nga i thati në stomak dhe në zorrë. Përveç kësaj, në mesin e këtyre fëmijëve, janë paraqitur raste të rrezikshme të delikuencës, siç janë vjedhja, keqtrajtimi trupor, mashtrimi dhe shkatërrimi i pronës së huaj.

Këtë hulumtim, i cili i ka përfshirë 2519 fëmijë të mitur dhe adoleshentë në Angli e në Uells dhe 2389 në Skoci, e ka mbikëqyrur Seksioni për Shëndetin dhe Mbrojtjen Sociale dhe Seksioni për Shëndetin dhe Hospitalizimin nga Skocia.

Revista "El-Islam" nr.97, shkurt, viti 1986, shkruan si vijon: "Në raportin e botuar në Gjermaninë Perëndimore përmendet se numri i alkoolistëve dhe narkomanëve e kalon shifrën 1 500 000 persona.

Prej këtij numri, 25% janë narkomanë, kurse shumica janë alkoolistë. Fakti që shqetëson dhe që ka nxitur frikë te njerëzit përgjegjës është ajo që ka zbuluar raporti, se 27% nga numri i përgjithshëm i të rinjve të moshës 12-14 vjeç pi alkool dy ose tri herë në javë, ndërsa 42% e atyre që kanë moshën 14-16 vjeç pi alkool më tepër se tri herë në javë."

Studimi që kanë bërë në vitin 1986 studiuesit Brans dhe Velt, në Institutin në Nju Jork, qëllimi i të cilëve ka qenë njohja e vëllimit të përhapjes së dukurisë të pirjes së alkoolit në shkollat e mesme në shtetin e Nju Jorkut, ka përfshirë 27335 nxënës të shkollave të mesme.

Këta dy studiues kanë zbuluar se rreth 71% e nxënësve pinë alkool. Prej këtyre 13% pinë alkool me makutëri, d.m.th. së paku një herë në javë.

ALKOOLI DHE PROBLEMET NË PUNË

Buletini special për alkoolin i botuar nga Fakulteti Mbretëror për mjekë të praktikës së përgjithshme shkruan se në Britani është bërë një studim që ka përfshirë një numër të madh alkoolistësh, me ç'rast është zbuluar se alkooli ka qenë shkaktari kryesor i problemeve të ndryshme. Disa prej këtyre problemeve janë:

- 63% e këtyre personave janë pushuar nga vendet e tyre të punës;

- janë zvogëluar përfitimet te 43% e punëtorëve;

- 43% e punëtorëve kanë përjetuar fatkeqësi në punë.

Për sa i përket Bashkimit Sovjetik, përqindja e punëtorëve alkoolistë ka arritur në 37%.

Dëmi që u shkakton alkooli punëdhënësve, që lidhet me ndërmarrje e fabrika, me punëtorë e administrata mund të thuhet si vijon:

- mungesa e përhershme nga puna;

- joaktiviteti (joproduktiviteti);

- paqëndrueshmëria në punë;

- fatkeqësitë dhe lëndimet në punë;

- konfliktet mes punëtorëve dhe administratorëve;

- përhapja e mashtrimeve dhe e intrigave ndër punëtorët.

Në raportin për alkoolin, të përgatitur nga Fakulteti Mbretëror Britanik për mjekë, në vitin 1987 thuhet: "Dy hulumtues, Holtmani dhe Bartsheli, kanë vlerësuar humbjet e gjithëmbarshme të shkaktuara nga alkooli në afro 650 000 000 funta në vitin 1977 dhe në rreth 1 000 000 000 funta në vitin 1984.

Për sa u përket vlerësimeve të fundit të humbjeve në industrinë britanike nga pasojat e pirjes së alkoolit, ato kapin shumën rreth 641 000 000 funta në vit."

Në raport më tej thuhet: "Në hulumtimin e ndërmarrë nga Edvardsi dhe bashkëpunëtorët e tij është gjetur se 98 punëtorë të hetuar për shkak të alkoolit kanë munguar nga puna mesatarisht 68 herë në vit. Prej këtyre punëtorëve, 66% kanë mohuar se kanë munguar nga puna çdo të hënë, duke qenë se fundjavën e kalojnë në zbavitje dhe zhurmë."

ROLI I ALKOOLIT NË BËRJEN E KRIMEVE

Lidhja ndërmjet alkoolit dhe krimit është lidhje e fortë dhe nuk është për t'u habitur që Resulullahu s.a.v.s. e ka karakterizuar alkoolin si "nënën e të gjitha kobeve", ngase alkooli, pasha Allahun, është pikërisht ky, meqë ai është çelësi i çdo kobi.

Nga Uthmani r.a. transmetohet se i Dërguari i Allahut s.a.v.s. ka thënë: "Shmangiuni alkoolit, ngase ai është nëna e të gjitha kobeve! Në mesin e atyre që kanë qenë para jush, ka qenë një njeri i devotshëm, me të cilin është dashuruar një grua e çmendur. Ajo ia dërgon atij shërbëtoren e vet,

përmes së cilës e porosit: "Të thërrasin që të vish, për shkak të dëshmimit." Ai niset me shërbëtorën e saj dhe, në çdo derë që hynte, ajo e mbyllte pas tij, derisa erdhi deri te gruaja e bukur, tek e cila ishte një djalë i vogël dhe një enë me alkool. Atëherë ajo i thotë: "Unë, pasha Allahun, nuk të kam ftuar për shkak të dëshmimit, por që të bësh kurvëri me mua, ta pish këtë gotë me alkool ose ta mbytësh këtë fëmijë. Ai thotë: "Në këtë rast, më jep gotën e alkoolit!" Ajo ia jep gotën me alkool, e ai thotë: "Më jep ende!"Derisa në fund bën kurvëri me të dhe e vret djaloshin. Prandaj shmangiuni alkoolit se, pasha Allahun, nuk gjenden së bashku imani (besimi) dhe pirja e alkoolit e që së shpejti njëri të mos e mbrapsë tjetrin."[30]

Tani këtu do të parashtroj fakte të shprehura me numra, të cilat zbulojnë brishtësinë dhe thyeshmërinë e qytetërimit përendimor dhe dekadencën në të cilën është zhytur ajo nga aspekti shoqëror.

Buletini i botuar nga Fakulteti Mbretëror Britanik për mjekët e praktikës së përgjithshme shkruan si vijon: "Hulumtuesi Smit, në vitin 1984, ka bërë një hulumtim që ka përfshirë një numër të burgosurish në Angli dhe në Uells. Ai ka zbuluar se përafërsisht ndërmjet gjysmës dhe një të tretës së meshkujve dhe 15% e femrave kanë bërë krim nën ndikimin e alkoolit."

Jofferi dhe Saundersi, në vitin 1983, kanë zbuluar se 64% e të burgosurve dhe atyre që janë mbytur kanë pirë alkool vetëm katër orë para se të mbyteshin.

Në numrin 263, dhul-kade 1406 h., revista "El-Vaj El-Islam" shkruan si vijon: "Raporti i bërë nga Zyra për Statistikë e Qeverisë Amerikane thotë se më tepër se gjysma e të burgosurve që janë

[30] Shënon En-Nesaiu.

gjykuar për shkak të dhunimit kanë pranuar se kanë pirë alkool para se të bënin krim. Raporti e ka shpallur këtë në bazë të hetimeve të të burgosurve të akuzuar, numri i të cilëve ishte 23110.

Hulumtimet kanë konkluduar se 54% e dhunëbërësve kanë pirë alkool para kryerjes se krimit. Përsa i përket të gjitha krimeve të tjera, ku hyjnë edhe vjedhja dhe shkelja e rendit publik, të bëra nën ndikimin e alkoolit, përqindja e tyre është 48%."

Ky raport amerikan përmban edhe të dhëna të tjera numërore, të cilat vënë në pah edhe më shumë ndikimin që ka pirja e alkoolit në sjelljet dhunëbërëse. Kështu, është treguar se 7 prej dhjetë të gjykuarve për vrasje, kanë pirë alkool para se ta bëjnë krimin. Shprehur me përqindje kjo është 68%, përderisa përqindja e vrasjeve me paramendim është 49%.

Po kjo revistë përcjell fjalët e ish-ministrit të punëve të brendshme të Rusisë, Fjodorçekut, i cili ka cituar nga revista "Komunisti", se alkooli konsiderohet si shkaktar i një të tretës së krimeve si dhe i përhapjes së tregut të zi.

Revista "En-Nur", nr. 11, gusht 1984, përmend:

"Kuvendi popullor për mbrojtjen sociale në Suedi vlerëson se rreth 300 000 suedezë kanë probleme të ashpra me alkoolin, sepse ai ndikon rrezikshëm në punët, në jetën familjare dhe në shëndetin e tyre. Ky kuvend vlerëson se shpenzimet për shërimin e tyre arrijnë disa milionë funta.

Hulumtimi që ka ndërmarrë ky kuvend sqaron se ekziston lidhje e qartë ndërmjet akteve të dhunës dhe alkoolit dhe aludon se 70% e meshkujve të gjykuar për sulmime të femrave e kanë bërë këtë nën ndikimin e alkoolit."

Raporti për alkoolin në Fakultetin Mbretëror Britanik për mjekë, i vitit 1987, shënon se në vitin 1983 në Angli e në Uells janë bërë 109 728 krime dhe vepra të këqija të kryera nën ndikimin e alkoolit, për të cilat është zbatuar gjykimi gjyqësor. Në Skoci, në vitin 1981, janë gjykuar 22 572 persona për krime që janë bërë për shkak të alkoolit. Numri i atyre që janë gjykuar në Angli e në Uells në vitin 1982 për shkak të ngasjes nën ndikimin e alkoolit, kur niveli i alkoolit në gjak ka qenë më i madh se 80 ml në çdo 100 mililitra gjak, ka arritur në 63 632 persona. Zyrtarët nga Ministria e Punëve të Brendshme të Britanisë përmendin se ky numër është vetëm një pjesë e vogël e realitetit, për shkak se vetëm njëri prej 250 alkoolistëve gjenden nën goditjen e ligjit dhe kundrejt tij zbatohet gjykimi gjyqësor.

Raporti gjithashtu përmend se mbi 50% e të gjitha vrasjeve janë bërë nën ndikimin e alkoolit dhe 50% e viktimave kanë qenë nën ndikimin e pijeve dehëse.

Enciklopedia Britanike përmend se shumica e rasteve të dhunimit seksual të femrave me aferësi gjaku, motra, nëna, vajza (incest), kanë ndodhur nën ndikimin e alkoolit. Po kështu, shumica e rasteve të ngatërresave dhe e përdorimeve të forcës që ndodhin në ndeshjet futbollistike kanë shkak alkoolin (91 persona nga 110 të burgosur kanë shkaktuar ngatërresa e dhunë në një ndeshje futbollistike, për shkak të gjendjes së tyre të dehur).

Doktor Bernti, në librin "Tema rreth shërimit", përmend se 70% e vrasjeve janë bërë nën ndikimin e alkoolit (pijeve alkoolike). Nga ana tjetër, raporti i Organizatës Botërore të Shëndetit, në lidhje me dhunën në 30 shtete ndër të cilat janë SHBA-të, Britania etj., përmend se 86% e krimeve-vrasjeve dhe 50% e krimeve-përdhunimeve të grave janë kryer nën ndikimin e alkoolit.

Gazeta "Daily Mail" (26 Qershor 1980), duke cituar Lord Harisin, i cili e kryesonte komisionin për hetimin e gjendjes së të burgosurve në burgjet e Britanisë, përmend se shumica e të burgosurve në Britani vuan nga problemi i pirjes në sasi të madha të alkoolit. Po kështu, 50% e të gjitha krimeve të dhunës së tmerrshme kanë ndodhur për shkak të pirjes së alkoolit.

ROLI I ALKOOLIT NË RRITJEN E PËRQINDJES SË FATKEQËSIVE AUTOMOBILISTIKE

Burimet mjekësore thonë se aftësia e koordinimit të lëvizjeve (të njeriut) zhduket kur përqindja e alkoolit në gjak arrin 20-30 miligramë në çdo 100 mililitra. Aftësia e të parit gjithashduke e bërë njeriun të nënshtruar ndaj fatkeqësive automobilistike në rastin e drejtimit të automjetit ose të biçikletës (motoçikletës).

Në rastin kur përqindja e alkoolit në gjak arrin 80 mg në çdo 100 mililitra, e kjo është sasia e lejuar nga ligji i trafikut në Austri, Kanada, Danimarkë, Francë, Britani dhe në Zelandë të Re, përqindja e aksidenteve automobilistike rritet dyfish. Në rastin kur përqindja e alkoolit në gjak arrin 150 mg në çdo 100 mililitra, përqindja e aksidenteve automobilistike rritet dhjetë herë. E, kur përqindja e alkoolit në gjak është 200 mg në çdo 100 mililitra gjak, përqindja e këtyre fatkeqësive rritet për 20 herë.

Tani do të shqyrtojmë rrezikun e pirjes së alkoolit në rritjen e përqindjes së aksidenteve automobilistike përmes një grupi të dhënash statistikore për disa shtete evropiane:

Britania

Organizata për luftimin e përdorimit të keq të alkoolit në Britani ka thënë se pirja e tepërt e alkoolit në vitin 1985 ka shkatërruar më tepër se 26 800 njerëz në Britani. Kjo organizatë e ka karakterizuar alkoolin si vrasës të vërtetë dhe ka filluar fushatën e zvogëlimit të pirjes së pijeve alkoolike 30-40%. Vlera vjetore e alkoolit të pirë në Britani vlerësohet në 1680 milion funta. Organizata ka përmendur se gjysma e atyre që janë gjykuar për krime vrasjeje kanë qenë nën ndikimin e alkoolit në çastin e kryerjes së krimit. Nga ana tjetër, njëri nga çdo tre ngarës, të cilët kanë shkaktuar aksidente automobilistike që shkaktojnë vdekje dhe lëndimin e mijëra njerëzve çdo vit, kanë qenë nën ndikimin e alkoolit.[31]

Me fillimin e punës për çdo Vit të Ri, Evropën dhe viset e tjera të botës e kaplon vala histerike dhe e pafrenueshme e aksidenteve automobilistike, të cilat marrin me mijëra jetë njerëzish. Njëri nga oficerët e policisë britanike të trafikut, duke i përshkruar punët për çdo Vit të Ri, thotë se ato shndërrohen në masakra të përgjakshme nga arsyeja se disa drejtues automobili i nënçmojnë jetë njerëzore dhe i ngasin automobilat në gjendje të dehur. Rastet e drejtimit të automobilit në gjendje të dehur në Evropë, në fund të vitit 1986, janë shtuar në përmasa jonormale. Kështu, alkotesti që ka bërë policia britanike e trafikut te personat e dyshuar për ngarje në gjendje të dehur ka zbuluar një numër rekord të personave të tillë. Vetëm në Angli dhe Uells janë zbuluar 1 000 000 persona, prej të cilëve 100 000 kanë përfunduar në gjyq. Numri i të vdekurve në këto aksidente ka qenë më i madh se 10 000 persona. Për këtë shkak, ministri britanik i trafikut, Botomly, thotë: *"Me të vërtetë, ai që nget automobilin e vet në gjendje të dehur në duart e veta mban jetën e vet*

[31] Marrë nga "El-Islah", nr.101, Qershor 1986

dhe jetën e njerëzve të tjerë. E, sikur këta njerëz ta kuptonin sa e rëndë është ajo që bëjnë ata, me siguri se nuk do ta kishin marrë guximin asnjëherë të uleshin para timonit të automobilave të tyre në gjendje të tillë." Duhet përmendur se kufizimet dhe ndalesat ligjore për vepra të këtilla të këqija nuk janë aspak të mjaftueshme. Kështu, shoferi që ka ngarë makinën në gjendje të dehur dhe i ka rënë të riut Xhin Lin Prajsit (20 vjeç.) është gjykuar me dënim në të holla prej 100 funtash. Prindërit e pikëlluar të të riut janë pyetur për këtë e ata kanë thënë: *"A mos vallë kjo është kundërvlera e jetës të djalit tonë, të cilin nuk do ta shohim më kurrë?"* Në shumicën e legjislacioneve botërore dënimi i paparë për vepra të këtilla është gjobitja në të holla dhe marrja e patentës së shoferit për një kohë të caktuar, e cila nganjëherë i kthehet shoferit për më pak se një vit.[32]

Anketa e bërë në Britani tregon se një e treta e ngarësve të automobilave dhe motoçikletave kanë pranuar se kanë pirë alkool gjatë kohës së ngarjes dhe se gjysma e njerëzve të tillë kanë pranuar se kanë ngarë makinën pasi kanë pirë alkool në sasi që tejkalon sasinë e lejuar me ligj. Rezultatet e kësaj ankete (që e ka bërë Instituti i Galupit) kanë treguar se përqindja e rasteve të ngarjes në gjendje dehjeje tejkalon përqindjen e krimeve të vrasjes, të përdorimit të drogës dhe të infektimeve nga Sida. Anketa gjithashtu ka treguar se gjysma e ngarësve në Britani konsideron se fushata e qeverisë për pengimin e ngarjes në gjendje të dehur nuk ndikon aspak tek ata. Qeveria e Britanisë para kësaj pati organizuar një fushatë reklamuese, e cila i ka kushtuar 600 000 funta, dhe ka pasur për qëllim zvogëlimin e pirjes së alkoolit gjatë drejtimit të automjetit.[33]

---

[32] Marrë nga gazeta "Esh-Sherk El-Eusat" më 04.01.1987

[33] Marrë nga gazeta "Er-Rijad" më 13.04.1407 h.

Enciklopedia Britanike thotë se personat e dehur zakonisht i ekspozohen fatkeqësive dhe lëndimeve. Është zbuluar se përqin-dja e ekspozimit të alkoolistëve ndaja fatkeqësisë vdekjepruese është shtatë herë më e madhe sesa përqindja e ekspozimit të personave të thjeshtë, kur merret parasysh numri i përgjithshëm i banorëve. Përqindja e ekspozimit të alkoolistëve ndaj helmimit vdekjeprurës është 30 herë më e madhe, përqindja e ekspozimit ndaj vdekjes, për shkak të rrëzimeve, është 16 herë më e madhe, kurse përqindja e ekspozimit ndaj vdekjes në fatkeqësitë automobilistike është 4,5 herë më e madhe. Këto përqindje të larta nuk reflektojnë vetëm dobësinë (paaftësinë e çdo lloji), e cila është rezultat i rënies së drejtpërdrejtë nën ndikimin e alkoolit, por reflekton edhe mënyrën e jetesës dhe gjendjen në të cilën është personi i dehur.

Franca

Aksidentet automobilistike në Francë marrin 12 000 jetë dhe i shkaktojnë lëndime të ndryshme 300 000 njerëzve. Burim-et zyrtare franceze kanë publikuar se shkaku kryesor për këtë është rritja e përqindjes së aksidenteve automobilistike nga personat që kanë pirë alkool. Kryetari i qeverisë franceze ka nxjerrë ligjin që parasheh arrestimin e çdo shoferi tek i cili vërtetohet se ka pirë alkool gjatë drejtimit të automjetit, si dhe dënimin në të holla për ata që shkelin këtë dispozitë.[34]

Statistikat zyrtare franceze nga Parisi, kanë bërë të njohur se alkooli në Francë çdo vit vret 37 450 persona. Statistikat thonë se alkooli ishte shkaktar i 40% të fatkeqësive në vitin e kaluar, ngase përqindja e personave të dehur që cilët kanë shkaktuar fatkeqësi automobilistike ka arritur 38,8%. Është vërejtur se përafërsisht 30% ngarësve të automobilave në Francë ngasin automobilat kur në

[34] Marrë nga revista "En-Nur" nr.29, xhumadel-ula, 1406 h.

venat e tyre gjenden më tepër se 80 mg alkool në çdo 100 ml. gjak, sasi e lejuar në Francë dhe në Evropë. Statistikat vënë në pah se gjatë ditëve të fundjavës, të shtunën dhe të dielën, regjistrohet numri më i madh i fatkeqë-sive automobilistike vdekjeprurëse.[35]

Belgjika

Çdo vit në shtetet e Bashkësisë Evropiane në aksidentet automobilistike vdesin rreth 50 000 persona, ndërsa 1 600 000 prej tyre pësojnë lëndime trupore. Ministri belg i komunika-cionit thotë se 42% e viktimave të këtyre aksidenteve kanë qenë nën ndikimin e alkoolit. Ky ministër ka publikuar themelimin e Dhomës për Sigurim Tokësor në Bashkimin Evropian dhe ka bërë të ditur se do t'u propozojë partnerëve të tij nga shtetet e Bashkimit Evropian një ndërmarrje të fushatës së gjerë për vetëdijësimin e njerëzve se çfarë shkakton alkooli me rastin e ngarjes së automobilit dhe për t'ua theksuar shoferëve që t'i përmbahen shpejtësisë së kufizuar në rrugë.[36]

SHBA

Studimet shkencore tregojnë se 10 000 000 amerikanë pinë alkool dhe vuajnë nga alkoolizimi dhe se 25 000 raste vdekjesh në vit ndodhin për shkak të aksidenteve automobilistike të shkaktuara nga ngarja e automobilave në gjendje të dehur. Kësaj i shtohen 15 000 raste vdekjesh (dhe vrasjesh) në vit për shkak të sëmundjeve të shkaktuara nga helmimi me alkool.[37]

---

[35] Marrë nga gazeta "Ehl-Sherk El-Eusat", më 24.01.1987

[36] Marrë nga gazeta "El-Sherk El-Eusat", 20.04.1407 h.

[37] Marrë nga studimi i prezantuar Kongresit të Mjekësisë të organizuar nga universiteti "El-Azhar", e që është botuar në revistën "El-Vaj El-Islam", nr.260 në muajin shaban të vitit 1406 h.

Zvicra

Shoqata e ndërmarrjeve zviceriane për sigurim thotë se është shënuar rritja e pandërprerë e numrit të aksidenteve automobilistike të shkaktuara nga ngarja në gjendje të dehur e automobilave. Kjo shoqatë ka vënë në pah se në vitin 1974 numri i këtyre fatkeqësive, të shkaktuara me këtë lloj ngarjeje të shfrenuar, ka qenë 566. Mirëpo ky numër më vonë është rritur me 28% në vit dhe ka arritur në 7222 fatkeqësi.[38]

[38] "El-Vaj El-Islam", nr.263, dhul-kade, viti 1406 h.

BIXHOZI

Bixhozi, gjithashtu është një nga veset më të dëmshme e më të rrezikshme që ka ndaluar Islami. Bixhozi është, sipas Islamit, çdo lojë me të holla, krahas bastit me ndonjë vlerë, ku secili pjesëmarrës është i detyruar të fitojë a të humbë. Çdo lojë e këtillë, prej atyre popullore (p.sh. "unaza", "guri nga krahu", "garat e vrapit", etj.) e "letrave", "shkrepëseve" , "shahut", deri te llotaria - të gjitha këto janë të ndaluara, nëse partnerët luajnë me të holla.

Ndërsa loja miqësore, për hir të zbavitjes e pushimit, por pa depozitim të hollash ose vlerash të tjera, nuk është e ndaluar ngase kjo, në realitet, nuk është bixhoz- me kusht që një lojë e këtillë të mos shndërrohet në pasion që do ta shpiente njeriun nga kufiri i mesatares (përkorësisë) në papunësi e përtaci.

Po kështu, Islami nuk e konsideron të ndaluar nëse një palë, një person, nga vullneti i vet i mirë, ose ndonjë person i tretë të depozitojë të holla për t'i marrë fituesi, por me kusht që partneri tjetër të mos ketë ndonjë borxh ose detyrim për të depozituar nga vetja.

Ndërkaq, bixhozi ku partnerët depozitojnë të holla në ndonjë lojë, dhe çdonjëri përpiqet të fitojë në dëm të tjetrit është i urrejtur dhe rreptësisht i ndaluar (haram) në Islam. Loja e këtillë (bixhozi) konsiderohet sipas mësimit islam si mëkatet më të mëdha.

Kur të merren në konsideratë parimet morale e shoqërore, nga një anë, dhe pasojat e ndikimet e bixhozit te njeriu, nga ana tjetër, atëherë na bëhet i qartë qëndrimi i këtillë i Islamit kundrejt bixhozit.

Parimi islam është se muslimani duhet të fitojë pasuri me punë të ndershme. Pasuria e huaj, sipas Islamit, është e mbrojtur dhe e pacënueshme (parimi i lirisë së pasurisë), prandaj askush nuk guxon ta marrë a ta përvetësojë atë, përveçse në mënyrë ligjore (p.sh. me anë të ndërrimeve të pronave ose me anë të dhuratës).

Ndërkaq, marrja e pasurisë së dikujt me anë të bastit ose bixhozit paraqet përvetësimin e pronës së huaj në mënyrë joligjore dhe jo të ndershme, e kjo sipas Kur'anit është e ndaluar rreptësisht për muslimanët.

"Mos i hani pasurinë njëri-tjetrit pa të drejtë" (El-Bekare: 188)

Kumarxhiu e shkatërron dhe e shkapërderdh pasurinë e vet, e kjo sipas Islamit është e ndaluar. Bixhozi e pushton njeriun psiqikisht dhe ia merr të tërë kujdesin, e dalldis atë dhe, në njëfarë mënyre, e deh porsi alkooli. Prandaj ai gjithë fuqinë dhe kohën e vet e shpenzon në punë të dëmshme, e kjo sërish, sipas Islamit, është mëkat i posaçëm. Bixhozi u shkakton njerëzve entuziazëm të tepruar e të dëmshëm, zhgënjim, urrejtje të ndërsjellë, e kjo është e ndaluar dhe mëkat (haram).

Sikundër shumë dukuri e shprehi shoqërore, edhe bixhozi sot në botën e kulturuar është vënë nën thjerrëzën e shkencës dhe të studimeve, e quajtur zakonisht "psikologjia e bixhozit". Këto

studime zbulojnë tërë tmerrin dhe trishtimin e bixhozit, të cilat nuk mbesin prapa trishtimeve të alkoolit e drogës, nëse nuk i tejkalojnë këto.

Kur bixhozi i bëhet njeriut pasion e shprehi, e kjo ndodh shpejt, atëherë ai është bixhozçi dhe në këtë rast mund të thuhet se ky njeri është i zhytur, i humbur, derisa të shpëtojë nga ky kob. Psikiatërt i kanë vëzhguar bixhozxhinjtë dhe kanë shënuar deklaratat dhe rezultatet e vëzhgimit të tyre. Entuziazmi më i madh dhe një lloj kënaqësie e tepruar e kaplon bixhozçiun zakonisht gjatë lojës ose bastit. Njëri prej tyre thotë: *"Për mua rëndësia (vlera) e jetës është vetëm në atë gudulisje dhe entuziazëm të jashtëzakonshëm gjatë kohës së lojës."*

I dyti thotë: *"Kur luaj bixhoz, humbas çdo ndjenjë për rrethin, pa marrë parasysh se kush gjendet aty. Atëherë për mua nuk ekziston asgjë."* Një kumarxhi nuk ka ardhur në varrimin e babait të tij, vetëm pse nuk ka mundur të ndërpresë bixhozin e vet! Mjaft martesa dhe familje janë shkatërruar për shkak të bixhozit. Pasioni për bixhoz ia shkatërron njeriut të gjitha virtytet kryesore dhe vlerat njerëzore, ia mbyt arsyen, dinjitetin njerëzor dhe nderin. Bixhozçiu është i gatshëm të mashtrojë, të gënjejë, të vjedhë, madje edhe të vrasë njeriun, vetëm e vetëm që të arrijë deri te mjetet për bixhoz. Gjëja më e keqe është se kumarxhinjtë këto veprime çnjerëzore nuk i konsiderojnë dot si krime, meqë kumari ua shkatërron vetëdijen dhe aftësinë e gjykimit normal njerëzor.

Me siguri se për shkak të ndikimit të këtillë të bixhozit në psikën dhe vetëdijen e njeriut, si dhe për shkak të mungesës së vetëdisiplinës dhe rregullit, bixhozi po përhapet tmerrësisht dhe po merr vrull të fuqishëm në mbarë botën. Kjo më së miri shihet nga të dhënat që dalin herëpashere në dritë. Në vitin 1968 në Amerikë njerëzit kanë depozituar në baste, vetëm në vrapimet e kuajve, rreth katër miliardë e gjysmë dollarë. Mendohet se në vitin 1968 amerikanët kanë depozituar në

baste dhe në bixhozet e tjera të llojllojshme mbi njëqind miliardë dollarë. Bixhozi është në përhapje e sipër edhe te ne, edhe pse, së paku në një pjesë, ligjet e ndalojnë atë. Një "punë" dhe "zanat" i palejuar mund të gjendet nëpër qytetet dhe fshatrat tona, pikërisht te banorët muslimanë. Edhe pse zakonisht këta janë njerëz që nuk dinë asgjë për Islamin dhe nuk kanë fituar edukatë islame, megjithatë edhe këta paraqesin turp e fatkeqësi, si për veten e tyre ashtu edhe për muslimanët, madje edhe për bashkësinë mbarëkombëtare.

Kur të merren parasysh të gjitha këto, atëherë pra bëhet e qartë përse Islami e ka ndaluar aq vendosmërisht çdo lloj bixhozi, lojë me të holla, madje qoftë kjo edhe në sasi tejet të vogël. Atëherë na bëhet e qartë madhështia dhe lartësia e atyre fjalëve kur'anore, ku ndër të tjera thuhet se bixhozi është "punë e ndyrë e djallit", të cilën muslimani duhet ta hedhë shumë larg vetes dhe t'i shmanget vendosmërisht për hir të fatit të vet dhe për hir të dinjitetit njerëzor. Kjo është thënë në ajetin e cituar më herët: *"O besimtarë! Me të vërtetë, vera, bixhozi, statujat dhe shigjetëzat e fallit janë gjëra të ndyra, punë djalli. Prandaj largohuni nga këto që të arrini atë që dëshironi! Djalli dëshiron që, me anë të pijeve alkoolike e me bixhoz, të fusë në mes jush armiqësi e urrejtje dhe t'ju shmangë juve nga të kujtuarit e All-llahut dhe nga namazi. Pra, a do të shmangeni?!" (El–*Ma'ide: 90-91)*

Këto Fjalë të All-llahut në Kur'an vërtet janë madhështore. Në pika të shkurtra, tregojnë përsosmërisht thelbin dhe fotografinë tmerruese të dy kobeve të mëdha: të alkoolit dhe të bixhozit. Këto fjalë hyjnore, këto të vërteta të lartësuara për dëmin e bixhozit, tregojnë të gjitha ato ndikime të rrezikshme dhe shkatërruese të këtij kobi, mbi të cilin folëm paraprakisht. Këto fjalë të lartësuara çdo musliman duhet t'i vërë në zemrën dhe në vetëdijen e vet, si bazë dhe udhëzim për parimin (rregullin) e vet jetësor; që asnjëherë dhe në asnjë rrethanë të mos merret e

të mos zbavitet me bixhoz, d.m.th. me bast ose me ndonjë lojë tjetër me të holla;nëse dëshiron të mbetet dhe të jetojë si njeri dhe si musliman. Mëkati i madh i bixhozit, sipas Islamit, duket qartë, përveç fjalëve kur'anore, edhe nga disa hadithe. Kështu, sipas një transmetimi, Muhamedi s.a.v.s. ka thënë:

"Kush e thërret shokun e vet të luajë bixhoz, le të pendohet dhe le të ndajë sadaka!"

Kjo do të thotë: Nëse njeriu ka vendosur, është nisur ose e ka ftuar dikë, për të luajtur bixhoz, duhet të pendohet menjëherë dhe të heqë dorë nga kjo dhe si pjesë përbërëse e pendimit duhet të ndajë sadaka (lëmoshë). Me këtë njëkohësisht theksohet se të hollat që njeriu do t'i shpenzonte në bixhoz, është më mirë të jepen për qëllime mirëbërëse.

Loja me të holla, bixhozi, nuk mund të arsyetohet assesi sipas Islamit. Arsyetimet dhe përallat se bixhozi mund të ketë edhe disa qëllime humane - si p.sh. bingoja ose llotaritë e llojllojshme, të cilat ngadonjëherë jepen për "qëllime mirëbërëse" nuk kanë vend e as arsyetim në Islam. Sipas konceptit islam, njerëzit duhet të kultivojnë dhe të zhvillojnë ndjenjat, vullnetin dhe interesimin për dhënie të vetëdijshme, sado e vogël qoftë, për qëllime mirëbërëse, ngase vetëm kështu ata e realizojnë aktin human. Duke i lënë dikujt "mirësi" me anë të bixhozit, bingos etj., e mund të shkaktohet dëmi i panevojshëm e i palejueshëm, edhe ndaj vetvetes edhe ndaj të tjerëve, meqë në këtë mënyrë hapet rruga, gjasat dhe mundësitë për sajimin e shprehisë së keqe të bixhozit. Prandaj muslimani i vetëdijshëm dhe i ndershëm nuk do t'i hidhte paratë e veta në bingo ose në ndonjë lojë tjetër bixhozi për hir të ndonjë "qëllimi human", pasi më me endje do t'i jepte për ndonjë qëllim të caktuar bamirës. Ai nuk do të merrte pjesë në bingo ose në çdo lloj tjetër bixhozi pa kurrfarë preteksti.

PËRDORIMI I DUHANIT

Duhani është i njohur për të gjithë, siç është e njohur edhe përhapja e tij në botë, por shumica, si duket, nuk e njohin dëmshmërinë dhe absurditetin e tij. Në përdorimin e duhanit shihet se sa janë njerëzit robër të shprehive të tyre dhe sa të dobët janë para kërkesave të veta.

Atdheu i duhanit është Amerika, prej nga është përcjellë në Evropë në fillim të shekullit XVI. Duke qenë se kjo ishte risi, në të cilën janë vënë re edhe pasojat negative, pushtetarët e Evropës, në fillim e kanë ndaluar përdorimin e duhanit. Porse në botë përhapeshin lajme të pabaza, se duhani është bimë çudibërese dhe ilaç për të gjitha sëmundjet. Me siguri, në bazë të këtyre besëtytnive, por edhe për shkak të makutërisë njerëzore për atë që ndalohet, duhani përhapej vrullshëm e gjithnjë e më shumë, përkundër të gjitha ndalesave. Sa e vështirë është braktisja e pirjes së duhanit për ata që njëherë fillojnë ta pinë, duhanxhinjtë e vjetër e kanë edhe më vështirë ta braktisin shprehinë e tyre, ndërsa të rinjtë pandërprerë! Duhani përmbyti së pari Evropën, e pastaj pjesën tjetër të botës. Kur edhe vetë shtetet filluan të themelojnë monopole në duhan, përhapjes së tij, në njëfarë dore, iu hap rruga legale. Të parët që e bënë këtë ishin francezët, në gjysmën e dytë të shekullit XVIII.

Prodhimtaria dhe përdorimi i duhanit, gjatë tërë historisë së tij e deri më sot, është në zhvillim dhe në rritje të përhershme. Së pari prodhuesit privatë dhe tregtarët, pastaj monopolet, kanë shikuar gjithnjë në qarkullimin e madh të duhanit vetëm fitimet e veta të mëdha. Në prag të Luftës së Dytë Botërore, prodhimtaria botërore e duhanit ka qenë 2 610 000 tonë.

DËMI I DUHANIT

Duke qenë se në kohët e hershme nuk është ditur sesa i dëmshëm është duhani, disi mund të kuptohet, e ndoshta edhe të tolerohet përdorimi i tij. Mirëpo, tanimë kjo nuk është e mundur. Shkenca që moti, e sot edhe më tepër, e ka zbuluar dëmin e madh të duhanit për shëndetin e njerëzve. Tani dihet me siguri të plotë se dëmi i tij është i shumëfishtë. Para së gjithash, dihet se duhani përmban një lloj helmi që quhet Nikotinë. Ky helm ndikon në organet e frymëmarrjes dhe mund të shkaktojë astmën bronkiale; ndikon në zemër duke shkakëtuar çregullimin e rrahjeve të zemrës (aritminë), në venat e gjakut, në organet tretëse, etj. Nëse dikush pi së tepërmi duhan, mund të pësojë helmime me nikotinë. Veçanërisht do të ishte e vlefshme të kihet parasysh ndikimi i dëmshëm i nikotinës në sistemin nervor. Mjekësia sot, përveç asaj që u përmend, e sjell në lidhshmëri të ngushtë pirjen e duhanit me sëmundje më të rrezikshme të kohës sonë, me sëmundjen e kancerit, duke pohuar se duhani është njëri nga shkaktarët e kësaj sëmundjeje të rrezikshme, nëse së paku i përshtatet asaj. Në realitet, hulumtimet kanë treguar se ka shumë më tepër të sëmurë nga kanceri në fyt, në buzë dhe në mushkëri nga mesi i atyre që pinë duhan sesa nga mesi i atyre që nuk e bëjnë këtë.

Po kështu, pirja e duhanit veçanërisht ndikon dëmshëm në shëndetin e të rinjve. Helmi i duhanit (nikotina) rrezikon dhe shkatërron organizmin e tyre të brishtë (delikat). Djelmoshat, madje edhe fëmijët, pinë duhan duke marrë si shembull më të vjetërit dhe duke menduar se me anë të pirjes së duhanit do ta tregojnë rëndësinë e tyre dhe njëfarë barazie me të rriturit, duke menduar se tanimë kanë hyrë në radhët e të rriturve. Çfarë naiviteti dhe papjekurie, çfarë mosdije dhe mungesë e arsyes në dëm të vetvetes, në dëm të shëndetit dhe fatit të tyre!

Duhani u shkakton dëm jo vetëm shtatëzënave, por edhe fëmijëve të tyre. Gratë e tilla i ekspozohen fuqishëm lindjes së parakohshme. Përkundër të gjithave, me pirjen e duhanit femrat rrezikojnë bukurinë dhe freskinë e tyre. Një mjek ka vënë re:

"Sikur ta dinin femrat se sa dëme i sjell pirja e duhanit bukurisë së tyre, nuk do ta ndiznin madje asnjë cigare."

Për shkak të gjitha këtyre, sot në botën e kulturuar gjithnjë e më tepër luftohet kundër pirjes së duhanit, si edhe kundër pirjes së alkoolit e përdorimit të drogës. Këtë luftë, te ne dhe në botë, e udhëheqin mjekët më të spikatur dhe institucionet më të famshme shëndetësore. Në disa vende tanimë është ndaluar reklamimi i duhanit, si p.sh. në Amerikë dhe në Arabinë Saudite. Në disa të tjera është urdhëruar që nëpër pakot e cigareve të shkruhet: "E rrezikshme për shëndetin".

PIRJA E DUHANIT NË SHOQËRINË MUSLIMANE DHE QËNDRIMI I ISLAMIT PËR KËTË ÇËSHTJE

Përhapja e duhanit ndër shtetet dhe popujt muslimanë është zhvilluar kryesisht sikundër edhe në shtetet evropiane. Nga shtetet muslimane duhani është paraqitur së pari në Mbretërinë Turke, në përbërje të së cilës ka qenë edhe shteti ynë. Kjo ka ndodhur në fund të shekullit XVI dhe në fillim të shekullti XVII. Në Hercegovinë duhani ka filluar të mbillet në gjysmën e parë të shekullit XIX, në kohën e Ali-pashë Rizvanbegoviçit (1833-1815). Asokohë tek ne është zhvilluar edhe esnafi i veçantë, i përbërë nga shitësit dhe grinsit e duhanit (tutunxhinjtë dhe havaxhinjtë).

Paraqitja e duhanit në shoqërinë muslimane ka shkaktuar probleme, polemika dhe rezistencë të fuqishme. Mësuesit e mëhershëm islamë (ylemaja) deri në gjysmën e dytë të shekullit XIV nuk kanë thënë asgjë në mënyrë të prerë për pirjen e duhanit, ngase në kohën e tyre nuk ka pasur fare duhan. Por bashkëkohësit e paraqitjes së tij dhe të periudhës së parë të tij kanë reaguar shpejt e qartë dhe kanë dhënë mendime për të. Disa prej tyre kanë konsideruar se përdorimi i duhanit në aspektin islam është i lejuar (hallall), duke marrë parasysh se ai nuk deh dhe sipas mendimit të tyre nuk është i dëmshëm. Mirëpo, shumica prej tyre dhe ata më të spikaturit menjëherë kanë thënë se duhani është i ndaluar (haram), ose së paku se është risi e qortuar dhe e dëmshme.

Ndër dijetarët e parë islamë që kanë filluar ta ndalojnë duhanin ka qenë udhëheqësi suprem fetar i muslimanëve në Stamboll, Shehul-Islam Fahrudin Muhamed Çivizade (vdiq më 995/ 1586). Ai në gjysmën e dytë të shekullit XVI ka luftuar vendosmërisht, edhe me fjalë, edhe me penë, kundër disa dukurive të dëmshme, të cilat asokohe kishin marrë hov në botën islame, si: duhani, kafeja, burmuti dhe opiumi. Atij iu bashkuan dhe e përkrahën shumë alimë të shquar.

Sulltan Murati IV (1623-1640) për këtë arsye e pati ndaluar duhanin edhe pati nxjerrë ligjin që parashihte dënimin me vdekje për duhanxhinjtë. Në disa vende (Persi) në fillim të përhapjes së duhanit duhanxhinjtë i ndëshkonin me rrahje.

Njerëzit e dijshëm (ylemaja) në Bosnje, gjithashtu e gjykonin dhe e ndalonin përdorimin e duhanit. Ka pasur raste kur shumë njerëz fillonin të pinin duhan duke mos ditur asgjë për të e veçanërisht për pasojat e tij të dëmshme, prandaj, kur pas përvojës së parë ndienin pakënaqësinë e pirjes, siç është edhe kundërmimi i pakëndshëm, ndonjëri shpejt pushonte së përdoruri dhe pastaj i këshillonte të tjerët që të vepronin ashtu. Ndër pirësit e parë të duhanit në Bosnjë dhe

Hercegovinë, të cilët e kanë hedhur duhanin pas përvojes së keqë me të, ka qenë alimi ynë i shquar, Sufiu, dhe poeti nga shekulli XVII, Shejh Hasan Kimiu, i lindur në Sarajevë, vdiq në Zvornik në 1690. Ai ka përshtatur një poemë instruktive (kaside) në gjuhën tonë për dëmin e duhanit, duke parapëlqyer mësime të sinqerta, këshilla dhe lutje që njerëzit t'i shmangen përdorimit të duhanit. Nga kjo poemë shihet se ky kob është përhapur me shumicë qysh në kohën e tij. Ai duhanin e quan "punë e ligë" e cila i sjell njeriut turpin dhe kundërmimin e pakëndshëm. Vetë duhanin e quan me fjalën turke "tutun", kurse për përdorimin e tij (pirjen) thotë ndonjëherë sipas mënyrës së të shprehurit turk "pi duhan". Kështu, ndër të tjera, në poemën e përmendur ai u porosit bashkëqytetarëve të vet për duhanin edhe këtë:

Është punë e ligë,

Ta pish është turp,

Ngase është gjynah.

Braktisni duhanin!

Në të ankthe të ashpra,

Të gjitha rrobat qelben,

Çdokujt i gërditen.

Braktisni duhanin!

Edhe ne e kemi pirë,

Dhe ishim në qelbësirë,

Por si bogomilët.

Braktisni duhanin!

Një dijetar dhe shkrimtar tjetër nga shekulli XVIII (Mustafai, i biri Muhamedit, Akhisari, nga Prisci, vdiq më 1169/1755) ka shkruar një shqyrtim të vlefshëm në gjuhën arabe për kafenë, opiumin dhe duhanin.[39] Në të autori ynë parashtron mendimet e shumë mësuesve të shquar për ndalimin e duhanit, pasi ai paraqet shumë dëme të llojllojshme dhe thotë: *"Të gjitha dëmet e duhanit nuk mund të njehsohen, as të shënohen"*. Mendim të tillë dijetarët eminentë të Islamit e kanë dhënë, në bazë të vrojtimeve të tyre të dëmeve të duhanit, të cilat qysh atëherë i kanë vërejtur dhe, kryesisht, i kanë prezantuar kështu: *"Dobësi-mi i shëndetit te duhanxhiu, humbja e oreksit, çrregullimi i funksioneve të disa organeve, e veçanërisht të mëlçisë."* Përveç kësaj kanë thënë: *"Duhanxhiu përhap rreth vetes tym dhe kundërmim të pakëndshëm dhe kështu, me ndotjen e ajrit, shqetëson mjedisin e vet. Ky është shkak i mjaftueshëm për t'u gjykuar e për t'u ndaluar duhani, meqë parimi islam është: "Të mos shqetësohen njerëzit e tjerë"*. Krahas kësaj, me pirjen e duhanit prishen të hollat pa kurrfarë dobie, e vetë kjo u është ndaluar muslimanëve (haram).

[39] Shqyrtime të ngjashme, në të cilat ndalohet përdorimi i duhanit, gjenden në numër të madh ndër doreshkrimet e kësaj biblioteke nga shkrimtarë të njohur e të panjohur.

Përveç parimeve dhe rregullave islame, të përmendura më herët, për ruajtjen e shëndetit dhe të pasurisë nga çdo gjë që i rrezikon e i shkatërron ata, në Islam ka edhe shumë rregulla nga të cilat mund të kuptohet dhe të konkludohet qartë se ndër gjërat dhe shprehitë e tjera të dëmshme edhe përdorimi i duhanit është i ndaluar. T'i përmendim së paku disa prej tyre, në mënyrë që qëndrimi i Islamit dhe mësuesve islamë në raport me duhanin të na bëhet më i qartë: Këto janë rregulla të përgjithshme, që na udhëzojnë të marrim një qëndrim më të mirë lidhur me këtë çështje, si dhe për shumë çështje të ngjashme që mund të na parashtrohen në jetë.

I Dërguari i All-llahut s.a.v.s. i mëson njerëzit se Zoti ka lejuar çdo gjë që është e bukur dhe e shëndoshë, e ka ndaluar të gjitha gjërat që janë të shëmtuara e të dëmshme.

Se edhe duhani bie në gjërat e shëmtuara e të dëmshme të epsheve të njeriut, kuptojmë nga Kur'ani ku Zoti thotë:

"Mos ndiq pasionin tënd të ulët dhe mos iu bind atij, se ai do të të shpie në lajthitje, larg rrugës së drejtë të All-llahut." (Sad:26)

"Mos ndiqni epshet dhe ëndjet e ulëta, që të mos shmangeni nga e vërteta dhe rruga e drejtë." (En-Nisa: 135)

"Kush i frikësohet gjyqit të Zotit dhe e dëbon shprehinë e vet të keqe dhe epshet, vendi i tij është në Xhenet." (En-Naz'at: 40)

Askush nuk mund të mohojë se pirja e duhanit është kryesisht pasion dhe ëndje (kërkesë) e dëmshme.

Hadithet:

- "Askujt (as vetvetes, as tjetrit) nuk guxon t'i shkaktohet dëm!"

- "Ruhuni nga epshet dhe ëndjet e ulëta, ngase ato njeriun e bëjnë të verbër dhe të shurdhër!"

- "Lufta më e mirë është të luftosh kundër egos sate të keqe dhe ëndjeve të tua."

Duke marrë parasysh të gjitha qëndrimet e përmendura nga mësimet islame dhe duke pasur parasysh ato që janë zbuluar deri më sot për dëmin e duhanit, dhe që kuptohet e zbulohet ende në shkencë;me siguri të plotë mund të thuhet se përdorimi i duhanit, sipas mësimit islam, është e urryer dhe i ndaluar. Kjo sidomos vlen kur mjeku specialist i rekomandon njeriut që ta lërë duhanin në interes të shëndetit të tij.[40]

Nga e gjithë kjo shihet qartë se sa kanë të drejtë dijetarët islamë (ylemaja), të cilët e kanë gjykuar dhe ndaluar përdori-min e duhanit dhe se sa janë të mëdha e të lartësuara ato rregulla e parime islame në bazë të të cilave ata kanë marrë qëndrim të këtillë dhe kanë dhënë zgjidhje të tillë. Këto rregulla dhe zgjidhje të ylemave duhen nderuar dhe zbatuar në praktikë. Me të vërtetë është dukuri e pikëllueshme që të kesh kësi rregullash përparimtare dhe të mëdha e të mos sillesh sipas tyre, por të pranosh sjellje dhe shprehi të dëmshme të përkundërta me këto!

Prandaj, çdo musliman që pi duhan, në realitet e vë veten në një situatë të çuditshme, tragjikomike, për të cilën do të duhet të mendojë thellë dhe të shikojë veten dhe sjelljet e tij nga

[40] Një qëndrim të këtillë e ka pasur dhe e ka shënuar qartë edhe njëri nga dijetarët dhe shkrimtarët më të shquar islam, rektori i El-Ahzenit, Muhamed Sheltuti, vdiq më 1963; shih veprën e tij "El-Fetava."

aspekti i zgjuarsisë dhe i Islamit. Kur të veprojë kështu, do ta gjejë veten në një situatë të palakmueshme, një fotografi e shëmtuar, të cilën ai kurrë nuk do t'ia lejonte vetes, po të mendonte lirshëm e arsyeshëm dhe po ta shikonte këtë fotografi me sy dhe shpirt të zgjuar (vigjilent). Ky është shembulli ose fotografia e njeriut që për çdo ditë djeg nga një banknotë para syve të tij duke u kënaqur me tymin dhe flakën e saj. Kushdo që vepron kështu, në mënyrë absurde dhe të padobishme, po shkatërron paratë e veta. Në realitet, ai me dhënien e parave për duhan, të cilin e ndez menjëherë para syve të vet, në fakt, i humb këto para sikur t'i kishte djegur drejtpërdrejt, vetëm për se me pirjen e duhanit, së bashku me shkatërrimin dhe humbjen e parave, i shkakton edhe dëme shëndetit të vet. Pra, vetëdijshëm dhe vullnetarisht ai i jep të hollat e veta për diçka që ia rrezikon dhe ia helmon shëndetin. Atëherë vallë, a nuk është kjo një pozitë e çuditshme dhe e pakuptueshme e duhanxhiut, duke qenë rob i pirjes së duhanit? Kjo tregon se si njeriu ngandonjëherë është shumë i dobët dhe i paarsyeshëm kur ka të bëjë me kërkesat dhe shprehitë e tij, të cilat do të duhej t'i flakte. Për këtë duhet të kihet guxim dhe vullnet i fortë, e feja jonë e lartësuar-Islami-u jep pasuesve të vet kështilla të çmueshme dhe u mëson guximin dhe forcimin e vullnetit, që të mund t'i përballojnë të gjitha pasionet dhe vetitë e këqija, vetëm nëse sinqerisht e pranojnë këtë mësim dhe këto këshilla.

Vëlla i dashur, motër e dashur, të moshuar e të rinj, djalë, vajzë dhe djalosh! Ti po e sheh dhe po e kupton qartë, duke lexuar ç'është parashtruar këtu, se feja jote e lartësuar, Islami, e urren dhe e ndalon pirjen e duhanit, prandaj urreje dhe braktise edhe ti dhe përmbaju fesë sate; do të jesh fatlum dhe i kënaqur gjatë gjithë jetës, ngase do të shpëtosh nga një shprehi e dëmshme, nga një kob tejet i madh. Nëse fatkeqësisht, pa vetëdije apo nga mosdija, ke rënë në këtë kob dhe ke bërë shprehi që të pish duhan, përpiqu me të gjitha forcat që të shkëputesh nga kobi dhe të braktisësh

duhanin. Nuk duhesh të hutohesh nga fakti se në mesin e shumë duhanxhinjve sheh mësuesin e fesë (ylemanë) dhe mjekun. Edhe ata në fillimin e pavetëdijshëm, kur nuk kanë ditur, kanë rënë në këtë shprehi e nuk munden lehtë ta braktisin por të gjithë do të dëshironin të mos ishin duhanxhinj. Nëse ende nuk ke hyrë në këtë kob, ruaju e assesi mos e bë shprehi të pish duhan! Mos bjerë nën ndikimin e askujt; as të "miqve", as të "shoqërisë", e as të "modës", të cilët do të donin të të shpinin e të të bindnin në këtë kob të dëmshëm. Nuk e ke shok të mirë, nuk e ke shoqëri të mirë, nuk është as njeri i kulturuar ai që do të ta mbushë mendjen që të pish duhan, prandaj mos bjer nën ndikimin e tyre! Nuk mund të jetë moderne ajo që është e dëmshme dhe që e shkatërron shëndetin dhe fatbardhësinë tënde. Motoja jote e jetës le të jetë: *"Duhani është i dëmshëm e i padenjë, duhanin e braktis përgjithmonë!"*

Prandaj, vëlla i dashur dhe motër e dashur, kudo që të jeni përmbajuni këshillave dhe mësimeve shpëtimprurëse të fesë suaj të lartësuar-Islamit, duke qenë të vetëdijshëm se në këtë mënyrë do ta mbroni më së miri dinjitetin dhe nderin tuaj njerëzor!

VRASJET
DHE GRINDJET

"Musliman i vërtetë është ai musliman nga gjuha dhe duart e të cilit janë të qetë dhe të sigurtë të gjithë njerëzit."

Ndër mëkatet që po përhapen në disa vende e vendbanime muslimane, pra në mjedisin tonë musliman, janë grindjet, rrahjet dhe vrasjet. Sipas Islamit këto janë mëkate të turpshme e të rënda, prandaj assesi nuk duhet të kenë vend në mesin e muslimanëve. Islami i detyron pasuesit e vet në parimin e respektimit të të drejtave të njeriut dhe të jetave të njerëzve. Islami, në të vërtetë, është fe e drejtësisë, e humanitetit dhe e sjelljes së mirë.

Islami e konsideron të shenjtë jetën e njeriut, të cilën askush nuk guxon ta përdhosë e ta shkatërrojë. Shkatërrimi i padrejtë i jetës së dikujt është karakterizuar dhe është shpallur në Islam jo vetëm ndër mëkatet më të mëdha ndaj Zotit dhe ndaj fesë, por edhe si krim ndaj njerëzimit. Kjo është thënë shprehimisht në Kur'an:

"Kush e vret një njeri të pafajshëm, i cili nuk ka bërë ndonjë vrasje ose trazirë në Tokë, është sikur t'i kishte vrarë të gjithë njerëzit." (El-Maide: 32)

Prej këtu shihet qartë se Islami e konsideron gjininë njerëzore si një familje të madhe, anëtarët e së cilës duhet të mbrohen e të ndihmohen në mes vete e jo të mbyten. Një qëndrim të tillë të

humanitetit dhe të respektimit të jetës së njeriut Islami e përfaqëson ndaj të gjithë njerëzve, pa marrë parasysh ngjyrën, racën, përkatësinë fetare e ideologjike të tyre. Njerëzit, pas përpjekjeve të gjata e të lodhshme, këtë mendim të madh e kanë futur në Dokumentin për të Drejtat e Njeriut, përpiluar pas Luftës së Dytë Botërore. Në pikën 3 të dokumentit, thuhet: *"Çdo individ ka të drejtën për jetë, për liri dhe për siguri personale."*

Sipas kësaj pike, Dokumenti i Kombeve të Bashkuara është detyrë qytetare, morale dhe ndërkombëtare e të gjithë njerëzve, individëve e popujve, që e pranojnë këtë dokument.

Ndërkaq në Islam, qysh para katërmbëdhjetë shekujsh, ky parim është dhënë dhe formuluar si detyrë fetare e morale e çdo besimtari islam. Këtë e vënë në pah edhe fjalët e Muhammedit s.a.v.s., i cili ka thënë:

"Musliman i vërtetë është ai musliman nga gjuha dhe duart e të cilit janë të qetë dhe të sigurtë të gjithë njerëzit."

Prej këtu kuptohet qartë se muslimani, në ujdi me fenë e tij, nuk guxon t'i shqetësojë, e lëre më t'i rrezikojë njerëzit e tjerë as me fjalë, as me vepër.

Ky është parimi i gjithëmbarshëm në marrëdhëniet ndaj njerëzve. Kur Islami një parim të këtillë e vë nga aspekti i raporteve ndaj njerëzve në përgjithësi, atëherë mund të kuptoj-më se çfarë parimesh e dispozitash merr në raportet midis vetë muslimanëve.

Për këtë çështje, d.m.th. për marrëdhëniet e ndërsjella të muslimanëve, këtu duhet të thuhet diçka më gjerësisht veçanërisht në lidhje me rastet e shpeshta të sjelljeve jokorrekte jonjerëzore, madje

edhe të grindjeve më të reja siç theksuam më parë. Prandaj kjo çështje është lëndë e shqyrtimit tonë.

Nga pikëpamja e mirësjelljes së mirë reciproke ndër muslimanët, brenda bashkësisë vëllazërore muslimane, ekzistoj-në shumë udhëzime të rëndësishme dhe rregulla të qarta në vetë Kur'anin dhe Hadithin, të cilat muslimanët duhet t'i njohin dhe duhet t'i veprojnë nëse dëshirojnë të jenë njerëz dhe muslimanë.

All-llahu xh.sh. thotë në Kur'anin e Madhëruar:

"Besimtarët ndërmjet vete janë vëllezër, prandaj mbajeni rendin, qetësinë dhe bashkimin në mes vëllezërve! Shmangiuni mëkateve ndaj Zotit, në mënyrë që Ai t'ju dhurojë mëshirën e Vet!" (El-Huxhurat: 10)

Pra, Bashkësinë Vëllazërore të Muslimanëve e ka themeluar vetë All-llahu xh.sh., Krijuesi i Gjithëfuqishëm, dhe neve na ka lënë Kur'anin e Madhëruar. Prandaj, kush do të mundte dhe do të merrte guxim që ta shkelë dhe ta shkatërrojë këtë vëllazëri me grindje, me sharje dhe me rrahje? Ai që ka besim në zemrën e vet, nuk do ta bëjë dot këtë. Duke qenë se muslimanët janë vëllezër, ata duhet të duhen, të pajtohen, të këshillohen dhe të ndihmohen, e jo të urrehen e ta xhelozojnë njëri-tjetrin. Të dëgjojmë se ç'na thotë Muhamedi s.a.v.s. në lidhje me këtë:

"Mos ia kini zili njëri-tjetrit, mos i bëni armiqësi njëri-tjetrit dhe mos u urreni ndërmjet vete, por jini që të gjithë robër të mirë të All-llahut dhe vëllezër!"

Zilia është ndjenjë lakmie e keqdashjeje për shkak të mirëqenies e fatbardhësisë së dikujt, respektivisht, kur dikujt nuk i pëlqen dhe e ndien si barrë që dikush zotëron ndonjë të mirë të

dynjallëkut ose të mirë morale, andaj dëshiron që mos ta ketë këtë të mirë e ta humbë atë. Zilia ose smira, sipas Islamit është veti e ndaluar dhe e qotuar.

Në një hadith tjetër Muhamedi s.a.v.s. thotë:

"Nuk e ka të lejuar muslimani ta braktisë vëllanë e tij musliman dhe t'i ndërpresë lidhjet me të më tepër se tri ditë!". Kjo do të thotë: Nëse ndër muslimanët ka ndodh konflikt ose grindje, duhet të paqësohen t'ja bëjnë hallall njëri-tjetrit brenda një kohe sa më të shkurtër, e më së gjati në afat prej tre ditësh. Ai që afrohet dhe kërkon pajtim i pari, ai është më i mirë, e, nëse tjetri refuzon këtë, atëherë ai është mëkatar.

Këtu duhet të theksohet se një raport i këtillë mirëkuptimi (harmonie), dashurie e paqësimi duhet të mirëmbahet me çdo vëlla musliman, vetëm nëse ekziston ndonjë shkak i arsyeshëm fetar a moral që të ndërpriten lidhjet dhe të kërkohet e të vijohet miqësia me ndonjë njeri. Ky është p.sh. rasti kur dikush me vetëdije, qëllimthi dhe botërisht (haptazi) mëkaton ndaj fesë, i thyen dhe i përqesh dispozitat e saj, ose ka sjellje dyfytyrëshi, kundrejt fesë, i cili para botës hiqet si musliman në realitet nuk e do fenë dhe i bën asaj fshehurazi dhe haptazi pengesa, ose ndoshta përpiqet që të luhasë tjetrin në besim dhe ta shmangë atë nga rruga e drejtë, ose e shtynë në ndonjë mëkat, p.sh. të pijë alkool etj. Një "musliman" i këtillë nuk bën të duhet e as të miqësohet. Përkundrazi, nga njeriu i këtillë duhet të largohemi për shkak të mëkateve dhe mangësive të tij, derisa të pendohet sinqerisht dhe të braktisë sjelljen e vet të parregullt, por kundrejt tij nuk duhet të jemi të dhunshëm dhe të padrejtë. Një qëndrim të ngjashëm muslimani duhet ta ketë edhe ndaj njeriut që i ka bërë ndonjë padrejtësi të madhe ose e ka ofenduar rëndë.

Sa u tha më sipër, duket qartë se ndërmjet muslimanëve nuk duhet të ketë grindje, rrahje, e sidomos vrasje reciproke. Këto janë mëkatet më të mëdha dhe të metat më të urryera para Zotit dhe para të gjithë njerëzve të ndershëm në botë, siç cekëm më parë. Për këtë shkak Islami ua ndalon rreptësisht këto ithtarëve të vet. Në realitet, të vrasë vëllanë e vet musliman mund të bëjë vetëm ai që e ka humbur fenë dhe njerëzinë, ka rënë në shkallën e bishës gjakpirëse, kafshës së egër. Ai që ka vrarë i pari, e ka vrarë në të vërtetë edhe fenë edhe njerëzinë e vet dhe është bërë njeri i egër.

E, ç'tju flas më lidhur me këtë? Sado që t'ju flisja, nuk jam në gjendje, nuk kam aftësi për t'ju shpjeguar sa i tmerrshëm është ky mëkat tek All-llahu xh.sh. sa e ulët dhe e shëmtuar është kjo vepër siç na e kanë shpjeguar këtë All-llahu xh.sh.,në Kur'an, dhe i Dërguari i Tij, Muhamedi s.a.v.s. në hadith. Dhe ja ç'thuhet për këtë mëkat të rrëndë:

Kur'ani:

"Besimtari (musliman) nuk mund të mbysë muslimanin tjetër, përveç nëse kjo ndodh pa dashur." (En-Nisa:91)

Se çfarë mëkati është kur kjo bëhet me qëllim, All-llahu xh.sh. na thotë në ajetin tjetër:

"Kush e mbyt me qëllim dhe paramendim vëllanë e vet musliman, dënimi për të është xhehenemi, në të cilin do të qëndrojë përgjithmonë, mbi të do të derdhet pezmi dhe mallkimi i All-llahut, dhe All-llahu për të ka përgatitur mundime (vuajtje) të mëdha!" (En-Nisa:92)

Të kujtohemi dhe të mbajmë mend se asnjë mëkat në Islam nuk është gjykuar kaq ashpër dhe tmerrshëm sikundër ky, dmth. vrasja e vëllait musliman.

Duke shpjeguar domethënien e këtyre ajeteve, Muhamedi s.a.v.s. për këtë mëkat të neveritshëm ka thënë në shumë hadithe:

"Të grindesh me muslimanin dhe ta shash atë është mëkat dhe vepër e keqe, kurse të rrahësh dhe ta vrasësh është rebelim (dalje) nga feja (kufër)."

"Ditën e Gjykimit, më së pari njerëzit do të gjykohen për vrasje." - që do të thotë se ky është mëkati më i madh.

"Kush i ndihmon ndonjë vrasësi (bashkëvepron me të) me fjalë ose me isharet (shenjë) në vrasjen e një muslimani, do të dalë para All-llahut Ditën e Gjykimit me mbishkrimin në ballë: "Fatkeqi i cili është larg rahmetit të All-llahut."

"Ndoshta All-llahu do t'ua falë çdo mëkat njerëzve (pa pendim), përveç njeriut që vdes si kafir dhe njeriut që e mbyt me qëllim muslimanin."

Pra, sërish paralajmërim dhe tërheqje vërejtjeje se sa i madh dhe i tmerrshëm është ky mëkat.

"Kur dy muslimanë ballafaqohen në përleshje reciproke me armë në dorë dhe njëri e mbyt tjetrin, edhe vrasësi edhe i vrari shkojnë në Xhehenem!" Dikush nga as'habët e pranishëm në këtë tha: "Vrasësi, po, këtë po e kuptojmë, por përse i vrari?" I Dërguari i All-llahut u përgjigj:"Ai ka dashur, ka pasur për qëllim ta mbysë vëllanë e vet dhe shokun e vet!"

"Kiameti tek All-llahu është ngjarje më e vogël dhe më e lehtë sesa vrasja e një muslimani."

"Pas meje mos u bëni rebel nga Islami dhe ta vritni njëri-tjetrin."

Mjerisht, ndodh që muslimanët të grinden e të vriten për ndonjë imtësi të dynjallëkut: për një copë tokë, për megje (sinor), për drurë në kori, për pemë në kopsht, për ndonjë send në shtëp kur ndahen, etj. Sa e ligë, primitive dhe e panjerëzishme është kjo! E, sa e keqe dhe mëkatare është kjo sipas Islamit!

Ja se ç'thotë posaçërisht për këtë, përveç asaj që u tha më sipër, i Dërguari i All-llahut, Muhamedi s.a.v.s.:

"Kur të rriheni dhe vriteni për dynjallëk dhe interesat e dynjallëkut, edhe vrasësi edhe i vrari do të hynë në xhehenem!"

Përveç shkaqeve të përmendura, sot janë të shpeshta edhe: alkooli, bixhozi dhe femrat (kurvëria, për shkak të grindjes rreth ndonjë vajze, ose për shkak të lidhjeve të palejuara me gra ose, në disa vise, për shkak të grabitjes së gruas së huaj)

Ndonjëherë shkaku i vrasjes është pezmi i tepruar, hidhërimi që ia turbullon njeriut mendjen dhe e shtyn atë në rrahje e në vrasje. Një pezm i këtillë, sipas Islamit, është një veti e keqe dhe e qortuar, të cilin muslimani gjithnjë duhet të përpiqet ta dëbojë. Ai duhet ta dijë se në këtë pezm përherë është i përzier djalli, ose fuqitë e së keqes, që gjithnjë e më tepër nxisin te njeriu hidhërimin, vetëm e vetëm që ta shtyjnë atë të bëjë ndo-një vepër të keqe dhe t'i sjellin fatkeqësi atij dhe të tjerëve. Ekzistojnë njerëz të pashkolluar e të padijshëm të cilët ngado-njëherë mendojnë, e veçanërisht kur janë të hidhëruar, se ta vrasësh njeriun është trimëri. Kjo është lajthitje e madhe dhe mashtrim i djalli. Në Islam dhe te të gjthë njerëzit e mençur nuk është trimëri të jesh rob i hidhërimit tënd dhe i djallit, e të dëgjosh urdhërin e tyre për ta mbytur

njeriun, por trimëri e njerëzi është të përmbash veten në hidhërimin më të madh dhe të mos e dëgjosh djallin, madje edhe në hidhërim e sipër të sillesh në mënyrë njerëzore e bujare.[41]

Tani do të parashtrojmë një hadith shumë konstruktiv, të cilin duhet të mbajë mend çdo musliman dhe ta pranojë atë si parim jetësor, i cili do t'i shërbejë e do ta shpëtojë atëherë kur do të hidhërohet më së tepërmi.

"Nuk është trim ai që e mposhtë (e mund) njeriun në mundje (luftim trup me trup), por ai i cili e mposhtë në vete zemërimin dhe mllefin!"

Një trim të këtillë do ta kërkojë Islami, trimin e këtillë e do All-llahu xh.sh. dhe i Dërguari i Tij s.a.v.s.

Çdo musliman duhet të përpiqet që të jetë trim i këtillë dmth. që të ketë trimëri të drejtë, të jetë bujar e njerëzor, të ketë fuqinë e sundimit mbi vetveten. Vetëm trimëria fizike, fuqia pa bujari e kulturë, nuk është - sipas etikës islame - aspak virtyt, meqenëse në realitet as që është trimëri. Njerëzit të cilët trimërinë dhe fuqinë e vet e shfaqin me grindje, me shar-je, me rrahje, me banditizëm, me krime e kriminalitete te ndry-shme nuk janë kurrfarë trimash që do të meritonin admirim. Këta janë vetëm njerëz grindavecë, shamataxhinj, të ligë e të pakulturuar, njerëz të egër, të cilët meritojnë përbuzje e qortim. Njerëzit që nuk e kontrollojnë vetveten, të cilët nuk i vërejnë

[41] Muslimani, sipas mësimit islam, mund të përdorë forcën kundër tjetrit vetëm në rast të nevojës së skajshme, për ruajtjen e jetës, nderit dhe pasurisë së vet, sikundër edhe jetën e nderin e të afërmve të vet, dhe atë vetëm sa është e nevojshme që ta dëbojë sulmuesin ose vjedhësin. Nëse do të detyrohej të vriste sulmuesin, atëherë nuk është mëkatar.

vëmendshëm sjelljet e tyre, të cilët nuk i përfshijnë normat morale dhe virtytet njerëzore, lehtë mund të bëhen të tillë. Tek ata prirja morale dhe ndjenja e njerëzisë shkatërrohet dhe shuhet, e ndërkohë zhvillohen vetitë negative, të cilat atëherë mund t'ua kufizojnë edhe aftësitë mendore. Kur psikia-tëri në Amerikë kanë pyetur një të ri, vrasës të shumëfishtë, që vriste njerëz krejtësisht të pafajshëm, përse e bënte këtë, ai është përgjigjur: *"Thjesht, sepse asgjë tjetër më e mençur nuk më binte ndërmend."* Kjo është një gjendje trishtuese për njerëzit, të cilët i lëshohen mëkateve dhe krimeve dhe bien në ligësi të tmerrshme. Muslimani nuk mund dhe nuk guxon kurrë të jetë i tillë. Ai është, për nga bujaria dhe mirësia e shpirtit te tij, për nga zgjuarsia e mendjes së tij, e kundërta e gjithë kësaj. Hadithet dhe udhëzimet e përmendura e ndihmojnë që, në çdo situatë, të jetë dhe të mbetet njeri i kulturuar dhe bujar në nivelin e dinjitetit njerëzor.

Kur një njeri pati kërkuar nga i Dërguari i All-llahut s.a.v.s. këshillë, ai i ka thënë:

"Mos u hidhëro, mos bjer në zemërim!" Kur i Dërguari pa një njeri në gjendje të entuziazmit të skajshëm për shkak të zemërimit, të cilit nga pezmi e gjithë fytyra i ishte skuqur, ai s.a.v.s. tha:

"Unë i di disa fjalë të cilat, sikur t'i thoshte ky njeri, do t'ia zbusnin zemërimin që ka: I drejtohem All-llahut dhe e lus atë që të më shpëtojë nga shejtani i mallkuar!"

Po kështu, është mirë që njeriu në gjendje hidhërimi t'i thotë edhe këto fjalë:

"Nuk ka as forcë, as fuqi pa ndihmën e All-llahut të Lartmadhërishëm!"

(Ai na ka ndaluar që fuqinë tonë ta harxhojmë në vepra të këqija dhe në mëkate).

Veçanërisht është dobisjellëse që njeriu në gjendje të tillë të marrë abdest. Të gjitha këto janë ilaçe që zbusin tensionin psikik të shkaktuar nga zemërimi, i cili do të mund të shkakto-nte dëme të mëdha. Këto janë ilaçe të rëndësishme e të dobi-shme nga barnatorja shpirtërore e Islamit, prandaj duhet të ruhen e të shfrytëzohen.

GJAKMARRJA

Nga e tërë ajo që u tha deri më tani kuptohet se gjakmarrja dhe dyluftimet janë të ndaluara (haram) ndër muslimanët, siç kanë thënë të gjithë mësuesit islamë (ylemaja).

Gjakmarrja ka qenë shumë e përhapur në Arabi para Islamit. Ky zakon primitiv e i dëmshëm ka ekzistuar dhe ekziston edhe sot te popujt primitivë e të prapambetur, madje edhe në disa mjedise, për të cilat nuk do të donim të thonin se janë primitvë, por megjithatë nuk mund të lirohen nga ky zakon i vjetër, ose nga ky mëkat i madh, i cili ndër njerëzit e kulturuar e fisnikë nuk mund të ketë vend. Marrja e gjakut sipas zakonit të hakmarrjes tërheq zanafillën e saj nga kohët kur njerëzit nuk kishin sistem të rregullt ligjor, mbrojtje ligjore dhe drejtësi me anë të gjyqeve të rregullta, që është karakteristikë e mjediseve më të prapambetura, e kësi ka qenë edhe bashkësia e idhujtarëve arabë para Islamit. Ndër mëkatet dhe shprehitë e këqija të shumta që mbretëronin në Arabinë paraislamike, të cilat pastaj Islami i ka ndërperë dhe i ka ndaluar tërësisht, ka qenë gjakmarrja. Se sa i ndaluar dhe i gjykuar në Islam është ky zakon i prapambetur e i egër shihet edhe nga fjalimi i të Dërguarit të All-llahut, Muhamedit s.a.v.s. në haxhin e tij të lamtumirës, para fundit të jetës së tij, kur ai këtë ndalesë e ka theksuar në mënyrë të veçantë. Në këtë fjalim të tijin (hytbe) në Arafat, në të cilin ai ka parashtruar parimet dhe dispozitat kryesore islame, morale, familjare e shoqërore, për gjakmarrjen ka thënë:

"Çdo gjakmarrje që ka ekzistuar në kohën pagane para Islamit është anuluar dhe shfugruar!"

Këtë urdhër e ka zbatuar menjëherë në praktikë, në të njëjtin vend, kur e anuloi gjakmarrjen e një kushëriri të tij, Rebi'a El-Harithit, të cilin e kishin vrarë njerëzit e fisit Hudhejl, e gjakmarrja e të cilit ende nuk ishte zgjidhur. Atë ditë pushoi të ekzistuari gjakmarrja tek arabët si dhe te popujt e tjerë të cilët sinqerisht dhe ndërgjegjshëm kishin pranuar Islamin dhe kulturën islame. Prej atëherë muslimanët, në pajtim me fjalët e Muhamedit s.a.v.s., të gjitha rastet dhe konfliktet lidhur me vrasjet rreshtën t'i zgjidhin privatisht, në mënyrë arbitrare e tekanjoze, me anë të hakmarrjes, por i kanë zgjedhur ato me anë të gjyqeve e ligjeve. Kështu duhet të jetë gjithnjë ndër muslimanët, ngase fjalët e Muhamedit s.a.v.s. për ndalesën e gjakmarrjes kanë vlerë të përhershme për të gjitha kohët.

Sipas një transmetimi tjetër ai ka thënë: "Gjakmarrja dhe kamata nga kohët e paganizmit le të ndërpriten përgjithmonë!"

SJELLJA E KEQE DHE JO E KULTURUAR SI SHKAKTARE E GRINDJEVE DHE VRASJEVE

Përveç shkaqeve të përmendura më sipër për grindjet dhe vrasjet ndër njerëzit, shpeshherë shkak janë edhe sjelljet e këqija. Veçanërisht fyerjet (thashethemet), shpifjet dhe përgoj-imet.

Të gjitha këto veprime vetvetiu janë mëkate dhe mangësi të mëdha nga aspekti dhe morali islam. Këto mëkate dhe mangësi assesi nuk guxojnë të gjendën te muslimanët. Këto mëkate janë në

kundërshtim me çdo moral njerëzor dhe me nocionet themelore të kulturës dhe mirësjelljes së bukur.

Krahas kësaj, ato gjithnjë kanë pasoja shumë të këqija nga aspekti shoqëror ngase çrregullojnë dhe shkatërrojnë marrëdhëniet e mira ndërnjerëzore dhe shpeshherë shkaktojnë grindje dhe urrejtje të ndërsjellë, madje mund të shpiejnë edhe te rrahja dhe vrasja. Për shkak të të gjitha këtyre, Islami ua ndalonte të gjithë ithtarëve të vet. Fjalët kur'anore janë:

"Mos merrni nëpër gojë njëri-tjetrin..." (Huxhurat: 12)

"Mjerë për çdonjërin që i ofendon dhe i shpotit njerëzit (sy në sy ose prapa shpinës)!" (El-Humezeh: 1)

"Mos e ndiq atë që ofendon njerëzit dhe bart fjalë (për t'u shkatuar grindje dhe trazira)**!"** (El-Kalem:11)

"Largohuni nga fjalët e rrejshme dhe nga dëshmimi i rrejshëm!" (El-Haxhxh:30)

Ndër hadithet po përmendim vetëm disa:

"Ka njerëz që ndonjëherë thonë fjalë duke mos menduar se a janë të dobishme apo jo e për shkak të të cilave bien thellë në zjarr"

"A e dini se ç'është përgojimi?... Të flasësh për dikë atë që ai nuk dëshiron të flitet për të... nëse tek ai nuk ekziston ajo për çka flet ti, atëherë ke shpifur për të (ky është mëkat edhe më i madh se përgojimi)."

"Tek ai që gjenden katër cilësi të caktuara, ai është dyfytyrësh (munafik) i tërë, e nëse e ka njërën prej këtyre cilësive, ai ka një pjesë të dyfytyrësisë, gjithnjë derisa nuk e flak nga vetja atë cilësi."

"Muslimani nuk është grindavec e mizor, i cili ofendon e sulmon, as sharës e mallkues, as i pagdhendur e i padije (rezil), i cili flet fjalë të panjerëzishme, e as harbut (i vrazhdë e i rëndë)".

Sa të vlefshme e të dobishme që janë këto mësime! Këto janë të rëndësishme si për individin, ashtu edhe për shoqërinë në tërësi. Për individin sepse e mësojnë të jetë bujar e i kulturuar në sjelljen e vet ndaj njerëzve. Për shoqërinë sepse janë element i rëndësishëm i harmonisë dhe paqes së ndërsjellë. Shoqëria muslimane, sikundër edhe çdo individ musliman, duhet të jetë e përshkuar dhe e udhëhequr nga këto mësime dhe virtyte duke iu shmangur të gjitha atyre mangësive të ndaluara dhe të gjykuara. Në këtë mënyrë muslimanët do të dëshmojnë e argumentojnë figurën dhe karakterin kulturor e moral, e njëkohësisht do të largojnë nga mjedisi i tyre shkaqet e mëdha e të shpeshta për urrejtjen, konfliktet dhe vrasjet e ndërsjella.

Këtu duhet bërë një vërejtje e shkurtër për kuptim sa më të drejtë dhe qëndrim sa më korrekt lidhur me mësimet e sipërpërmendura. Gjegjësisht, çdo "përgojim", bartje dhe ritre-gim i mangësive e zullumeve (mizorive), dhunimeve dhe damka-ve të huaja, nuk është gjithnjë mëkat i ndaluar. Kështu, moral-isht është e lejuar të thuhen dhe të paraqiten mangësitë, mëka-tet dhe dëmet e dikujt, p.sh. gjyqit-për shkak të konstatimit të së drejtës dhe për mbrojten e të drejtave personale a të huaja. Nëse dikush me mangësitë vetiake, në çfarëdo mënyre qoftë, i shkakton dëm individëve ose shoqërisë, i rrezikon ata ose inte-resat materiale e morale të tyre, p.sh. me paaftësinë, ligësinë, vjedhjen, qëllimkeqësinë, etj., atëherë individët e rrezikuar dhe shoqëria në mënyrë adekuate mund të përkujtojnë dhe të tërheqin vërejtjen për dëmin e këtyre personave.

Gjithashtu, për t'i mësuar të rinjtë (p.sh. që t'i shmangen shoqërisë së keqe) mund t'ua tërheqin vërejtjen për të metat e dikujt. Nëse dikush me qëllim të mirë pyet për ndonjë person, me të cilin mendon të martohet, mund të thuhen të gjitha për atë person, madje edhe mangësitë e dobësitë e tij, në mënyrë që personi, i cili kërkon mendime dhe këshilla, të dijë si të veprojë. Por, në çdo rast të këtillë, mund të thuhet për dikë vetëm e vërteta, vetëm realiteti, ajo që është në fakt, e kurrë dhe në asnjë rast nuk duhet të thuhet për dikë diçka që nuk është, që nuk gjendet tek ai, pasi nuk bën për askënd të flitet dhe të dëshmohet rrejshëm. Muslimani dhe shoqëria muslimane duhet të jetë e drejtë ndaj çdokujt, siç na thekson qartë Kur'ani kur thotë:

"Le të mos ju nxisë urrejtja juaj ndaj njerëzve ose urrejtja e tyre ndaj jush që të jeni të padrejtë, jini të drejtë gjithnjë ndaj çdokujt (miqve dhe armiqve); ngase kjo është më afër devotshmërisë së vërtetë." (El-Maide: 8)

Kështu pra, paraqitja dhe tregimi i të metave të dikujt nuk bën të jetë për motive personale ose për ndonjë interes personal.

Nëse muslimanët janë në lidhje farefisnore ose fqinj, apo shokë e miq, atëherë në veçanti e kanë të ndaluar (haram) që të kenë sjellje të këqija ndërmjet tyre, që të grinden, të rrihen e të vriten, sepse, sipas mësimit islam, ky është mëkat shumë më i rëndë, përkatësisht, dy herë më i rëndë, sepse përveç mëkatit të grindjes, këtu kryhet edhe mëkati i zhvlerësimit dhe i përdhosjes së farefisit, fqinjësisë dhe shoqërisë së ndërsjellë. Gjegjësisht, Islami thekson dhe porosit në veçanti që lidhjet e marrëdhëniet farefisnore, fqinjësore dhe shoqërore të mirëmbahen sa më mirë dhe të shmanget çdo gjë që do t'i prishte e do t'i çrregullonte këto lidhje.

Mjerisht, te ne shpeshherë ndodh që pikërisht kushërinjtë e fqinjët të ngatërrohen, madje edhe jetën t'ia rrezikojnë njëri-tjetrit, për ndonjë imtësi, për ndonjë interes të dynjallëkut, siç kemi përmendur tanimë. Sa e panjerëzishme dhe sa larg Islamit! Sa më të ngushta e më të afërta të jenë lidhjet farefisnore e fqinjësore ndërmjet njerëzve, kjo është motoja dhe kërkesa islame. Marrëdhëniet ndërmjet prindërve dhe fëmijëve të tyre janë në vend të parë nga ky aspekt e pastaj ndërmjet të afërmve të tjerë, sipas shkallës së afrisë e të gjakut. Se çfarë rëndësie i jep Islami këtyre marrëdhënieve farefisnore e fqinjë-sore, shihet nga ajo se sa shumë flitet për to në burimet krye-sore të fesë: në Kur'an e në Hadith. Në këto burime jepen dispozitat dhe udhëzimet më të përkryera morale e fetare për sjelljen praktike të muslimanëve në jetën e përditshme. Këto dispozita e rregulla do të duhej të ishin ligj për jetën e tyre. Të shohim vetëm si shembull disa nga këto dispozita islame:

Kur'an:

"Zoti yt, All-llahu, ka urdhëruar që të adhuroni vetëm Atë dhe t'u bëni mirësi prindërve. Nëse njëri prej tyre, ose që të dy, përjetojnë te ti pleqërinë e vet, mos u thuaj kurrë atyre asnjë fjalë pakënaqësie (mërzie), mos u sill ndaj tyre me vrazhdësi, dhe gjithmonë thuaju ndonjë fjalë të mirë." (El-Isra: 23)

"Adhuroni All-llahun dhe mos i përshkruani kurrë shok Atij! Ndaj prindërve kini sjellje të mirë, edhe ndaj të afërmve në përgjithësi, pastaj ndaj bonjakëve e varfanjakëve, ndaj fqinjve në përgjithësi, pastaj ndaj fqinjve të largët, si dhe ndaj shokut..." (En-Nisa:36)

"Ne i kemi rekomanduar njeriut që të ketë sjellje të mirë ndaj prindërve..." (El-Ankabut:8)

Hadithet:

"Mëkatet e mëdha janë: mosbesimi në All-llahun, sjellja e vrazhdë dhe mosdëgjimi i prindërve, vrasja e njeriut dhe betimi i rrejshëm!"

Në një hadith Muhamedi s.a.v.s. ua tërhoqi vëretjen dhe i pyeti shokët e vet: *"Kini kujdes, a dëshironi t'ju tregoj se cilat janë mëkatet më të mëdha?"* Këtë e ka përsëritur tre herë. *"Po, dëshirojmë!"* - thanë shokët e tij. Ai tha: *"Mosbesimi në All-llahun, vrazhdësia dhe mosdëgjimi i prindërve ..."*, pastaj u ngrit e tha: *"Kini kujdes ende: edhe betimi i rrejshëm!"* Më tej në hadith, i Dërguari i All-llahut s.a.v.s thotë:

"Kush e beson All-llahun dhe Ditën e Gjykimit, le të sillet mirë ndaj të afërmve të vet; kush e beson All-llahun dhe Ditën e Gjykimit, le të flasë atë që është e mirë dhe e dobishme, ose le të heshtë!"

Në një hadith tjetër thotë:

"Kush e beson All-llahun dhe Ditën e Gjykimit, le të sillet bukur dhe njerëzisht me fqinjin e vet!"

"Mirëbërësia (ndihma) ndaj të afërmve është mirëbërësi e dyfishtë: ndihmë dhe kujdes ndaj të afërmve."

Në një rast, sërish, Muhamedi s.a.v.s. dy herë përsëriti: "Betohem në All-llahun, se nuk është besimtar i mirëfilltë..." "Kush, o i Dërguari i All-llahut?", - e pyetën as'habët, e ai u përgjigj: "Ai njeri nga shpirtligësia dhe e keqja e të cilit nuk është i kursyer e i sigurtë fqinji i tij."

Lidhur më këtë rregull islam sjellja e mirë e dëgjimi i prindërve dhe i të afërmve mësimi islam jep një vërejtje të rëndësishme, e cila gjendet në vetë Kur'anin. Marrëdhëniet e mira dhe sjelljet e këtilla duhet të mirëmbahen në kufijtë e sjelljeve të drejta morale të prindërve; prandaj, nëse prindërit do t'i kalonin kufijtë e do të urdhërojnë a do të kërkojnë nga fëmija e tij diçka që nuk është e lejueshme sipas normave fetare ose morale, e mëkatshme dhe e ndaluar, atëherë detyrimi dhe rre-gulli i dëgjimit në këtë rast ndalet.

Prandaj, nëse prindi do ta nxiste fëmijën e vet të bëjë mëkat, p.sh. të pijë alkool, t'i sjellë alkool atij, ose të jepet pas kriminalitetit ose të mos i zbatojë dispozitat fetare, detyrimet patriotike, ose përgjithësisht të mos e respektojë fenë e tij Islamin, atëherë në këto raste, fëmija nuk do t'i dëgjojë këto kërkesa të parregullta. Veçanërisht dhe analogjikisht me këtë nënkuptojmë se edhe prindi nuk duhet t'i japë kënaqësi fëmijës së tij nëse ai do të kërkonte kësi veprash nga ai. Pikërisht, rregulli i njëjtë vlen edhe nga pikëpamja e solidaritetit dhe dëgjimit ndaj të afërmve, që të bëjë diçka mëkatare dhe jonormale sipas Islamit, ose sipas ligjeve të drejta shoqërore. Në raste të këtilla, nuk duhet të jesh solidar dhe i dëgjueshëm ndaj askujt.

Lidhur me këtë, në Kur'an thuhet:

"... Por nëse ata të nxisin e të drejtojnë që Mua të më përshkruash shok, ose të mos besosh në Mua, atëherë mos iu bind atyre!..." (El-Ankebut:8)